



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 2

D H J E T O R 2 0 1 1

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 2

BOTUES © Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

Faqja e internetit www.bqk-kos.org

Adresa elektronike economicanalysis@bqk-kos.org

KRYEREDAKTOR Gani GËRGURI

REDAKTOR Arben MUSTAFA

AUTORËT Zana GJOCAJ
Sokol HAVOLLI
Albulenë KASTRATI
Mimoza MUSTAFA
Astrit PANXHA

REDAKTOR TEKNIK Butrint BOJAJ

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
ATM	Bankomatë (angl. Automated Teller Machines)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio)
CIS	Commonwealth of Independent States
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (angl. European Bank for Reconstruction and Development)
ECB	Banka Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank)
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MEF	Ministria e Financave
NIM	Margjina Neto e Interesit (angl. Net Interest Margin: NIM)
NPL	Kreditë joperformuese (angl. Non-Performing Loans)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
pp	Pikë Përqindje
POS	Pika të Shitjes (angl. Point of Sales)
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
OECD	Organizata për Bashkpunim Ekonomik dhe Zhvillim (angl. Organization for Economic Cooperation and Development)
OJSHEF	Organizatrat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (angl. Rule of Law Index)
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity)
ROE	Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (angl. Risk Weighted Assets)
SDR	Të Drejtat Speciale të Tirazhit (angl. Special Drawing Rights)
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
 Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2011), Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 2, Prishtinë: BQK.
 Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

PËRMBAJTJA:

1. Parathënie	9
2. Përmbledhje Ekzekutive	11
3. Zhvillimet Makroekonomike dhe Financiare në Ekonominë Botërore	17
3.1. Evropa Juglindore	25
4. Ekonomia e Kosovës	28
4.1. Sektori real	29
5. Sektori Financiar i Kosovës	33
5.1. Karakteristikat e përgjithshme	33
5.2. Sistemi i pagesave dhe infrastruktura bankare	36
6. Sistemi Bankar i Kosovës	42
6.1. Karakteristikat e përgjithshme të sistemit bankar	42
6.2. Bilanci i gjendjes së sistemit bankar	43
6.3. Performanca dhe rreziqet e sistemit bankar	52
7. Institucionet Tjera Financiare	73
7.1. Kompanitë e sigurimit	73
7.2. Fondet pensionale	75
7.3. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiarë	76
Tema Specifike	81
8. Anketa mbi Kreditimin Bankar për Kosovën	83
Astrit Panxha dhe Arben Mustafa	
9. Përcaktuesit e Kredive Joperformuese në Vendet e Tranzicionit	98
Albulenë Kastrati	
10. Përcaktuesit e Investimeve të Emigrantëve: a ka Hapësirë për Politikëbërje?	105
Sokol Havolli dhe Boštjan Jazbec	
9. Shtojca Statistikore	109
10. Referencat	129

LISTA E FIGURAVE----- 18

Figura 1. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave për grupet bankare-----	18
Figura 2. Kthimi ndaj kapitalit për grupet bankare -----	19
Figura 3. Norma ekredive joperformuese në vende të zgjedhura të eurozonës-----	20
Figura 4. Tregusit e mjaftueshmërisë së kapitalit në vende të zgjedhura të eurozonës -	20
Figura 5. Skema Bazel III -----	21
Figura 6. Harta makroekonomike -----	27
Figura 7. Dërgesat e emigrantëve -----	28
Figura 8. Llogaria rrjedhëse -----	29
Figura 9. Llogaria kapitale dhe financiare-----	30
Figura 10. Indeksi i çmimeve të konsumit, importit dhe prodhimit -----	30
Figura 11. Kontributi i komponentëve të CPI-së në inflacion vjetor-----	31
Figura 12. Norma reale efektive e këmbimit-----	31
Figura 13. Struktura e asetëve të sistemit financiar sipas sektorëve-----	32
Figura 14. Kërkuesat neto të sektorit financiar -----	33
Figura 15. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve -----	34
Figura 16. Struktura e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm -----	34
Figura 17. Struktura e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm -----	34
Figura 18. HHI për asete, kreditë dhe depozitat-----	41
Figura 19. Kontributi në rritjen e asetëve të sistemit bankar sipas kategorive -----	42
Figura 20. Normat vjetore të rritjes së komponentëve të asetëve-----	43
Figura 21. Kreditë e reja në baza mujore -----	44
Figura 22. Norma vjetore e rritjes së kredive sipas sektorëve -----	44
Figura 23. Struktura e kredive sipas sektorëve -----	45
Figura 24. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike -----	45
Figura 25. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit -----	46
Figura 26. Struktura e depozitave sipas sektorëve -----	48
Figura 27. Struktura e depozitave të afatizuara sipas maturitetit-----	49
Figura 28. Mesatarja gjashtëmujore e normave të interesit -----	50
Figura 29. Harta e stabilitetit financiar -----	51
Figura 30. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve-----	51
Figura 31. Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve -----	52
Figura 32. Struktura e të hyrave-----	52
Figura 33. Normat vjetore të rritjes së të hyrave -----	52
Figura 34. Struktura e e të hyrave sipas kategorive -----	53
Figura 35. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive-----	53
Figura 36. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive-----	54
Figura 37. Treguesit e profitabilitetit-----	54

Figura 38. Raporti shpenzime të hyra-----	55
Figura 39. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar -----	56
Figura 40. Raporti asete likuide “broad”/detyrime afatshkurtëra-----	57
Figura 41. Rezervat e sistemit bankar -----	57
Figura 42. Struktura e letrave me vlerë-----	59
Figura 43. Hendeku i likuiditetit-----	58
Figura 44. Struktura e kredive sipas klasifikimit -----	61
Figura 45. Raporti NPL/gjithsej kreditë -----	62
Figura 46. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve -----	62
Figura 47. Struktura e kredive joperformuese-----	62
Figura 48. NPL-të sipas sektorëve-----	63
Figura 49. NPL-të sipas industrive-----	63
Figura 50. NPL-të dhe provizionet -----	63
Figura 51. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	65
Figura 52. Kapitalizimi i sistemit bankar -----	65
Figura 53. Gjithsej kapitali dhe kapitali rregullativ-----	66
Figura 54. Gjithsej kapitali dhe norma vjetore e rritjes -----	67
Figura 55. Struktura e kapitalit të sistemit bankar -----	68
Figura 56. Struktura e kapitalit të klasit të parë-----	68
Figura 57. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut -----	69
Figura 58. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit-----	73
Figura 59. Struktura e detyrimeve të kompanive të sigurimit-----	73
Figura 60. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara -----	74
Figura 61. Truktura e primeve të pranuar të kompanive të sigurimit -----	74
Figura 62. Struktura e dëmeve të paguara të kompanive të sigurimit-----	75
Figura 63.Çmimi i aksionit të TKPK-sëdhe indeksi DJI -----	75
Figura 64. Struktura e investimeve të trustit-----	76
Figura 65. HHI për asetet e IMF-ve-----	76
Figura 66. Asetet sipas madhësisë së IMF-ve -----	77
Figura 67. Kreditë e lëshuara nga IMF-të -----	77

LISTA E TABELAVE ----- 16

Tabela 1. Indikatorët kryesor makroekonomik-----	16
Tabela 2. Periudha kohore për implementimin Bazel III -----	22
Tabela 3. Rritja vjetore e kredive dhe depozitave -----	26
Tabela 4. Numri i institucioneve financiare -----	33
Tabela 5. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej SEKN -----	37
Tabela 6. Rrjeti i sektorit bankar -----	39
Tabela 7. Struktura e aseteve të sistemit bankar -----	43
Tabela 8. Struktura e detyrimeve të sistemit bankar -----	47
Tabela 9. Tregusit e efikasitetit të sistemit bankar-----	55
Tabela 10. Distribrimi i aseteve sipas shkallës së CAR-së -----	66
Tabela 11. Përmbledhja e rezultateve të stres-testit -----	72

LISTA E KUTIVE ----- 18

Kutia 1. Performanca e grupeve bankare të cilat operojnë në Kosovë -----	18
Kutia 2. Reformimi i kornizës rregullative të sistemit bankar përmes Bazell III -----	21
Kutia 3. Strategjia e zhvillimit të sistemit kombëtar të pagesave -----	40
Kutia 4. Ligji për bankat dhe institucionet financiare jobankare -----	42
Kutia 5. Ngarkesa me borxh dhe performanca e kredive të klientëve mikrokreditor në Kosovë-----	60
Kutia 6. Administrimi i përkohshëm i KEP Trust - rivendosja e qeverisjes -----	77

1. Parathënie

Ekonomia e Kosovës vazhdon me stabilitet duke reflektuar normë pozitive të rritjes dhe stabilitet adekuat në rrafshin fiskal dhe monetar. Konsumi dhe investimet e sektorit privat kanë vazhduar të kenë rol parësor në zgjerimin e aktivitetit ekonomik në vend, përderisa rol të vazhdueshëm në rritje po luan edhe sektori fiskal, sidomos në aspektin e investimeve publike. Pozita jo e favorshme e bilancit tregtar me botën e jashtme vazhdon të ketë ndikim negativ në bilancin e llogarisë rrjedhëse të ekonomisë së vendit tonë, por inkurajon fakti se mbulesa e importeve me eksporte shënon trend rritës. Sidoqoftë, ekonomia e Kosovës vazhdon të vuajë nga norma e lartë e papunësisë gjë që kërkon një dinamikë edhe më të madhe dhe një “meny” edhe më të pasur të aktivitetit ekonomik i cili do të rezultonte me më shumë vende të reja të punës.

Sektori financiar stabil i Kosovës paraqet burimin më të rëndësishëm të financimit dhe njërën ndër shtyllat më të rëndësishme të stabilitetit të ekonomisë së vendit. Bërthamën e këtij sektori e përbën sistemi bankar i cili vazhdon të performojë me shëndet dhe me stabilitet ndër më të mirin madje krahasuar edhe me shumë sisteme me traditë në rajon dhe më gjerë. Bankat komerciale në Kosovë kanë përshpejtuar ritmin e kredisë drejtë ekonomisë, ndërsa besimi i rritur i publikut ndaj sistemit bankar ka rezultuar me rritje të vazhdueshme edhe të depozitave nëpër banka. Sistemi bankar i Kosovës nuk është i ekspozuar pothuajse fare problemeve që kanë të bëjë me huadhënien dhe ose huamarrjen ndërkufitare dhe ndërvalutore. Gjithnjë, bankat komerciale që operojnë në vend po mirëmbajnë norma të larta të likuiditetit dhe të kapitalizimit, duke tejkaluar madje edhe kërkesat rregullative të BQK-së dhe disa nga standardet ndërkombëtare në këtë fushë. Një stabilitet i tillë i sektorit financiar e bën perspektivën ekonomike të vendit edhe më pozitive dhe më immune nga tronditjet që mund të vijnë nga sektori i jashtëm.

Sidoqoftë, vështirësitë dhe pasiguritë që aktualisht po mbretërojnë në ekonominë e eurozonës paraqesin shqetësim edhe për ekonominë e vogël dhe të hapur të Kosovës, kryesisht për shkak të ecurive të mundshme negative që mund të prekin remitencat, eksportet dhe investimet e huaja direkte në ekonominë e Kosovës. Të gjitha këto paraqesin shqetësim për performancën e sektorit real të ekonomisë së Kosovës, gjë që mund të ndikojë negativisht edhe performancën e sistemit bankar të vendit përmes dobësimit të aftësisë paguese të kredimarrësve. Padyshim, sistemi bankar duhet të vazhdojë së përkrahuri ekonominë e vendit përmes kredisë, mirëpo ky zgjerim i aktivitetit kredidhënës duhet bërë me kujdes të shtuar, në mënyrë që të ruhet stabiliteti financiar si parakusht i rëndësishëm edhe për stabilitetin e përgjithshëm ekonomik në vend.

Pikërisht, nisur nga objektivi parësor i BQK-së mbi sigurimin e stabilitetit financiar, ky *Raport i Stabilitetit Financiar* synon të analizojë zhvillimet kryesore në sektorin financiar, përfshirë aspekte të ndërvarësisë midis sektorëve brenda dhe jashtë ekonomisë së vendit si dhe të shtjellojë tema specifike që sëbashku kanë për qëllim t'i kontribuojnë debatit dhe analizave publike mbi çështjet me rëndësi për stabilitetin dhe zhvillimin e ekonomisë së Kosovës.

Gani Gërguri
Guvernator

2. Përmbledhje Ekzekutive

Shenjat e rikuperimit të ekonomisë globale që u paraqitën gjatë vitit 2010 nuk vazhduan me të njëjtin ritëm edhe gjatë vitit 2011, gjë që pritet të rezultojë në një ngadalësim të rritjes së ekonomisë globale në vitin 2011. Ngadalësimi i rritjes së ekonomisë globale kryesisht ka për burim vështirësitë ekonomike me të cilat po ballafaqohen eurozona dhe SHBA-të, përderisa vendet në zhvillim vazhdojnë të regjistrojnë normë relativisht të lartë të rritjes ekonomike. Problemet lidhur me nivelet e larta të borxhit publik në disa nga vendet e eurozonës vazhduan të përfaqësojnë zhvillimin më të rëndësishëm në ekonominë e eurozonës, madje këto probleme u thelluan edhe më tepër në krahasim me vitin e kaluar. Thellimi i krizës së borxheve publike në eurozonë ka ndikuar në rritjen e shkallës së rrezikut sistemor në bankat që janë të ekspozuara ndaj këtyre vendeve. Bankat e vendeve të eurozonës që kanë financuar shuma më të mëdha të borxheve publike të vlerësuara me rrezik më të madh janë karakterizuar me tendosje dhe performancë më të dobët, gjë që ka ndikuar edhe në ngadalësimin e rrjedhjes së kredisë drejtë sektorit real të ekonomisë. Grupet kryesore bankare të cilat i kanë entitetet e tyre edhe në Kosovë, përkundër ambientit jo të favorshëm në ekonominë e eurozonës, deri në qershor 2011, kanë shënuar përmirësim të performancës krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Pasiguria rreth zhvillimeve ekonomike në eurozonë ndikoi edhe në zhvlerësimin e valutës euro kundrejt valutave tjera të rëndësishme botërore që nga muaji maj i vitit 2011, përderisa në muajt e parë të këtij viti euro ishte vlerësuar kundrejt valutave tjera.

Vendet e rajonit të EJJL-së kryesisht u karakterizuan me rikuperim të aktivitetit ekonomik gjatë gjysmës së dytë të vitit 2010 dhe fillimit të vitit 2011. Sidoqoftë, parashikimet për zhvillimet e aktivitetit ekonomik në EJJL për gjysmën e dytë të vitit 2011 dhe për vitin 2012 mbeten modeste, përderisa rajoni vazhdon të jetë i ndjeshëm ndaj zhvillimeve në ekonominë e eurozonës në aspektin e tregtisë, investimeve të huaja direkte (IHD-ve), pjesëmarrjes së lartë të bankave të huaja dhe dërgesave të emigrantëve. Përkundër normave pozitive të rritjes ekonomike, disa nga vendet e EJJL-së shënuan rritje të normës së papunësisë, e cila vazhdon të jetë një ndër sfidat më të rëndësishme për të gjitha vendet e EJJL-së. Rritja e të hyrave buxhetore si rrjedhojë e rritjes së aktivitetit ekonomik ka rezultuar në përmirësimin e bilancit buxhetor për shumicën e vendeve të EJJL-së, përderisa niveli i borxhit publik ka një mesatare prej rreth 40 përqind të PBB-së. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, pothuajse të gjitha vendet e EJJL-së u përballën me presione inflacioniste që kryesisht ishin reflektim i rritjes së çmimeve të naftës dhe ushqimit në nivel global, si dhe çmimeve të prodhimit në nivel lokal. Për dallim nga viti 2010, sistemet bankare në shumicën e vendeve të rajonit kanë zgjeruar aktivitetin e tyre kreditues, përderisa depozitat vazhduan të karakterizohen me normë më të ngadalshme të rritjes. Gjatë kësaj periudhe është vërejtur përkeqësim i cilësisë së portofolit kreditor të bankave që operojnë në këto vende.

Zhvillimet ekonomike në gjashtë muajt e parë të vitit 2011 sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në Kosovë po vazhdon të zgjerohet dhe, si rezultat, rritja reale ekonomike për vitin 2011 parashikohet të arrijë në rreth 5.0 përqind krahasuar me 3.9 përqind në vitin 2010. Rritja e kredive të sistemit bankar, shpenzimeve qeveritare si dhe dërgesave të emigrantëve kanë inkurajuar nivelin e përgjithshëm të konsumit në vend gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Po ashtu, rritje vlerësohet të kenë shënuar edhe investimet, si ato private ashtu edhe ato publike. Zgjerimi i vazhdueshëm i kredidhënies nga sistemi bankar i Kosovës vazhdon të mbetet burim i rëndësishëm i financimit të investimeve të sektorit privat në vend, përderisa edhe investimet e huaja direkte shënuan rritje gjatë gjysmës së

parë të vitit 2011. Efekt negativ në PBB-në e Kosovës vazhdon të ketë bilanci tregtar, i cili në vazhdimësi po karakterizohet me shkallë të lartë të deficitit. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, deficiti tregtar në Kosovë arriti vlerën prej 925.4 milionë euro që paraqet rritje prej 16.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjatë kësaj periudhe, importet shënuan rritje vjetore prej 16.5 përqind, ndërsa eksportet u rritën për 18.6 përqind. Deficiti i lartë tregtar vazhdon të kontribuojë deficitit të lartë të llogarisë rrjedhëse, mirëpo efekti i tij vazhdon të zbutet nga bilanci pozitiv i llogarisë së transfereve rrjedhëse që kryesisht përbëhen nga dërgesat e emigrantëve. Dërgesat e emigrantëve deri në qershor të vitit 2011 arritën vlerën prej 234.2 milion euro dhe shënuan rritje prej 1.2 përqind. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, ekonomia e Kosovës vazhdoi të përballet me presionet inflacioniste. Indeksi i Çmimeve të Konsumit për gjashtëmuorin e parë të vitit 2011 shënoi një rritje vjetore prej mesatarisht 9.7 përqind, që paraqet normë relativisht më të lartë inflacioni krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kur inflacioni shënoi një normë mesatare prej 1.4 përqind.

Një ndër faktorët që ka ndikuar në rritjen e aktivitetit ekonomik në Kosovë gjatë kësaj periudhe ka qenë edhe aktiviteti i shtuar ndërmjetësues i sektorit financiar të vendit, që deri në një masë ka qenë rezultat i vetë performancës më të mirë të ekonomisë së vendit në përgjithësi. Sektori financiar i Kosovës gjatë kësaj periudhe kishte një strukturë mjaft të ngjashme me periudhat e kaluara, ku sistemi bankar përfaqëson pjesën më të madhe të asetëve të këtij sektori, pasuar nga sistemi i fondeve pensionale. Sistemi bankar vazhdon të jetë i dominuar nga bankat me pronësi të huaj, si për nga numri i bankave ashtu edhe për nga pjesëmarrja e tyre në gjithsej asetet e sistemit bankar. Struktura e tregut të sistemit bankar vazhdon të karakterizohet nga një shkallë relativisht e lartë e koncentrimin, mirëpo që vazhdimisht po shënon rënie gjë që mund të nënkuptojë rritje të presioneve konkurruese në këtë industri. Që nga qershori i vitit 2010, bankat komerciale kanë vazhduar të zgjerojnë infrastrukturën e tyre, si në kuptim të degëve bankare ashtu edhe në kuptim të infrastrukturës tjetër përcjellëse siç janë ATM-të dhe POS-të, që kontribuon në rritjen e shkallës së shfrytëzimit të shërbimeve bankare në Kosovë. Me qëllim të rritjes së mëtutjeshme të efikasitetit të shërbimeve bankare, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar të avancojë sistemin e pagesave në vend, ndërsa veprime konkrete janë paraparë brenda Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave. Për më tepër, gjatë vitit 2011, BQK-ja ka hartuar Ligjin e ri për Bankat Komerciale, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, me të cilin synon të përforcojë edhe më tutje kapacitetet mbikëqyrëse të BQK-së në rolin e rregullatorit si dhe të kontribuojë në përforcimin e qeverisjes së brendshme në institucionet financiare.

Aktiviteti ndërmjetësues financiar i sistemit bankar të Kosovës u karakterizua me një trend rritës që nga qershori i vitit të kaluar, duke rezultuar në një normë vjetore të rritjes së kredisë prej 15.7 përqind në qershor 2011, krahasuar me rritjen prej 9.7 përqind në qershor 2010. Si rezultat, gjithsej vlera e kredive të lëshuara nga sistemi bankar i Kosovës në qershor 2011 arriti në 1.6 miliard euro, duke përfaqësuar 65 përqind të gjithsej asetëve të sistemit bankar. Përderisa në vitin e kaluar rritjen më të theksuar e kishin shënuar kreditë për ekonomitë familjare, ndërsa shtrëngimi i kredidhënies kryesisht kishte peshuar mbi kreditë për ndërmarrjet, gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, ishte pikërisht kreditimi i ndërmarrjeve private kontribuuesi kryesor i rritjes së nivelit të përgjithshëm të kredive të lëshuara nga sistemi bankar. Rritja e besimit të bankave komerciale kundrejt ndërmarrjeve, si sektor me ndjeshmëri më të lartë ndaj lëvizjeve në ekonominë e brendshme dhe atë globale, ka ndikuar edhe në zvogëlimin e kostos së financimit të

kreditimit për ndërmarrjet private, gjë që mund të ketë ndikuar edhe në rritjen e kërkesës për kredi nga ky sektor. Struktura e kredive të lëshuara për ndërmarrjet, vazhdoi të dominohet nga kreditë e lëshuara për sektorin e tregtisë, të cilat në qershor 2011 përfaqësuan 52.5 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit ka vazhduar të dominohet nga kreditë me afat maturimi prej mbi dy vite, megjithëse këto kredi u karakterizuan me zvogëlim të pjesëmarrjes në gjithsej kreditë gjatë periudhës raportuese.

Kreditë e lëshuara nga sistemi bankar i Kosovës, që përfaqësojnë pjesën dërmuese të aseteve të këtij sistemi, pothuaj në tërësi janë të lëshuara për kredimarrësit brenda Kosovës gjë që e bënë sistemin bankar të Kosovës të ketë ekspozim relativisht të ulët kundrejt tregjeve të jashtme. Rrjedhimisht edhe tronditjet e mundshme në tregjet e jashtme kanë më pak të ngjarë të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë sistemin bankar të Kosovës. Sidoqoftë, përveç investimeve në tregun e brendshëm, një pjesë e aseteve të tregut bankar është e investuar edhe në tregjet e jashtme dhe atë kryesisht në formë të plasmanëve në bankat komerciale dhe letra me vlerë. Investimet në letra me vlerë edhe gjatë kësaj periudhe kanë vazhduar trendin e rritjes, duke arritur në 8.6 përqind të gjithsej aseteve të sistemit bankar.

Aktiviteti i sistemit bankar të Kosovës vazhdon të financohet duke u mbështetur kryesisht në burimet e financimit brenda ekonomisë së vendit, konkretisht në depozitat e mbledhura nga qytetarët brenda Kosovës. Në qershor 2011, gjithsej depozitat në sistemin bankar të Kosovës arritën vlerën prej 1.9 miliard euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 11.8 përqind. Burimi kryesor i depozitave për sistemin bankar të Kosovës vazhdojnë të jenë depozitat e ekonomive familjare, që në qershor 2011 arritën vlerën prej 1.4 miliard euro (69.2 përqind e gjithsej depozitave). Performanca e mirë dhe stabiliteti i treguar nga sistemi bankar i Kosovës ka krijuar mundësi më të mëdha për bankat që operojnë në Kosovë që të shtojnë qasjen edhe në burimet e financimit nga tregjet e jashtme, gjë që krijon potenciale më të mëdha për rritjen e aktivitetit kredidhënës në Kosovë. Një nga këto burime financimi që ka shënuar rritje të vazhdueshme është borxhi i ndërvuar (angl. subordinated debt), që në qershor 2011, arriti vlerën 33.5 milionë euro nga 24.4 milionë euro sa ishte në qershorin e vitit paraprak. Sidoqoftë, financimi i bankave që operojnë në vend nga tregjet e jashtme vazhdon të jetë i ulët në raport me financimin e brendshëm. Për fazën nëpër të cilën po kalon ekonomia globale, kjo paraqet një faktor pozitiv për qëndrueshmërinë e sistemit bankar të vendit në kohën kur pasiguria që ka kapluar tregjet e jashtme mund të rezultojë në luhatje më të theksuara të ofertës dhe kostos së mjeteve likuide.

Normat e interesit në sistemin bankar të Kosovës kanë vazhduar të qëndrojnë në nivel të përafërt me vitin e kaluar, por të karakterizuara me një rënie të lehtë si në kredi ashtu edhe në depozita. Norma mesatare për kreditë e lëshuara nga bankat komerciale kishte një mesatare prej 14.3 përqind në gjysmën e parë të vitit 2011, përderisa norma mesatare e interesit në depozita ishte 3.4 përqind. Profiti i realizuar nga sistemi bankar i Kosovës vazhdoi së qëndruari në nivel pozitiv edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, por që në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar shënon rënie. Profiti neto i sistemit bankar të Kosovës ishte 14.9 milionë euro në qershor 2011, që paraqet një rënie prej 13 përqind krahasuar me qershor 2010. Zvogëlimi i profitit kryesisht ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të shpenzimeve në krahasim me të hyrat e përgjithshme të sistemit bankar, përkundër faktit se ndërmjetësimi financiar shënoi rritje gjatë kësaj periudhe. Ndikimin më të madh në rritjen e shpenzimeve gjatë kësaj periudhe e kishte rritja e provizioneve për

mbulimin e humbjeve potenciale nga kreditë. Rritja më e shpejtë e shpenzimeve krahasuar me të hyrat ka ndikuar në përkeqësimin e disa indikatorëve të efikasitetit për sistemin bankar, siç është raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave, i cili në qershor 2011 u ngrit në 85.4 përqind nga 81.2 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të karakterizohet me shkallë të kënaqëshme të likuiditetit, e cila bën që detyrimet e bankave komerciale ndaj depozituesve dhe huadhënësve tjerë të kryhen me kohë dhe pa vështirësi. Shkalla e kënaqshme e likuiditetit në bankat komerciale që operojnë në vend është rezultat i menaxhimit të kujdesshëm të bilancit të gjendjes së bankave komerciale si në aspektin e asetëve ashtu edhe të detyrimeve. Në qershor 2011, raporti kredi/depozita qëndroi në 83.0 përqind që është kryesisht në linjë me rekomandimet e BQK-së që bankat të mirëmbajnë raportin ndërmjet kredive dhe depozitave në mesatarisht 80 përqind. Sidoqoftë, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, vërehet një rënie e lehtë në disa nga indikatorët e likuiditetit, siç është pjesëmarrja e asetëve likuide të sistemit bankar në gjithsej asetet, por që prap mbeten në nivel të kënaqshëm për të siguruar likuiditetin e këtij sistemi. Sistemi bankar i Kosovës ka vazhduar të jetë mjaft konzervativ për sa i përket nivelit të rezervave, duke tejkaluar në vazhdimësi minimumin e kërkuar nga BQK-ja, gjë që përforcon pozitën e likuiditetit të këtij sistemi.

Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të ketë shkallën më të ulët të kredive joperformuese në mesin e vendeve të rajonit të EJK-së, me një pjesëmarrje të këtyre kredive prej 5.9 përqind të gjithsej kredive. Sidoqoftë, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë shënoi rritje prej 1.4 pp. Pjesa më e madhe e kredive joperformuese në Kosovë i referohen kredive të lëshuara për ndërmarrjet, përderisa kreditë për ekonominë familjare karakterizohen me cilësi më të mirë për sa i përket ripagimit. Kreditë joperformuese në Kosovë vazhdojnë të mbulohen me mbi 100 përqind nga provizionet për humbje nga kreditë dhe bashkë me nivelin e tyre aktual të ulët nuk paraqesin kërcënim për stabilitetin e sistemit bankar. Gjatë periudhës observuese, portofoli kreditor i bankave po ashtu është karakterizuar me rritje të ekspozimeve më të mëdha kreditore.

Shkalla e lartë e kapitalizimit vazhdon të jetë një karakteristikë dalluese e sistemit bankar të Kosovës, duke paraqitur kështu një shtyllë të rëndësishme të qëndrueshmërisë së këtij sistemi dhe duke zvogëluar rrezikun nga josolvenca. Në qershor 2011, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit qëndroi në 17.2 përqind, që madje paraqet nivel më të lartë se sa minimumi i kërkuar nga BQK-ja. Për më tepër, kapitali i sistemit bankar të Kosovës karakterizohet me një cilësi mjaft të mirë, ku kapitali aksionar përbën rreth 60 përqind të gjithsej kapitalit. Gjendja e kënaqshme e qëndrueshmërisë së sistemit bankar të Kosovës sugjerohet edhe nga rezultatet e stres-testit për sistemin bankar, me ç' rast është testuar ndjeshmëria e bankave komerciale kundrejt rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut kreditor, të kombinuar me rrezikun nga normat e interesit dhe kursi i këmbimit. Me këtë rast, rezultat sugjerojnë se bankat komerciale që operojnë në Kosovë kanë mjete të mjaftueshme likuide në dispozicion për të përballuar qoftë edhe norma më të larta të tërheqjes së depozitave, të supozuara në skenarë hipotetik. Po ashtu, norma aktuale e lartë e kapitalizimit dhe niveli aktual relativisht i ulët i kredive joperformuese bëjnë që sistemi bankar i Kosovës të jetë në gjendje të përballojë edhe norma më të larta të kredive joperformuese. Për më tepër, fakti që pjesa dërmuese si e kredive ashtu edhe e depozitave në sistemin bankar të Kosovës janë të denominuara në euro, si dhe fakti që kreditë dhe depozitat në masë dërmuese bartin

norma fikse të interesit, bëjnë që sistemi bankar i Kosovës të jetë minimalisht i ekspozuar edhe kundrejt lëvizjeve potenciale në normat e interesit dhe kursit të këmbimit valutor.

Kontribut të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës vazhdojnë të japin edhe Institucionet Tjera Financiare, të cilat përbëhen nga fondet pensionale, kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiarë. Asetet e sistemit pensional të Kosovës deri në qershor 2011 arritën vlerën prej 551.5 milionë euro, krahasuar me 412.5 milionë euro sa ishin në qershor të vitit 2010, të përbëra kryesisht nga asetet e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). Në gjysmën e parë të vitit 2011, performanca e TKPK-së u përmirësua dukshëm në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke shënuar rritje të vlerës së aksioneve dhe kthimit në investime. Ngritje të performancës regjistruan edhe kompanitë e sigurimit, asetet e të cilave arritën vlerën prej 103.4 milionë euro. Në qershor 2011, sistemi i kompanive të sigurimit realizoi profit neto prej 1.2 milionë euro, për dallim nga viti i kaluar kur kishte realizuar humbje. Institucionet mikrofinanciare kanë vazhduar të zgjerojnë aktivitetin kredidhënës, mirëpo me një normë të rritjes më të ulët krahasuar me periudhat e kaluara. Gjithsej kreditë e lëshuara nga institucionet mikrofinanciare arritën vlerën prej 115.2 milionë euro në qershor 2011, që paraqet një rritje vjetore prej vetëm 1.2 përqind. Gjatë vitit 2011, në njërin nga institucionet më të mëdha mikrofinanciare që operojnë në vend u shfaqën probleme të qeverisjes së brendshme, që shtynë BQK-në të marrë këtë institucion nën administrim të përkohshëm, gjë që rezultoi me kthimin e normalitetit në këtë institucion financiar dhe përfundimin me sukses të administrimit.

Ky numër i Raportit të Stabilitetit Financiar po ashtu përmban disa analiza tematike, të cilat trajtojnë tema specifike që ndërlidhen me funksionimin e sistemit bankar në vend dhe më gjerë si dhe me ekonominë e vendit në përgjithësi. Temat specifike të prezantuara në këtë raport janë: 1. Anketa mbi Kreditimit Bankar për Kosovën; 2. Përcaktuesit e Kredive Joperformuese në Vendet e Tranzicionit; dhe 3. Përcaktuesit e Investimeve të Emigrantëve: a ka Hapësirë për Politikëbërje?

3. Zhvillimet Makroekonomike dhe Financiare në Ekonominë Botërore

Aktiviteti ekonomik global po përballlet me ngadalësim të rritjes në vitin 2011. Rreziqet makroekonomike në përgjithësi kanë shënuar rritje gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2011, përderisa dallimet në mes të rajoneve dhe vendeve vazhduan të rriten. Zhvillimet pozitive që karakterizuan ekonominë globale gjatë vitit 2010 nuk vazhduan edhe në vitin 2011. Rritja globale u ngadalësua në rreth 4 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 5.1 përqind në vitin 2010. Ngadalësimi i prodhimit industrial dhe tregtisë globale në vitin 2011, që ishin kontribuuesit kryesor në ngadalësimin e rritjes ekonomike në këtë periudhë, deri diku u ndikuan edhe nga tërmeti dhe cunami që kapluan Japoninë, si dhe nga rritja e çmimeve të produkteve të naftës si pasojë e problemeve politike dhe krizave nëpër të cilat kaluan këtë vit vendet e Lindjes së Mesme. Ngadalësimi i rritjes ekonomike ishte më i theksuar në vendet e zhvilluara, ku rënia e kërkesës së jashtme dhe rikthimi i pasigurisë dhe tensioneve në sektorin fiskal dhe financiar gjatë vitit 2011 kanë ndikuar në rënien e konsumit dhe investimeve. Edhe vendet në zhvillim pritet të karakterizohen me ngadalësim të rritjes ekonomike, pasi që rritja e fuqishme e kërkesës së brendshme në vitin 2010 pritet të frenohet nga politikat më të shtrënguara monetare.

Sipas projeksioneve të FMN-së, gjatë vitit 2011, rritja ekonomike në SHBA do të ngadalësohet në 1.5 përqind nga 3.0 përqind sa ishte në vitin 2010. Edhe parashikimet për eurozonën u rishikuan në gjysmën e dytë të vitit 2011. Eurozona pritet të rritet me 1.6 përqind në vitin 2011 krahasuar me rritjen prej 1.8 përqind në vitin 2010 (Tabela 1). Në mesin e vendeve të eurozonës, Gjermania dhe Italia pritet të karakterizohen me ngadalësim të rritjes për 0.9 përkatësisht 0.7 pp, përderisa norma e rritjes ekonomike në Francë në vitin 2011 pritet të jetë për 0.3 pp më e lartë se sa në vitin 2010. Sa i përket ekonomive në zhvillim, rritja pritet të ngadalësohet nga 7.3 përqind në 6.4 përqind. Trend më të ngadalëshëm të rritjes ekonomike pritet të shënojë Kina 9.5 përqind dhe India 7.8 përqind (10.3 përkatësisht 7.8 përqind në vitin 2010), përderisa Rusia pritet të shënojë rritje prej 4.3 përqind në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010 kur rritja ishte 4.0 përqind. Ngadalësimi i rritjes ekonomike sidomos në vendet e zhvilluara pritet të bartë pasojat në sektorin fiskal dhe financiar në nivel global në periudhat në vijim. Parashikimet për një trend më të ngadalshëm të rritjes do të vështirësojnë qëndrueshmërinë dhe tejkalimin e krizës së borxheve publike në sektorin fiskal, gjë që është reflektuar në rënien e shkallës së besueshmërisë në tregje, rritjen e kostos së financimit dhe rritjen e mundshme të kredive joperformuese.

Tabela 1. Indikatorët kryesorë makroekonomik

Përshkrimi	PBB		Inflacioni		Llogaria rrjedhëse (% e PBB-së)	
	2010	2011	2010	2011	2010	2011
Ekonomia botërore	5.1	3.9	4.2	4.6	0.5	0.7
SHBA	3.0	1.5	1.7	2.5	-3.2	-3.1
Eurozona	1.8	1.6	2.2	2.3	0.3	0.1
Vendet në zhvillim	7.3	6.4	6.7	7.0	1.9	2.4
Evropa Lindore dhe Qëndrore	4.5	4.3	5.2	5.5	-4.6	-4.2

Burimi: FMN (Shtator 2011)

Kriza e fundit financiare globale u pasqyrua në rritjen e vazhdueshme të borxhit publik në vendet e zhvilluara që nga viti 2008. Përderisa në eurozonë, SHBA dhe Japoni, rrezikimi i

financave publike ishte kryesisht pasojë e rënies së shkallës së të ardhurave nga taksat, parashikimeve për ngadalësim të rritjes ekonomike dhe mbështetjes së institucioneve të dobësuar financiare, disa nga vendet më periferike të Evropës u përballën me rritje të barrës së borxheve publike kryesisht si pasojë e keq menaxhimit të financave publike në periudhat e parakrizës. Këto zhvillime, plotësuar edhe nga parashikimet për një performancë më të dobët të sektorit real në vendet e zhvilluara, kanë ndikuar në rritjen e mëtejme të pasigurisë së pjesëmarrësve të tregut për qëndrueshmërinë e politikave fiskale dhe borxheve publike.

Në vitin 2010, shkalla e borxhit publik në eurozonë arriti në 85.4 përqind të PBB-së (25.4pp mbi kriterin e Maastricht-it). Shkallën më të lartë të borxhit publik në vitin 2010 raportoi Greqia (144.9 përqind të PBB-së), pasuar nga Italia (118.4 përqind e PBB-së), Irlanda (94.9 përqind e PBB-së) dhe Portugalia (93.3 përqind e PBB-së). Të dhënat e fundit tregojnë për një rritje të mëtejme të shkallës së borxhit publik në 86.1 përkatësisht 87.0 përqind të PBB-së në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2011. Përveç rritjes së borxhit qeveritar, këto vende u përballën po ashtu me një rritje të deficitit buxhetor, megjithëse deficitit buxhetor tregon për një tendencë rënëse në vitin 2011. Deficiti buxhetor në eurozonë arriti në 6.2 përqind të PBB-së në vitin 2010, nivel ky që tejkalon pragun prej 3 përqind të PBB-së të përcaktuar me kriteret e Maastricht-it. Probleme më të theksuara me deficit buxhetor në vitin 2010 raportuan Irlanda dhe Greqia (31.3 përkatësisht 10.6 përqind të PBB-së), duke mos përjashtuar Spanjën dhe Portugalinë (9.8 përkatësisht 9.3 përqind të PBB-së). Në përputhje me pritjet, deficitit buxhetor është karakterizuar me një trend rënës në gjatëmujorin e parë të vitit 2011. Deficiti buxhetor në eurozonë në tremujorin e parë të vitit 2011 rezultoi në 6.0 përqind të PBB-së, duke u zvogëluar më tutje në tremujorin pasues në 3.7 përqind të PBB-së.

Për të parandaluar thellimin e krizës fiskale, në mes të vitit 2010 vendet e BE-së vendosën të themelojnë Mekanizmin për Stabilitetin Financiar Evropian, që përmes Bankës Qendrore Evropiane (BQE) dhe FMN-së ndau një fond të posaçëm në shumë prej 750 miliardë euro, të akorduar mes Greqisë (110 miliardë euro), Irlandës (85 miliardë euro) dhe Portugalisë (78 miliardë euro). Edhe Japonia, Italia dhe Belgjika u përballën me sfidën për përballimin e rritjes së borxheve publike në vitin 2011, megjithëse qëndrueshmëria e borxheve në këto vende është konsideruar më lehtë e arritshme pasi që kreditorët në këto vende janë kryesisht institucionet vendore. Kreditorët në Greqi, Portugali dhe Spanjë janë kryesisht kreditorë të huaj, andaj edhe përmbushja në kohë e obligimeve ndaj tyre konsiderohet më sfiduese për këto vende duke pasur parasysh rënien e besueshmërisë në tregjet financiare. Takimi i fundit i vendeve të BE-së në korrik të vitit 2011 rezultoi me një pako që do t'i mbulojë nevojat për financim të Greqisë përmes uljes së normave të interesit dhe zgjatjes së periudhës për rikthimin e kredive që Greqia ka marrë nga vendet e BE-së dhe FMN-ja.

Rritja e rrezikut rreth qëndrueshmërisë së financave publike zgjuan edhe reagimin e tregjeve, që u manifestua kryesisht me rritje të primeve për borxhet publike dhe ulje të rejtingut kreditor për shtetet me probleme fiskale. Andaj, përkundër faktit se shumë shtete në eurozonë kanë raportuar për zvogëlim të suksesshëm të deficiteve buxhetore që nga viti i kaluar, diferenca në normat e huamarrjes (diferenca në mes të normës së interesit në obligacionin shtetëror dhe referencës - 'benchmark'-ut, në këtë rast 'Bund'-i apo fletëobligacionet shtetërore të Gjermanisë) është rritur dukshëm për disa nga këto vende.

Progresi i arritur për stabilizimin e sistemit financiar global është penguar nga vështirësitë fiskale dhe stresi i borxheve publike në vitin 2011, që ndikuan në rritjen e rrezikut në

tregje dhe kreditim. Shpërndarja e krizës së borxheve publike nga Greqia në Irlandë dhe Portugali, dhe pastaj në Spanjë, Belgjikë dhe Itali ka ndikuar në rritjen e shkallës së rrezikut sistemor në bankat që janë të ekspozuara ndaj këtyre vendeve. Bankat e vendeve të eurozonës që kanë vlera më të larta të borxheve publike të vlerësuara me rrezik më të madh janë karakterizuar me tendosje dhe performancë më të dobët. Gjithashtu, prishja e shumë garancioneve qeveritare, rënia e vlerës së letrave me vlerë të qeverive që janë mbajtur si kolateral dhe rënia e rejtingut të bankave po ndikon në mënyrë të vazhdueshme në rritjen e kostos së financimit me implikime negative për stabilitetin jo vetëm të sektorit bankar por të sistemit financiar në përgjithësi. Rritja e rrezikut kreditor në sistemin financiar nga borxhet publike mund të ketë efekte të mëtutjeshme negative në tregjet e financimit dhe rrjedhën e kredisë drejtë sektorit real. Përkundër ambientit të ndjeshëm ekonomik në vendet e eurozonës dhe rritjes së rreziqeve edhe për performancën e sistemit bankar, grupet kryesore bankare të cilat i kanë entitetet e tyre edhe në Kosovë, deri në qershor 2011, kanë shënuar përmirësim të performancës krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Kutia 1).


Kutia 1. Peformanca e Grupeve bankare të cilat operojnë në Kosovë ¹

Procredit Group - PCB (Gjermani)

Gjatë vitit 2010, PCB Group raportoi përmirësim në shumicën e treguesve financiarë krahasuar me vitin 2009, pavarësisht ambientit jo të favorshëm afarist si pasojë e krizës financiare. Në fund të vitit 2010, gjithsej asetet e PCB Group arritën në 5.18 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 4.8 përqind. Vlera e kredive bruto për konsumatorë arriti në 3.65 miliardë euro (rritje vjetore prej 9.3 përqind), ndërsa depozitat arritën në 3.22 miliardë euro (rritje vjetore prej 7.7 përqind). Te ardhurat operative shënuan rritje prej 0.2 përqind krahasuar me vitin 2009, duke arritur

në 378.9 milionë euro. Ndërsa, shpenzimet operative ishin për 0.3 përqind më të ulëta se sa në vitin 2009, duke shënuar vlerën prej 356.1 milionë euro. Zvogëlimi i shpenzimeve ishte rezultat e masave që ndërmori PCB Group për të zvogëluar numrin e punëtoreve (-20.5 përqind) si dhe numrin e degëve (-11.0 përqind). Si rrjedhojë, raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave në vitin 2010 u zvogëlua në 81.3 përqind, që paraqet një rënie vjetore prej 0.4 pp (Figura 1). PCB Group përfundoi vitin 2010 me profit neto të konsoliduar prej 12.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.9 përqind. Përkundër rritjes së profitit, niveli i treguesit të performancës që matet përmes kthimit në kapital (angl. Return on Equity: ROE) mbeti i pandryshuar në 3.8 përqind aq sa ishte edhe në vitin 2009 (Figura 2). PCB Group vazhdon të ketë nivel të kënaqshëm të kapitalizimit, që shprehur përmes treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR) arriti normën prej 16.5 përqind në vitin 2010 (16.2 përqind në vitin 2009). PCB Group përfundoi vitin 2010 me rejting të kreditimit BBB- (agjensioni Fitch), ngjashëm me atë të vitit 2009.

Figura 1. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave për grupet bankare, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të bankave përkatëse


¹ Të dhënat për grupet bankare janë marrë nga raportet vjetore për vitin 2010 si dhe raportet e tremujorit të dytë të vitit 2011 të grupeve bankare përkatëse.

Në gjysmën e parë të vitit 2011, PCB Group raportoi fitim neto të konsoliduar në vlerë prej 17.9 milionë euro, që paraqet një përmirësim të dukshëm të profitabilitetit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (-5.1 milionë euro në qershor 2010). Raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave në qershor të vitit 2011 qëndroi në 87.5 përqind, që është për 12.7 pp më i ulët krahasuar me qershor 2010. Ndërsa, treguesi mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi rënie në 15.9% (16.5% në qershor 2010). Në qershor 2011, asetet e ProCredit Bank në Kosovë përbënin 14.8 përqind të gjithëj aseteve të PCB Group.

Raiffeisen International - RBI (Austri)

Raiffeisen International (RBI) e përmbylli vitin 2010 me rezultate pozitive. Gjatë vitit 2010, gjithëj asetet e RBI shënuan një rritje vjetore prej 9.9 përqind, duke arritur në 131.17 miliardë euro. Vlera e përgjithshme e kredive bruto për konsumatorë arriti në 75.6 miliardë euro (rritje vjetore prej 4.3 përqind), ndërsa depozitat arritën në 57.6 miliardë euro (rritje vjetore prej 4.0 përqind). Gjatë kësaj periudhe, të ardhurat operative arritën në 5.4 miliardë euro (rritje prej 4.6 përqind). Po ashtu, shpenzimet operative shënuan rritje prej 9.8 përqind, duke arritur vlerën prej 2.9 miliardë euro. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave arriti në 55.1 përqind, duke shënuar rritje për 2.6 pp. RBI përfundoi vitin 2010 me profit të konsoliduar neto në shumën prej 1.08 miliardë euro, duke shënuar një rritje të konsiderueshme prej 141.6 përqind krahasuar me vitin 2009. Rritja e profitit ishte kryesisht rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve për provizione me 47.0 përqind. Në vitin 2010, ROE arriti në 12.5 përqind nga 6.4 përqind sa ishte në vitin 2009. RBI përfundoi vitin 2010 me rejting të kreditimit A (agjensioni Fitch) që është më i lartë se në fund të vitit 2009.² Në fund të vitit 2010, RBI kishte nivel të kënaqshëm të kapitalizimit me CAR prej 13.3 përqind (rënie për 0.2 pp). Çmimi për një aksion të RBI-së ishte 41.0 euro, përderisa kapitalizimi i bankës në bursën austriake arriti vlerën në 8.0 miliardë euro.

Figura 2. Kthimi ndaj kapitalit për grupet bankare, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të bankave përkatëse

RBI shënoi rritje të performancës edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Në qershor 2011, RBI raportoi profit të konsoliduar neto në vlerë prej 615 milionë euro, që është për 30.3 përqind më i lartë se sa profiti i realizuar gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Rritja e profitit ndikoi pozitivisht edhe në rritjen e ROE-s, që arriti në 13.2 përqind (10.9 përqind në qershor 2010). Ndërsa, raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave arriti në 55.1 përqind, krahasuar me 53.0 përqind në qershor 2010. CAR u zvogëlua për 0.3 pp, duke shënuar normën prej 13.0 përqind. Në qershor 2011, Raiffeisen Bank Kosovo përbënte 0.48 përqind të gjithëj aseteve të Raiffeisen International.

RBI shënoi rritje të performancës edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Në qershor 2011, RBI raportoi profit të konsoliduar neto në vlerë prej 615 milionë euro, që është për 30.3 përqind më i lartë se sa profiti i realizuar gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Rritja e profitit ndikoi pozitivisht edhe në rritjen e ROE-s, që arriti në 13.2 përqind (10.9 përqind në qershor 2010). Ndërsa, raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave arriti në 55.1 përqind, krahasuar me 53.0 përqind në qershor 2010. CAR u zvogëlua për 0.3 pp, duke shënuar normën prej 13.0 përqind. Në qershor 2011, Raiffeisen Bank Kosovo përbënte 0.48 përqind të gjithëj aseteve të Raiffeisen International.

NLB Group (Slloveni)

Në fund të vitit 2010, vlera e gjithëj aseteve të NLB Group ishte 17.8 miliardë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 9.0 përqind. Kreditë bruto për konsumatorë shënuan vlerën prej 13.0 miliardë euro (rënie vjetore prej 1 përqind). Po ashtu, depozitat shënuan rënie vjetore prej 3.0 përqind, duke rënë në 10.3 miliardë euro. Gjatë kësaj periudhe, NLB Group raportoi të ardhura operative në vlerë prej 639.2 milionë euro, të cilat paraqesin nivel të ngjashëm me vitin paraprak. Ndërsa, shpenzimet operative arritën vlerën prej 393.1 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 5 përqind krahasuar me vitin 2009. Raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave shënoi rënie nga 65.0 përqind në vitin 2009 në 61.5 përqind në vitin 2010. Profiti i konsoliduar neto për vitin 2010 shënoi vlerën prej -202.3 milionë


² Në përmirësimin e rejtingut të RI, përveç performancës pozitive, ndikim kishte edhe bashkimi i operacioneve me RZB Group.

euro, që paraqet rënie të mëtejme krahasuar me vitin 2009 kur ishte -86.8 milionë euro. Dobësimi i performancës së NLB Group në masë të madhe u ndikua nga rritja e provizioneve për humbje nga kreditë. Në dhjetor 2010, provizionet për humbje nga kreditë u rritën në 477 milionë euro nga 315 milionë sa ishin në dhjetor 2009. Rënia e profitit u reflektua edhe në ROE, që në vitin 2010 qëndroi në -17.5 përqind (-6.8 përqind në 2009). Në fund të vitit 2010, CAR për NLB Group ishte 10.2 përqind ose për 0.5 pp më e ulët se sa në vitin 2009. Gjatë kësaj periudhe, dobësimi i performancës ndikoi edhe në uljen e rajtingut të NLB Group nga A1 në A3 (Moodies).

Në pjesën e parë të vitit 2011, NLB Group arriti deri diku të konsolidojë operacionet bankare, duke raportuar profit të konsoliduar neto në vlerë prej 0.9 milionë euro (qershor 2011), krahasuar me -34.6 milionë euro (qershor 2010). Niveli pozitiv i profitit u reflektua edhe në indikatorin e profiabilitetit ROE, që arriti në 0.2 përqind (qershor 2011), krahasuar me -5.8 përqind (qershor 2010). Zhvillim pozitiv shfaqti edhe raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave, i cili u zvogëluar në 59.8 përqind nga 62.5 përqind sa ishte në qershor 2010. Në gjysmën e parë të vitit 2011, NLB Group me sukses arriti ta rrisë kapitalin për 250 milionë euro. Kjo rritje e kapitalit u reflektua edhe në përmirësimin e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR), që në qershor 2011 u ngrit në 12.1 përqind, krahasuar me 10.7 përqind në qershor 2010. Në qershor 2011, NLB Prishtina përbënte 2.04 përqind të gjithëj aseteve të NLB Group.


Rrjedha e kredisë në shumicën e vendeve të zhvilluara vazhdon të jetë në nivele të ulëta, dhe atë sidomos në vendet që po përballen me krizë buxhetore, ku bankat po përballen me vështirësi në sigurimin e financimit me kosto të ulët. Për më tepër, humbjet potenciale nga investimet në fletëobligacionet qeveritare po i detyrojnë bankat të zvogëlojnë asetet, gjë që poashtu po reflektohet në ngadalësimin e kreditimit në ekonomi. Gjatë kësaj periudhe, bankat në shumicën e vendeve të Evropës u karakterizuan poashtu me përkeqësim të cilësisë së portofolit kreditor (Figura 3). Sidoqoftë, në shumicën e vendeve të eurozonës si dhe në SHBA, bankat raportuan përmirësim në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit (Figura 4). Mirëpo, në vendet si Irlanda, Spanja, Greqia dhe Portugalia edhe pse është regjistruar përmirësim në nivelin e kapitalizimit, ende janë disa banka të cilat mund të përballen me vështirësi duke marrë parasysh se kanë investuar mjete të shumta në fletëobligacionet qeveritare si dhe në patundshmëri. Në Mbretërinë e Bashkuar, bankat po përballen me zhvlerësim të aseteve që nga fillimi i krizës, por duke marrë

Figura 3. Norma e kredive jopërfomuese në vende të zgjedhura të eurozonës



Burimi: BQK (2011)

Figura 4. Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit në vende të zgjedhura të eurozonës



Burimi: BQK (2011)

parasysh se niveli i profitabilitet është i kënaqshëm sistemi bankar në tërësi është mjaft mirë i kapitalizuar. Qështja e kapitalizimit të bankave, duke qenë se përfaqëson shtyllë shumë të rëndësishme të qëndrueshmërisë së sistemit bankar, ka marrë trajtim të veçantë edhe në pakon e re rregullative për sistemin bankar të quajtur Bazel III, e cila synon të avancojë edhe më tepër kornizën e përgjithshme rregullative për sistemin bankar (Kutia 2).

Kutia 2. Reformimi i kornizës rregullative të sistemit bankar përmes Bazel III


Kriza financiare që filloi gjatë vitit 2007 dhe që shkaktoi lëkundje ekonomike dhe humbje të mëdha në tregjet financiare detyroi bankat qendrore të shumë vendeve të rishikojnë dhe të përmirësojnë rregullativën aktuale financiare. Si rrjedhojë, Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Bankare, që operon nën ombrellën e Bankës për Marrëveshje Ndërkombëtare (angl. Bank for International Settlements - BIS) propozoi një pako të rekomandimeve për ndryshimin e kornizës ekzistuese rregullative të quajtur Bazel II. Kjo pako e rekomandimeve, e njohur si Bazel III, u publikua në dhjetor 2010, me qëllimin kryesor që të fuqizojë rregulloret, mbikëqyrjen si dhe menaxhimin e rrezikut në sistemin bankar. Ndryshimet në kornizën rregullative të Bazelit janë të fokusuar në nivelin mikro dhe makro. Në nivelin mikro, prioriteti është dhënë aplikimit të standardeve të reja për përmirësimin e cilësisë së kapitalit, prezantimit të një standardi global për likuiditetin, si dhe plotësimin të treguesve të kapitalit edhe me treguesin e shkallës së levës (Figura 5).³ Ndërsa, në nivelin makro, ndryshimet u përqendruan në zvogëlimin e shkallës së prociklizimit si dhe në adresimin e rrezikut sistemor.

Pjesa e parë e rekomandimeve ndërlidhet me ndryshimet në kapitalin e mbajtur. Qëllimi parësor i këtyre ndryshimeve është përmirësimi i kapitalit bankar si për nga cilësia ashtu edhe për nga vëllimi, në mënyrë që të rritet Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR). Në kuadër të komponenteve të kapitalit bankar, përparësi do të jepet rritjes së kapitalit aksionar, ndërsa do të limitohet përdorimi i instrumenteve hibride financiare dhe borxhit të ndërvarur si pjesë e kapitalit fillestar. Po ashtu, do të shtrëngohen kriteret në përllogaritjen e Aseteve të Peshuara ndaj Rrezikut (angl. Risk Weighted Assets: RWA).

Bazel III rekomandon që bankat përveç kapitalit ekzistues (kapitali i klasit të parë dhe kapitali i klasit të dytë) të ndajnë edhe dy nivele shtesë të kapitalit, të përbërë nga mbulesa e konzervimit (angl. conservation buffer) dhe mbulesa kundërciklike (angl. countercyclical buffer). Të dy këto ndryshime kanë për qëllim të reduktojnë sjelljen prociklike të bankave gjatë periudhave të lëkundjeve ekonomike, kur tronditjet e mundshme negative për ekonominë e një vendi do të mund të thelloheshin edhe më tepër si pasojë e shtrëngimit eventual të kredidhënies nga bankat komerciale. Po ashtu, këto masa synojnë të paraqesin kufizime për bankat edhe për sa i përket shpërndarjes së profitit në formë të dividendës, duke i shtyrë ato të mbajnë nivele shtesë të kapitalit për të mbuluar humbjet potenciale.

Përveç ndryshimeve në përllogaritjen e komponentëve ekzistues të kapitalit, përmes Bazel III rekomandohet që raportimi mbi treguesit e kapitalit të plotësohet me një indikator të ri, gjegjësisht Treguesin e Shkallës së Levës (angl. Leverage Ratio). Sipas këtij rekomandimi, raporti ndërmjet kapitalit të klasit të parë dhe shumës së asetëve dhe zërave jashtëbilancorë të bankës duhet të

Figura 5. Skema Bazel III



Burimi: BIS

³ Publikimet e Bank for International Settlements (BIS).

mirëmbahet në një nivel prej minimum tre përqind. Përmes këtij treguesi, bankat do të detyrohen që të reduktojnë financimin e bilancit të gjendjes përmes borxhit të jashtëm.

Përveç ndryshimeve në standardet për caktimin e nivelit të kapitalit të sistemit bankar, Bazel III rekomandon edhe implementimin e dy standardave kuantitative që kanë për qëllim përmirësimin e menaxhimit dhe forcimin e pozitës së likuiditetit. Këto dy standarde do të implementohen përmes raportimit të dy indikatorëve të ri, që përbëhen nga Treguesi i Mbulueshmërisë së Likuiditetit (angl. Liquidity Coverage Ratio: LCR) dhe Treguesi i Financimit Stabil Neto (angl. Net Stable Funding Ratio: NSFR). LCR ka për qëllim forcimin e pozitës së likuiditetit në periudha kohore afatshkurtëra, duke obliguar bankat që të mbajnë shuma të mjaftueshme të aseteve të cilësisë së lartë për të mbuluar daljen e parasë neto (angl. Net Outflow of Money) nën supozimin e një stres-skenari që të do të zgjaste për rreth 30 ditë. Ndërsa, treguesi NSFR obligon bankat që të sigurojnë financimin përmes fondeve më të sigurta dhe më stabile për të financuar kreditimin afatgjatë. Kjo nënkupton që bankat duhet të përqendrohen në zvogëlimin e dallimit ndërmjet afatit të maturimit të aseteve dhe afatit të maturimit të detyrimeve.

Tabela 2. Periudha kohore për implementimin e Bazel III⁴

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Kërkesat CET1	Implementimi gradual 3.5%	Implmentimi gradual 4%	Implementimi final 4.5%				
Kapitali i klasit të I-rë	Implementimi gradual 4.5%	Implementimi gradual 5.5%	Implementimi final 6%				
Kërkesat e gjithsejt kapitalit	Implementimi final 8.0%						
Kapitali si mbulesë e konzerimit				Implementimi gradual 0.65%	Implementimi gradual 1.25%	Implmentimi gradual 1.875%	Implementimi final 2.5%
Përfshirja e zbritjeve te reja nga baza e kapitalit		Implementimi gradual 20%	Implementimi gradual 40%	Implementimi gradual 60%	Implementimi gradual 80%	Implementimi final 100%	
Shkalla e leves	Vështrimi	Vështrimi	Publikimi			Implementimi final	
Treguesi i Mbulueshmërisë së Likuiditetit	Vështrimi	Vështrimi	Implementimi final				
Treguesi i Financimit Stabil Neto	Vështrimi	Vështrimi	Vështrimi	Vështrimi	Vështrimi	Implementimi final	

Burimi: Riksbank (2010)

Pjesa e fundit e rekomandimeve, e cila ka të bëjë me aspektin makro, përqendrohet në zvogëlimin e prociklikalishtetit si dhe adresimin e rrezikut sistemor. Sidoqoftë, për shkak të natyrës komplekse të këtyre çështjeve, platforma makro e Bazel III ende nuk është përfunduar dhe nevojitet edhe një periudhë kohore për të pasur një konkretizim më të madh të kësaj platforme.

Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen e Bankave ka miratuar edhe periudhën transitore për aplikimin gradual të masave të rekomanduara si dhe periudhën kur zbatimi i tyre duhet të jetë efektiv (Tabela 2). Standardet e reja për nivelin e kapitalit dhe të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit duhet të fillojnë që të aplikohen gradualisht nga viti 2013, ndërsa duhet të finalizohen në vitin 2019. Bankat do të duhet të fillojnë të publikojnë standardin mbi shkallën e levës në vitin 2015, kurse implementimi final do të bëhet në vitin 2018. Sa i përket standardeve për menaxhimin e likuiditetit, LCR do të ketë një periudhë të monitorimit nga viti 2013-2014, ndërsa implementimi final parashihet të bëhet në vitin 2015. Po ashtu, NSFR do të ketë një periudhë të monitorimit që do të zgjasë nga viti 2013 deri në vitin 2017, ndërsa implementimi final parashihet të bëhet në vitin 2018. Rekomandimet e Bazel III pritet të miratohen në formë të Ligjit për vendet anëtare të BE-së.

Për sa i përket performancës së tregjeve financiare, bursat në SHBA dhe Eurozonë u karakterizuan me rritje të performancës. Në qershor 2011, indeksi i tregjeve të aksioneve në SHBA (Standard&Poor's 500) dhe indeksi i tregjeve të aksioneve që përfshinë bursat

⁴ Raporti i Stabilitetit Financiar, Riksbank, 2:2010.

evropiane (Dow Jones Euro Stoxx) shënuan ngritje prej 4.7 përkatësisht 18.8 përqind krahasuar me qershor 2010. Ndërsa, ai japonez (Nikkei 225 Stock Average Index) shënoi rënie prej 2.5 përqind në krahasim me qershor 2010. Performanca e bursës japoneze në masë të madhe u ndikua nga tërmeti i cili ndodhi në mars të vitit 2011.

Në prill 2011, Banka Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank: ECB) vendosi ta rrisë normën bazë të interesit për 0.25 pp në 1.25 përqind. Norma e bazë e interesit nuk ishte ndryshuar që nga maji i vitit 2009. ECB vendosi ta rrisë normën bazë të interesit si rrjedhojë e presioneve të shtuara inflacioniste në ekonominë e eurozonës. Rrija e normës bazë të interesit u reflektua edhe në rritjen e normës marginale të huadhënies dhe depozitave në 2.0 përqind (1.75 përqind) përkatësisht 0.5 përqind (0.25 përqind). Ndërsa, normat e financimit të vendosura nga Rezerva Federale e SHBA-ve (angl. Federal Reserve) vazhduan të qëndrojnë në intervalin 0.00 - 0.25 përqind.

Lëkundjet në tregjet financiare ndikuan në rritjen e kostos së financimit në tregjet ndërbankare. Në qershor 2011, norma e interesit për financim ndërbankar në euro EURIBOR (3 muaj) u dyfishua në 1.488 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur ishte 0.727 përqind. Po ashtu, norma e interesit për financim ndërbankar në sterlina britanike LIBOR GBP (3 muaj) shënoi rritje, duke arritur në 0.825 përqind (0.728 përqind në qershor 2010). Norma e interesit për financim ndërbankar në dollar amerikan LIBOR USD (3 muaj) shënoi rënie nga 0.536 përqind në 0.247 përqind.

Ekonomia botërore është karakterizuar me rritje të shkallës së inflacionit, veçanërisht në gjysmën e parë të vitit 2011. Në gjysmën e dytë të vitit 2011, vendet e zhvilluara u karakterizuan me ngadalësim të rritjes së shkallës së inflacionit, përderisa në vendet në zhvillim presionet inflacioniste ishin të pranishme edhe gjatë kësaj periudhe. Nxitur kryesisht nga rritja e çmimit të produkteve të naftës që u reflektuan në rritje të çmimit të energjisë dhe ushqimeve, presionet inflacioniste shënuan rritje në fillim të vitit 2011. Rënia e çmimit të naftës dhe si rrjedhojë edhe rënia e çmimeve të ushqimit dhe energjisë në pjesën e dytë të vitit kanë ndikuar në rënien e shkallës së inflacionit si në SHBA, ashtu edhe në eurozonë. Shkalla e inflacionit në nivel global për vitin 2011 pritet të jetë më e lartë krahasuar me vitin paraprak. Përderisa në nivel global, shkalla e inflacionit pritet të jetë 4.6 përqind (4.2 përqind në vitin 2010), inflacioni në SHBA pritet të arrijë në 2.5 përqind në vitin 2011 (1.7 përqind në vitin 2010), në eurozonë 2.3 përqind (2.2 përqind në vitin 2010), në vendet në zhvillim 7.0 përqind (6.7 përqind në vitin 2010), dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore 5.5 përqind (5.2 përqind në vitin 2010).

Ngadalësimi i rritjes së eksporteve në nivel global gjatë vitit 2011 ka ndikuar në përkeqësimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse në këtë periudhë. Eksportet në nivel global pritet të rriten me 6.1 përqind në vitin 2011 krahasuar me rritjen prej 7.3 përqind në vitin 2010. Si pasojë, deficitin në llogarinë rrjedhëse në nivel global pritet të rritet në 0.7 përqind të PBB-së në vitin 2011 (0.5 përqind e PBB-së në vitin 2010). Rritja e eksporteve pritet të shënojë ngadalësim si në vendet e eurozonës (3.9 pp në 2011 krahasuar me vitin 2010) ashtu edhe në vendet në zhvillim (4.2 pp në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010). Megjithatë, nga Tabela 1 shohim se përkeqësimi i llogarisë rrjedhëse ishte më evident në vendet në zhvillim që priten të shënojnë rritje të deficitit nga 1.9 përqind në vitin 2010 në 2.4 përqind në vitin 2011.

Shkalla e papunësisë në vendet e eurozonës pritet të ndikohet negativisht nga ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vitin 2011. Të dhënat aktuale tregojnë për një zvogëlim të normës së papunësisë në SHBA në 9.1 përqind në qershor 2011 (9.6 përqind në vitin 2010), 4.8

përqind në Japoni (5.1 përqind në vitin 2010), 4.0 përqind në Kinë (4.1 përqind në vitin 2010) dhe 7.3 përqind në Rusi (7.5 përqind në vitin 2010). Në eurozonë, shkalla e papunësisë mbeti në nivel të ngjashëm me vitin paraprak në 10.1 përqind në qershor 2011. Nga vendet e eurozonës, Gjermania pritet të shënojë rënie të shkallës së papunësisë prej 1.1 pp në vitin 2011, pasuar nga Franca me rënie të shkallës së papunësisë prej 0.3 pp në të njëjtën periudhë. Me rritje të shkallës së papunësisë në vitin 2011 pritet të karakterizohen Greqia, Portugalia dhe Spanja, kryesisht si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik që pritet të përfshijë këto vende.

Sa i përket kursit të këmbimit, euro është vlerësuar gjatë periudhës Janar - Prill, përderisa pas muajit maj e deri në shtator euro ndërroi kahjen, duke u zhvlerësuar ndaj shumicës së valutave kryesore. Lëvizjet e valutës euro kundrejt valutave tjera të mëdha kryesisht reflektojnë ndryshimet e perceptimeve të tregut për perspektivën ekonomike dhe fiskale të vendeve të eurozonës. Zhvlerësimi i euros nga maji ishte kryesisht pasojë e rikthimit të pasigurisë për shkak të rritjes së rrezikut nga vështirësitë fiskale me të cilat u ballafaquan disa nga vendet e eurozonës. Norma reale efektive e këmbimit të euros bazuar në çmimet e konsumit ishte përafërsisht e njëjtë me mesataren e vitit 2010, përderisa vlerësimi i lehtë nominal i euros në pjesën e parë të vitit është neutralizuar nga shkalla më e ulët e inflacionit në eurozonë krahasuar me vendet tjera.

3.1. Evropa Juglindore

Që nga gjysma e dytë e vitit 2010, vendet e Evropës Juglindore (EJL) kryesisht u karakterizuan me rikuperim të aktivitetit ekonomik. Pjesa më e madhe e këtyre vendeve treguan prirje për zgjerim të aktivitetit ekonomik, mirëpo rritja ekonomike nuk ishte e njëtrajtshme në mes të këtyre vendeve. Deri në mars 2011, rritja mesatare e PBB-së sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian për gjithë rajonin ishte 2.8 përqind, rritje kjo e nxitur kryesisht nga rritja e eksporteve që rezultoi nga rikuperimi i kërkesës së përgjithshme dhe prodhimit industrial në nivel global. Në kuadër të vendeve të EJL-së, Maqedonia shënoi rritjen më të lartë të PBB-së në tremujorin e fundit të vitit 2010 dhe tremujorin e parë të vitit 2011 (4.5 përqind), përderisa Kroacia ishte vendi i vetëm që vazhdoi të raportojë rënie ekonomike (-0.7 përqind). Parashikimet për zhvillimet e aktivitetit ekonomik në EJL për gjysmën e dytë të vitit 2011 dhe për vitin 2012 mbeten modeste, përderisa rajoni vazhdon të jetë i ndjeshëm ndaj zhvillimeve në ekonominë e eurozonës në aspektin e tregtisë, investimeve të huaja direkte (IHD-ve), pjesëmarrjes së lartë të bankave të huaja dhe dërgesave të emigrantëve.

Stabilizimi i kërkesës së brendshme në vendet e rajonit pritet të ndikojë në fillimin e stabilizimit të gjendjes edhe në tregun e punës. Megjithatë, vlerësimet e fundit tregojnë për një shkallë mesatare të papunësisë në EJL prej 25.5 përqind, një shkallë e përafërt me vlerësimet për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Recesioni që vazhdoi të karakterizojë ekonominë e Kroacisë ndikoi që ky vend të shënojë rritje të shkallës së papunësisë deri në mars të vitit 2011 (14.3 përqind në tremujorin e parë të vitit 2011 krahasuar me 11.8 përqind në vitin 2010). Shkalla më e lartë e papunësisë vazhdon të raportohet nga Kosova (me rreth 45 përqind), Bosnja dhe Hercegovina (42.7 përqind) dhe Maqedonia (31.1 përqind). Sipas Bankës Botërore, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011 u humbën afërsisht

7,000 vende pune në Maqedoni përderisa në Serbi, gjatë periudhës tetor 2010- prill 2011 u humbën mbi 100,000 vende pune.⁵

Rritja e aktivitetit ekonomik në EJL vazhdoi të mbështetet kryesisht në rritjen e eksporteve. Stabilizimi i kërkesës në eurozonë në tremujorin e parë të vitit 2011 u reflektua në një rritje vjetore të eksporteve prej mesatarisht 46.7 përqind, përderisa në tremujorin e parë të vitit paraprak eksportet shënuan rritje vjetore prej 16.1 përqind. Megjithatë, rritja e çmimeve të naftës dhe ushqimeve në gjysmën e parë të vitit 2011 në nivel global është pasqyruar edhe në rritjen e importeve në pjesën më të madhe të vendeve të EJL-së në këtë periudhë. Si rrjedhojë, shkalla e deficitit të llogarisë rrjedhëse mbetet e lartë në këto vende. Përveç Malit të Zi dhe Serbisë që u karakterizuan me zvogëlim të shkallës së deficitit të llogarisë rrjedhëse në fillim të vitit 2011 krahasuar me vitin 2010, të gjitha vendet e tjera u përballën me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vendet e rajonit u përkeqësua edhe si pasojë e zvogëlimit të transfereve rrjedhëse në shumicën e vendeve të rajonit. Vlerësimet për tremujorin e parë të vitit 2011 tregojnë për një shkallë mesatare të deficitit të llogarisë rrjedhëse prej 9.3 përqind në vendet e EJL-së, përderisa kjo normë në vitin 2010 qëndroi në 9.1 përqind. Mali i Zi dhe Kosova vazhdojnë të raportojnë normat më të larta të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Sa i përket Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në rajon, në tremujorin e parë të vitit 2011 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është vënë re tendencë ngadalësimi. Në tremujorin e parë të vitit 2011, shkalla mesatare e IHD-ve për rajonin në raport me PBB-në ishte 6.0 përqind, krahasuar me 7.9 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë në vitin 2010.

Sa i përket bilancit buxhetor dhe arritjes së qëndrueshmërisë së borxhit qeveritar, në shumë prej vendeve të rajonit rritja e të hyrave buxhetore si rrjedhojë e rritjes së aktivitetit ekonomik ka rezultuar në përmirësimin e bilancit buxhetor. Kroacia dhe Shqipëria u karakterizuan me rritje më të shpejtë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat buxhetore, gjë që ndikoi në zgjerimin e deficitit të tyre buxhetor. Norma mesatare e deficitit buxhetor në EJL shënoi rënie nga 3.9 përqind e PBB-së në vitin 2009 në 3.7 përqind të PBB-së në vitin 2010. Në gjysmën e parë të vitit 2011, shkalla mesatare e deficitit buxhetor në vendet e EJL-së ka qenë rreth 2 përqind e PBB-së. Në qershor 2011, shkallën më të lartë të deficitit buxhetor e shënoi Serbia (3.0 përqind të PBB-së), pasuar nga Shqipëria (2.1 përqind e PBB-së), Maqedonia (1.7 përqind e PBB-së) dhe Mali i Zi (1.5 e PBB-së). Përrjashtim bën Kosova, që në qershor 2011 shënoi suficit prej 1.1 përqind të PBB-së. Në periudhën e njëjtë, norma mesatare e borxhit qeveritar në EJL në raport me PBB-në ishte 38.4 përqind, me Shqipërinë dhe Malin e Zi që raportojnë shkallën më të lartë të borxhit prej 58.2 përkatësisht 51.3 përqind të PBB-së, përderisa Kosova raporton shkallën më të ulët të borxhit qeveritar në rajon me vetëm 6.9 përqind të PBB-së. Për të evituar problemet në sektorin fiskal, Serbia emetoi një bono globale prej 1 miliard dollar amerikan si dhe kishte në dispozicion huamarrjen e garantuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në fillim të vitit 2011 në vlerë prej 400 milion dollar amerikan. Në prill të vitit 2011, Mali i Zi emetoi një Eurobond në vlerë prej 180 milion euro, përderisa Maqedonia përfitoi nga kredia e FMN-së në vlerë prej 220 milion euro në mars të vitit 2011 si dhe pritet të përfitoj nga një hua prej 130 milion euro përmes një garancioni nga BERZH-i në fund të vitit.

⁵ Evropa Juglindore: Raporti i Zhvillimeve Ekonomike, Banka Botërore, 2011.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, pothuajse të gjitha vendet e EJL-së u përballën me presione inflacioniste që kryesisht ishin reflektim i rritjes së çmimeve të naftës dhe ushqimit në nivel global, si dhe çmimeve të prodhimit në nivel lokal. Në maj 2011, shkalla mesatare e Indeksit të Çmimeve të Konsumit (angl. Consumer Price Index: CPI) në EJL arriti në 6.2 përqind, krahasuar me 1.9 përqind në maj 2010. Serbia vazhdoi të karakterizohet me shkallën më të lartë të inflacionit në rajon (13.4 përqind), ndërsa shkallën më të ulët të inflacionit gjatë kësaj periudhe e raportoi Kroacia (2.5 përqind). Në Kosovë, inflacioni vjetor për muajin maj arriti në 10.4 përqind.

Sa i përket kursit të këmbimit ndërmjet valutave të vendeve të EJL-së dhe euros, në qershor 2011 krahasuar me periudhën e njëjtë në vitin paraprak, leku shqiptar u zhvlerësua kundrejt euros me 2.2 përqind, duke arritur në 139.60 lekë/euro, pasuar nga kuna kroate që u zhvlerësua me 2.5 përqind (7.41 HKR/euro). Në të njëjtën periudhë kohore, dinari serb u vlerësua për 4.4 përqind kundrejt euros (99.13 dinar/euro), pasuar nga denari maqedon që poashtu u vlerësua kundrejt euros për 0.9 përqind në qershor 2011 (60.98 den/euro).

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, pothuajse të gjitha vendet në EJL u karakterizuan me performancë të mirë të tregjeve financiare. Në qershor 2011, krahasuar me qershorin e vitit 2010, indekset e tregjeve të Maqedonisë (MBID), Kroacisë (COBEX) dhe Serbisë (BELEXline) shënuan ngritje prej 6.3, përkatësisht 20.2 dhe 12.1 përqind. Përjashtim në këtë mes bën Mali i Zi (MONEX20), indeksi i të cilit tregon për rënie të vlerës së aksioneve për 10.2 përqind në periudhën e njëjtë.

Për dallim nga viti 2010, shumica e vendeve të rajonit kanë zgjeruar aktivitetin e tyre kreditues, përderisa depozitat vazhduan të karakterizohen me normë më të ngadalshme të rritjes. Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2011 tregojnë se, me përjashtim të Malit të Zi që pësoi zvogëlim të kredive, të gjitha vendet tjera kanë shënuar rritje të përshpejtuar të kreditimit. Sipas të dhënave të Komisionit Evropian, rritja më e lartë e normës së kreditimit në tremujorin e parë të vitit 2011 është regjistruar në Serbi (22.0 përqind), Kosovë (13.2 përqind), Shqipëri (9.6 përqind) dhe Maqedoni (7.3 përqind), përderisa Mali i

Tabela 3. Rritja vjetore e kredive dhe depozitave

Përshkrimi	Shqipëria		BiH		Kroacia		Maqedonia		Mali i Zi		Serbia		Kosova	
	TM1 2010	TM1 2011	TM1 2010	TM1 2011	TM1 2010	TM1 2011	TM1 2010	TM1 2011	TM1 2010	TM1 2011	TM1 2010	TM1 2011	TM1 2010	TM1 2011
Kreditë	8.9	9.6	-3,1	4.2	-0,7	6.0	2.7	7.3	-12,2	-11,2	22.5	22.0	8.2	13.5
Depozitat	12.2	15.9	2.2	4.1	-25,7	-1,4	9.6	12.8	0.4	0.9	21.9	9.3	22.4	8.2

Burimi: Komisioni Evropian, Raporti i tremujorit të tretë 2011.

Zi raportoi rënie prej 11.2 përqind të kredive. Rritje më të shpejtë shënuan kreditë për ekonominë familjare, duke mos lënë anash edhe rritjen e kreditimit të sektorit privat në të njëjtën periudhë. Sa i përket normës së rritjes së depozitave, Serbia dhe Kosova raportuan ngadalësim të rritjes, përderisa Shqipëria u veçua me normë të rritjes prej 15.9 përqind në tremujorin e parë të këtij viti, pasuar nga Maqedonia (12.8 përqind) (Tabela 2). Përmirësim të moderuar të normës së rritjes së depozitave raportuan edhe Kroacia dhe Mali i Zi. Sistemet bankare në EJL u karakterizua me përkeqësim të cilësisë së portofolit kreditor gjatë kësaj periudhe. Në tremujorin e parë të vitit 2011, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia raportuan normat më të larta të kredive joperformuese në rajon, me 14.4, 11.7 përkatësisht 9.4 përqind. Shkallën më të ulët të kredive joperformuese vazhdon të raportojë Kosova, me vetëm 5.9 përqind në qershor 2011.


4. Ekonomia e Kosovës

Ekonomia e Kosovës vazhdon të jetë njëra ndër ekonomitë me normën më të lartë të rritjes në rajon. Burimet kryesore të financimit për aktivitetin ekonomik në vend gjatë gjysmës së parë të vitit kanë treguar performancë më të mirë, duke i kontribuar kështu pozitivisht performancës së përgjithshme të ekonomisë së vendit (Figura 6). Në këtë kontekst, përmirësimi i performancës së ekonomisë globale

bëri që eksportet të vazhdojnë të rriten, përderisa edhe dërgesat e emigrantëve shënuan normë pozitive të rritjes. Aktiviteti i sektorit privat vazhdoi të përkrahet nga kreditë e sistemit bankar, të cilat gjatë kësaj periudhe vazhduan të rriten me trend të përsheptuar, gjë që paraqet një sinjal të mirë edhe për shkallën e stabilitetit të ekonomisë së vendit. Në anën tjetër, sektori publik vazhdon të jetë një pjesëmarrës i rëndësishëm në ekonominë e vendit, me shpenzimet publike, veçanërisht ato kapitale, të cilat po rriten vazhdimisht.

Sidoqoftë, stabiliteti makroekonomik në Kosovë vazhdon të sfidohet nga problemi kryesor për ekonominë e vendit, që është norma e lartë e papunësisë, e cila nuk po arrin të zvogëlohet përmes normës aktuale të rritjes ekonomike në vend. Si rezultat i mbështetjes së lartë të ekonomisë së Kosovës në importin e mallrave nga jashtë, Kosova vazhdon të karakterizohet me deficit të lartë tregtar, i cili paraqet shkaktarin kryesor për shkallën e lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse në vend. Përkundër rritjes së eksporteve, vazhdimi i rritjes së importeve ka bërë që deficitin e llogarisë rrjedhëse të vazhdojë të rritet gjatë vitit 2011. Ekonomia e Kosovës gjatë këtij viti po ballafaqohet edhe me presione inflacioniste, të cilat janë më të theksuara në krahasim me vitin e kaluar. Inflacioni në Kosovë është treguar mjaft i luhatshtë në vitet e fundit, duke pasqyruar në masë të madhe zhvillimet e çmimeve në tregjet e jashtme, lidhshmëri kjo që rrjedhë nga shkalla e lartë e mbështetjes së ekonomisë së vendit në mallrat e importuara nga jashtë.

Figura 6. Harta Makroekonomike



3.1. Sektori real

3.1.1. Produkti i brendshëm bruto

Zhvillimet ekonomike në gjashtë muajtë e parë të vitit 2011 sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në Kosovë po vazhdon të zgjerohet dhe, si rezultat, rritja reale ekonomike për vitin 2011 parashikohet të jetë rreth 5.0 përqind (3.9 përqind në vitin 2010). Në terma nominal, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) gjatë vitit 2011 pritet të tejkalojë shumë prej 4.7 miliardë euro. Konsumi vazhdon të paraqes komponentën kryesore të PBB-së, duke arritur një pjesëmarrje prej rreth 107 përqind të PBB-së. Sidoqoftë, raporti ndërmjet konsumit dhe PBB-së vazhdon të zvogëlohet, gjë që kryesisht është rezultat i rritjes së investimeve në vend, të cilat përbëjnë rreth 35 përqind të PBB-së. Struktura e përgjithshme e konsumit dominohet nga konsumi i sektorit privat, ndërsa pjesëmarrja e konsumit publik ka shënuar rënie.


Rritja e kredive të sistemit bankar, shpenzimeve qeveritare si dhe dërgesave të emigrantëve kanë inkurajuar nivelin e përgjithshëm të konsumit në vend gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Kreditë për ekonomitë familjare, si një burim i rëndësishëm i financimit të konsumit, deri në qershor të vitit 2011 shënuan rritje prej 16.9 përqind. Po ashtu, dërgesat e emigrantëve deri në qershor të vitit 2011 arritën vlerën prej 234.2 milion euro dhe

shënuan rritje prej 1.2 përqind, duke vazhduar të kenë rolin e njërit ndër burimeve kryesore të financimit për konsumin e ekonomive familjare (Figura 7). Sidoqoftë, ritmi i rritjes së dërgesave të emigrantëve në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011 është më i ngadalshëm në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2010. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për konsum të mallrave dhe shërbimeve shënuan rënie, duke ndikuar kështu negativisht në konsumin e përgjithshëm. Sidoqoftë, rritja e pagave për shërbyesit civil ka ndikuar pozitivisht në konsumin e sektorit privat në vend.

Zhvillime pozitive gjatë kësaj periudhe vlerësohet të ketë pasur edhe për sa i përket investimeve, përshirë investimet e sektorit privat dhe atij publik. Zgjerimi i vazhdueshëm i kredihënies nga sistemi bankar i Kosovës vazhdon të mbetet burim i rëndësishëm i financimit të investimeve të sektorit privat në vend. Gjatë gjysmës së parë të vitit, kreditë e lëshuara nga sistemi bankar shënuan një rritje vjetore prej 15.7 përqind, prej të cilave pjesa më e madhe i është lëshuar ndërmarrjeve. Investimet e Huaja Direkte (IHD) po ashtu paraqesin një komponentë të rëndësishme në kuadër të investimeve të sektorit privat në vend. Në gjysmën e parë të vitit 2011, IHD-të shënuan rritje të konsiderueshme duke arritur vlerën prej 157.6 milionë euro në krahasim me 103.0 milionë euro në gjashtë muajtë e parë të vitit 2010.

Investimet publike në periudhën referuese kanë dhënë kontribut mjaft të rëndësishëm kur merren parasysh projektet e investimeve kapitale të cilat po shënojnë rritje të

Figura 7. Dërgesat e emigrantëve, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

vazhdueshme. Si rezultat i këtyre projekteve, ndikimi i shpenzimeve publike në investimet e përgjithshme në vend vazhdon të jetë pozitiv. Shpenzimet qeveritare për investime kapitale në gjysmën e parë të vitit 2011 shënuan një normë vjetore të rritjes prej 55 përqind. Shpenzimet kapitale paraqesin kategorinë kryesore në kuadër të shpenzimeve buxhetore, me pjesëmarrje prej 32.2 përqind (169.8 milionë euro). Vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 arriti në 528 milionë euro që paraqet rritje prej 13 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kategoritë tjera të shpenzimeve buxhetore shënuan gjithashtu rritje, me përjashtim të mallrave dhe shërbimeve të cilat në këtë gjashtëmuor shënuan rënie prej 8 përqind. Pagat dhe mëditjet si dhe subvencionet dhe transferet shënuan rritje prej 28.2 përqind, përkatësisht 8 përqind. Përkundër rritjes së shpenzimeve buxhetore, buxheti i Kosovës në gjysmën e parë të vitit 2011 regjistroi suficit prej 52.1 milionë euro, pasi që niveli i të hyrave në këtë periudhë arriti në 579.2 milion euro, që paraqet rritje vjetore prej 8.6 përqind krahasuar me gjashtë muajtë e parë të vitit 2010.

Efekt negativ në PBB-në e Kosovës vazhdon të ketë bilanci tregtar, i cili në vazhdimësi po karakterizohet me shkallë të lartë të deficitit. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, deficitit tregtar në Kosovë arriti vlerën prej 925.4 milionë euro që paraqet rritje prej 16.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja e deficitit më së shumti i adresohet ritmit më të shpejtë të rritjes së importeve në këtë periudhë, vlera e të cilave arriti në 1.1 miliardë euro që paraqet një rritje prej 16.5 përqind. Rritja e importeve ishte rezultat edhe i rritjes së çmimeve të produkteve që kanë peshë më të madhe në strukturën e importeve të Kosovës. Derivatet e naftës janë kategoria kryesore e impoteve në Kosovë, ndërsa, ngritjet e çmimeve të këtij produkti janë reflektuar edhe në vlerën e gjithsej importeve në vend. Në anën tjetër, eksportet shënuan rritje vjetore prej 18.6 përqind, duke arritur vlerën prej 169.1 milionë euro. Përkundër rritjes më të shpejtë në krahasim me importet, baza e ulët e eksporteve bënë që rritja e tyre të ketë ndikim relativisht të ulët në zvogëlimin e deficitit tregtar të Kosovës. Sidoqoftë, niveli i mbulueshmërisë së importeve me eksporte vazhdon të përmirësohet dhe, deri në qershor 2011, arriti në 15.4 përqind krahasuar me 15.1 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Niveli i lartë i deficitit tregtar bën që ekonomia e Kosovës të karakterizohet me një normë të lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në qershor 2011, deficitit i llogarisë rrjedhëse arriti vlerën prej 287.1 milionë euro. Komponenti me peshën më të madhe në llogarinë rrjedhëse vazhdon të jetë llogaria e mallrave dhe shërbimeve, e cila në vazhdimësi është karakterizuar me shpërputhje mjaft të madhe ndërmjet vlerës së importeve dhe eksporteve. Ndërsa, një kategori tjetër me peshë mjaft të madhe në llogarinë rrjedhëse përbëhet nga llogaria e transfereve rrjedhëse, e

Figura 8. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

cila dominohet nga dërgesat e emigrantëve. Kjo kategori vazhdimisht është karakterizuar me bilanc pozitiv dhe ka kontribuar dukshëm në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse.

Llogaria kapitale dhe financiare e bilancit të pagesave vazhdon të karakterizohet me bilanc pozitiv, që kryesisht rrjedh nga Investimet e Huaja Direkte (IHD) dhe investimet tjera.

Investimet e huaja direkte në Kosovë gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 arritën vlerën prej 157.6 milionë euro, që paraqet një rritje mjaft të lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur IHD-të kishin shënuar vlerën prej rreth 103 milionë euro. Investimet tjera kryesisht përbëhen nga kreditë tregtare, të cilat shënuan një rritje mjaft të lartë deri në qershor 2011, duke arritur në 64.0 milionë euro

Figura 9. Llogaria kapitale dhe financiare, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

krahasuar me 13.4 milionë euro në qershor 2010. Përveç kredive tregtare, edhe kthimi i depozitave të investuara jashtë vendit ka ndikuar mjaft që kjo kategori të rritet. Në anën tjetër, portfolio investimet, të cilat përbëhen kryesisht nga investimet e mjeteve të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në instrumente financiare të vendeve tjera, kanë vazhduar të rriten por me një ritëm më të ngadalshëm krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

3.1.2. Çmimet

Presionet inflacioniste të cilat filluan të shfaqen që nga gjysma e parë e vitit 2010 vazhduan të jenë të pranishme edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (*angl. Consumer Price Index: CPI*) për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011 shënoi një rritje vjetore prej mesatarisht 9.7 përqind, që paraqet një normë relativisht më të lartë të inflacionit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kur inflacioni shënoi një

Figura 10. Indeksi i çmimit të konsumit, importit dhe prodhimit



Burimi: ESK (2011)

normë mesatare prej 1.4 përqind, përderisa gjatë gjysmës së parë të vitit 2009, ekonomia e Kosovës kishte shënuar një normë mesatare të deflacionit prej 2.6 përqind (Figura 10).

Rritja e çmimeve në ekonominë e Kosovës kryesisht është shkaktuar nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe posaçërisht nga rritja e çmimeve të drithërave dhe karburanteve. Vala e fundit e rritjes së çmimeve në vend në masën më të madhe është shkaktuar nga rritja e çmimeve të produkteve ushqimore të cilat ndikuan me rreth 7 pikë


përqindje në gjithsej inflacionin si rezultat i peshës më të madhe në shportën e konsumatorit në Kosovë (Figura 11). Edhe çmimet e karburanteve (në kuadër të çmimeve të transportit) paraqesin një kategori me ndikim të rëndësishëm për nivelin e përgjithshëm të çmimeve në vend, me kontribut prej rreth 1 pikë përqindje në normën e përgjithshme të inflacionit.

Ndjeshmëria e lartë e nivelit të çmimeve në Kosovë nga lëvizjet e çmimeve në tregjet globale vërehet edhe në Figurën 10, ku shihet se trendi i indeksit të çmimeve të konsumit dhe të prodhimit në Kosovë ka ndjekur trend shumë të ngjashëm me indeksin e çmimeve të mallrave të importuara. Ndikimi i madh i çmimeve të importit edhe në çmimet e prodhimit tregon për një mbështetje mjaft të madhe të prodhimit vendor në importin e lëndës së parë nga jashtë.

Në gjysmën e parë të vitit 2011, çmimet e produkteve të importuara, shprehur përmes Indeksit të Çmimeve të Importit (angl. Imports Price Index: IPI), shënuan rritje vjetore prej mesatarisht 11.5 përqind. Ndërsa, çmimet e produkteve të prodhuara në Kosovë, shprehur përmes Indeksit të Çmimeve të Prodhimit (angl. Producer Price Index: PPI), shënuan rritje vjetore prej mesatarisht 8.9 përqind. Rritja e çmimeve të prodhimit në Kosovë ishte kryesisht rezultat i rritjes së çmimeve në industrinë e nxjerrjes së mineraleve metalike, në industrinë produkteve ushqimore dhe pijeve, etj.


Si rezultat i zbutjes së inflacionit, në fund të tremujorit të dytë të vitit 2011, kundrejt muajve të parë të këtij viti, norma reale efektive e këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate; REER) u zhvlerëisua ndaj valutave të partnerëve tregtar, që paraqet një zhvillim pozitiv për ekonominë e Kosovës (Figura 12). Ndërsa, deri në mars të vitit 2011, REER e Kosovës kundrejt valutave të partnerëve tregtarë (sidomos me vendet e EU) u vlerësua në masë të konsiderueshme, duke bërë produktet e Kosovës më pak konkurruese në tregjet e jashtme. Faktori kryesor i cili ndikon në nivelin e REER të Kosovës kundrejt partnerëve tregtarë vazhdon të jetë niveli i inflacionit, i cili në Kosovë është më i lartë se sa në eurozonë dhe në vendet e CEFTA-s. Sidoqoftë, zhvlerësimi në tremujorin e dytë të vitit 2011 paraqet shenjë inkurajuese për prodhuesit vendor në rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve të tyre në tregjet e jashtme.

Figura 11. Kontributi i komponentëve të CPI-së në inflacion vjetor



Burimi: ESK (2011); Kalkulimet e BQK-së

Figura 12. Norma Reale Efektive e Këmbimit



Burimi: BQK (2011)

5. Sektori Financiar i Kosovës


5.1. Karakteristikat e përgjithshme

Sektori financiar i Kosovës ka vazhduar të zgjerojë aktivitetin dhe, në të njëjtën kohë, ka arritur të mirëmbajë nivelin e kënaqshëm që qëndrueshmërisë në të gjitha segmentet përbërëse të tij. Në fund të qershorit 2011, vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit financiar të Kosovës arriti në 3.3 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.1 përqind (17.5 përqind në qershor 2010). Kjo rritje kryesisht i atribuohet gjysmës së dytë të vitit 2010, përderisa gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 asetet e sektorit financiar shënuan një rritje më të ngadalshme. Trendi i aseteve të sektorit financiar vazhdon të përcaktohet kryesisht nga trendi i aseteve të sistemit bankar, që paraqet sistemin më të madh në kuadër të sektorit financiar të Kosovës. Asetet e sistemit bankar në qershor 2011 shënuan rritje vjetore prej 12.7 përqind (5.1 përqind në qershor 2010). Megjithatë, vlen të përmendet se aktiviteti kredihënës gjatë periudhës njëvjeçare shënoi një rritje dukshëm më të theksuar (15.7 përqind) krahasuar me rritjen e qershorit 2010 kur shënoi rritje prej 9.7 përqind. Kjo rritje e aktivitetit kredihënës u reflektua drejtpërdrejt edhe në të hyrat nga interesi i kredive, të cilat shënuan rritje vjetore prej 9.9 përqind.

Përpos rritjes së aseteve të bankave komerciale, në rritjen e aseteve të sektorit financiar ndikoi dukshëm edhe rritja e aseteve të fondeve pensionale, veçanërisht të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Në qershor 2011, vlera e aseteve të fondeve pensionale arriti shumë më prej 551.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 33.7 përqind. Zhvillimet në sistemet tjera, si ai i kompanive të sigurimeve, institucioneve mikrofinanciare dhe ndihmësve financiarë, kanë ndikim dukshëm më të vogël në zhvillimet e përgjithshme të sektorit financiar, si rezultat i pjesëmarrjes më të ulët të tyre në treg. Veprimtaria kryesore e kompanive të sigurimeve vazhdon të jetë sigurimi i përgjegjësishë ndaj palës së tretë (angl. Third Party Liability: TPL), prej nga edhe gjenerohet pjesa më e madhe e primeve të pranuar. Në qershor 2011, totali i aseteve të kompanive të sigurimit arriti vlerën prej 103.4 milionë euro (rritje vjetore prej 14.8 përqind). Institucionet financiare vazhdojnë të mbështesin aktivitetin e tyre kryesisht në financimin e bizneseve dhe ekonomive familjare përmes kredive, vlera e të cilave në qershor 2011 arriti në 115.2 milionë euro (rritje vjetore prej vetëm 1.2 përqind).

Përderisa bankat komerciale menaxhojnë rreth 76 përqind të aseteve të sektorit financiar, pjesëmarrje të konsiderueshme kanë edhe fondet pensionale, të cilat në qershor 2011 menaxhuan 16.7 përqind të gjithsej aseteve të sektorit financiar (14.4 përqind në qershor 2010). Pjesëmarrja e sistemeve tjera, siç janë kompanitë e sigurimeve dhe ndihmësit financiarë mbeti pothuajse e pandryshuar krahasuar me qershorin 2010, përderisa vërehet

Figura 13. Struktura e aseteve të sistemit financiar sipas sektorëve



Burimi: BQK (2011)

një rënie e vogël e pjesëmarrjes së asetëve të institucioneve mikrofinanciare në gjithsej asetet e sektorit financiar (Figura 13).

Struktura e sektorit financiar të Kosovës vazhdon të jetë kryesisht e njëjtë me periudhat e kaluara edhe për sa i përket numrit të institucioneve financiare të cilat operojnë në Kosovë, ku me përjashtim të hyrjes në treg të tre ndihmësve financiarë, numri i institucioneve financiare mbeti i njëjtë me vitin e kaluar (Tabela 1). Në qershor 2011, në Kosovë operuan gjithsej 70 institucione financiare, numrin më të madh të cilave e përbëjnë ndihmësit financiarë dhe institucionet mikrofinanciare (së bashku 49), por të cilat menaxhojnë pjesën më të vogël të asetëve të sektorit financiar. Numri i bankave dhe kompanive të sigurimit në tregun financiar të Kosovës nuk ka ndryshuar gjatë tri viteve të fundit, përkundër faktit që këto industri janë mjaft profitabile dhe kanë shënuar zgjerim të vazhdueshëm të aktivitetit, faktorë këta shumë të rëndësishëm për tërhequr hyrjen e institucioneve të reja financiare në treg. Sidoqoftë, mungesa e hyrjeve të reja në tregun financiar të Kosovës korrespondon me evoluimin e krizës globale financiare që nga viti 2008, gjë e cila ka ndikuar në kufizimin e zgjerimit të mëtutjeshëm të institucioneve të huaja financiare drejtë tregjeve të reja, si dhe me eskalimin ekzistues të krizës së borxheve në euro-zonë – krizë kjo që ka prekur numër të konsiderueshëm të bankave në Bashkimin Evropian.

Tabela 4. Numri i institucioneve financiare


Përshkrimi	Qershor 2008	Qershor 2009	Qershor 2010	Qershor 2011
Bankat komerciale	8	8	8	8
Kompanitë e sigurimeve	12	11	11	11
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiarë	29	28	29	32
Institucionet mikrofinanciare	16	19	17	17

Burimi: BQK, 2011

Sektori financiar i Kosovës (përfshirë BQK-në) vazhdon të investojë një pjesë të konsiderueshme të asetëve në sektorin e jashtëm, përderisa shfrytëzimi i financimit nga jashtë vazhdon të jetë në nivel relativisht të ulët. Në qershor 2011, vlera e Asetëve të Jashtme Neto (AJN) arriti në rreth 2 miliardë euro (Figura 14), që paraqet një rritje vjetore prej 14.7 përqind (7.6 përqind në qershor 2010). Pjesa më e madhe e AJN-ve përbëhet nga

asetet e BQK-së (58.8 përqind), pasuar nga bankat komerciale (21.1 përqind) dhe institucionet tjera financiare me 20.1 përqind (Figura 15). Të gjitha institucionet financiare, përveç institucioneve mikrofinanciare, kanë shënuar bilanc pozitiv të AJN-ve që

Figura 14. Kërkesat neto të sektorit financiar, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

do të thotë se në përgjithësi kërkesat ndaj sektorit të jashtëm janë më të mëdha se detyrimet ndaj këtij sektori.

Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm shënuan vlerën prej 2.42 miliardë euro, pjesa dërmuese e të cilave është investuar në depozita (48.4 përqind) dhe letra me vlerë (26.4 përqind), strukturë kjo mjaft e ngjashme me atë të viteve të kaluara (Figura 16). Megjithatë, shikuar sipas institucioneve, përdërisa BQK ka zhvendosur një pjesë të investimeve nga letrat me vlerë drejtë investimeve në depozita, bankat komerciale kanë bërë të kundërtën, duke zhvendosur një pjesë të investimeve nga depozitat drejt letrave me vlerë. Në qershor 2011, 68.5 përqind e kërkesave të BQK-së ndaj sektorit të jashtëm përbëheshin nga investimet në depozita (53.5 përqind në qershor 2010) dhe 18.8 përqind përbëheshin nga investimet në letra me vlerë (29.7 përqind në qershor 2010). Për sa i përket investimeve të bankave komerciale në sektorin e jashtëm, depozitat përbëjnë 44.2 përqind të këtyre investimeve (59.1 përqind në qershor 2010), ndërsa 32.4 përqind e këtyre investimeve përbëhet nga letrat me vlerë (20.9 përqind në qershor 2010).


Detyrimet e sektorit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm shënuan vlerën prej 432.6 milionë euro në qershor 2011 (rritje vjetore prej 18.4 përqind). Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm kryesisht përbëhen nga kreditë që institucionet financiare që operojnë në Kosovë kanë pranuar nga institucionet financiare që operojnë jashtë vendit (46.2 përqind të gjithsej detyrimeve), si dhe depozitat e jorezidentëve në bankat që operojnë në Kosovë (23.6 përqind) (Figura 17). Pjesa më e madhe e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm i përket bankave komerciale dhe institucioneve mikrofinanciare, si përfituesit më të mëdhenj të

Figura 15. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

Figura 16. Struktura e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

Figura 17. Struktura e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

kredive të marra nga jashtë dhe gjithashtu si mbajtës të depozitave të jorezidentëve (vetëm bankat komerciale). Për sa i përket detyrimeve të BQK-së ndaj sektorit të jashtëm, ato kryesisht përbëhen nga Të Drejtat Speciale të Tirazhit dhe kuota e FMN-së.

Sektori financiar i Kosovës vazhdoi të rrisë kërkesat edhe ndaj sektorit të brendshëm. Në qershor 2011, këto kërkesa arritën vlerën prej 839.2 milionë, që paraqet një rritje prej 38.8 përqind krahasuar me qershor 2010. Me që kërkesat ndaj sektorit të brendshëm përbëhen nga kërkesat neto ndaj qeverisë qendrore dhe kërkesat ndaj sektorit real, rritja e tyre kryesisht rezultoi për shkak të nivelit më të ulët të depozitave të qeverisë (krahasuar me qershor 2010) dhe në anën tjetër rritjes së theksuar së kërkesave ndaj sektorit real (afër 13 përqind). Kërkesat ndaj sektorit real kryesisht përbëhen nga kreditë e lëshuara nga bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare, përfitues të të cilave janë kryesisht ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Kur merren parasysh edhe detyrimet ndaj sektorit real (kryesisht depozitat në bankat komerciale), atëherë neto kërkesat ndaj sektorit real zakonisht shënojnë bilanc negativ (Figura 14).

5.2. Sistemi i pagesave dhe infrastruktura bankare

Sistemet e pagesave dhe shlyerjeve janë pjesë vitale e ekonomisë dhe infrastrukturës financiare dhe paraqesin një ndër shtyllat me rëndësi të stabilitetit dhe efikasitetit të përgjithshëm të sektorit financiar. Nisur nga kjo, një ndër objektivat më të rëndësishme të bankave qendrore mbetet funksionimi transparent i sistemit të pagesave dhe qartësia e plotë e udhërrëfyesve për tërë pjesëmarrësit në sistemin e pagesave dhe shlyerjeve. Duke qenë se një pagesë paraqet transferimin e vlerave monetare nga blerësi tek shitësi, një sistem i efektshëm pagesash duhet të sigurojë masa të duhura për përfundimin e suksesshëm të pagesës në mënyre që të evitohen rreziqet eventuale që mund të kanosin çfarëdo pagese. Zvogëlimi i rrezikut potencial për mos përfundimin e një pagese rezulton në funksionimin e mirë të tregjeve financiare dhe sistemeve bankare kombëtare dhe ndërkombëtare. Kriza e fundit financiare globale dëshmoi se sistemet e pagesave paraqesin një arterie jo vetëm për tregjet financiare, por edhe për aktivitetin ekonomik të secilit vend. Prandaj, bankat qendrore në mbarë botën angazhohen maksimalisht në ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave për të siguruar zhvillim të duhur ekonomik.

Një pagesë, sado e thjeshtë në dukje, përfshinë brenda vetës një sërë hapash që duhen të ndermirën në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja e transaksionit, proces ky që përfshinë kliringun dhe shlyerjen e pagesës. Kliringu përfshin hapat e një pagesë prej momentit që depozituesi paraqet pagesën në bankën e tij deri tek ai kur pagesa mbërrin në bankën për të cilën është destinuar, ndërsa shlyerja paraqet aktin përfundimtar të transferimit të pronësisë së pagesës. Lloji i instrumenteve të pagesave në dispozicion varet kryesisht nga zhvillimi i sistemit të pagesave në vend dhe përzgjedhja e instrumenteve të pagesave bëhet në pajtueshmëri me llojin e pagesës, si nga individët ashtu edhe nga institucionet relevante. Në vendet me sisteme financiare më pak të zhvilluara, paraja e gatshme mbetet instrumenti më i përdorshëm dhe më i pranueshëm për pagesa. Vlen theksuar se paraja e gatshme bart mbi vete një sërë rreziqesh, siç janë falsifikimet e ndryshme, rreziku i transportit të parasë (vjedhjet apo dëmtimet e ndryshme), etj. Instrumentet e pagesave që nuk bëhen në para të gatshme mund të jenë instrumente në letër dhe instrumente elektronike. Instrumentet e pagesës në letër konsiderohen Transferet e Kreditit dhe Çeçet, ndërkaq instrumentet e pagesave elektronike janë Kartat e Debitit dhe Kartat e Kreditit (Kartat me funksion pagese), Debitimi Direkt dhe E-banking. Duke qenë se këto lloje të

instrumenteve të pagesës kalojnë nëpër një sërë hapash që njëkohësisht mundësojnë kontrollin dhe vlerësimin e kualitetit dhe besueshmërisë së instrumentit, rritja e vazhdueshme e preferencës për format tjera të pagesës në krahasim me paranë e gatshme do të ndikojë në zvogëlimin jo vetëm të rreziqeve të lartpërmendura, por edhe të zvogëlimit të informalitetit në ekonomi në përgjithësi.

5.2.1 Sistemi i Pagesave në Kosovë

Nxitja e një sistemi financiar stabil, që mes tjerash përfshinë një sistem të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas të pagesave është objektiv parësor i BQK-së. Sistemi i pagesave në Kosovë përfshinë në vete institucionet, instrumentet relevante të pagesave, rregullat dhe teknologjinë që deri më sot kanë rezultuar në një sistem të qëndrueshëm dhe stabil pagesash me ecuri të vazhdueshme të rritjes. Që nga nëntori i vitit 2000, BQK është angazhuar në ndërtimin e një sistemi të pagesave ndërbankare në vend dhe në maj të vitit 2001 filloi punën Sistemi i Kliringut Ndërbankar (SKN). Ky sistem pagesash përbënte një sistem të thjeshtë të kliringut dhe shlyerjes së urdhërpagesave në letër, sistem në të cilin regjistroheshin të dhënat në mënyre manuale dhe gjysëmmanuale. Në vitin 2002, u kalua në fazën e dytë të zhvillimit të sistemit të pagesave, gjegjësisht në Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN). Që nga viti 2009, SEKN bazohet plotësisht në teknologjinë e web-it, gjë që ndikoi në rritjen e funksionalitetit të tij dhe në lehtësinë dhe qartësinë e përdorimit të tij.

BQK është jo vetëm operuese, monitoruese dhe rregullatore e sistemit të vetëm ndërbankar të pagesave në vend, por është edhe pjesëmarrëse në sistem në emër të saj dhe të institucioneve të qeverisë. Përpos BQK-së, në sistemin e pagesave marrin pjesë edhe tetë bankat komerciale që veprojnë në sistemin bankar në vend, që në të njëjtën kohë veprojnë edhe si agjent të pagesave për institucionet mikrofinanciare dhe kompanitë e sigurimeve. Bankat komerciale janë të lidhura me SEKN sipas topologjisë “Hub-and-Spoke” përmes linjave të huazuara nga kompanitë e telekomunikimit, përderisa zhvillimet e fundit do të qojnë në zëvendësimin e linjave të huazuara me fije optike. Sistemet qendrore të pjesëmarrësve në sistemin kombëtar të pagesave janë të lidhura në mënyrë elektronike me SEKN, dhe pagesat prioritare dhe ato urgjente klirohen në baza bruto, përderisa pagesat tjera në baza neto në katër funksione kliringu të pranishme në SEKN në ditë. Pagesat tjera përfshijnë pagesat individuale, pagesat me shumicë, pagesat Kos-Giro dhe pagesat e debitimit direkt.

Sistemi i pagesave në Kosovë vazhdon të mbështetet kryesisht në pagesa në para të gatshme, megjithëse avancimi i sistemit ndërbankar të pagesave gjatë viteve të fundit ka ndikuar në rritjen e vazhdueshme të pagesave jo në para të gatshme. Në kuadër të pagesave jo në para të gatshme, instrumenti më dominues përfaqësohet nga Transferet e Kreditit, që mund të jenë urdhërpagesa në formë elektronike apo në formë letër. Përmes produkteve të ndryshme bankat komerciale në vend po inkurajojnë qytetarët dhe bizneset të rrisin përdorimin e pagesave elektronike kundrejt atyre në letër. Megjithatë, numri i transfereve të kreditit në letër vazhdon të jetë më i madh krahasuar me ato elektronike. Një instrument i rëndësishëm pagese që ka treguar rritje të vazhdueshme të përdorimit që nga prezantimi në vitin 2005 është Kos-Giro, instrument pagese i krijuar për të rritur efikasitetin e pagesave në letër si për bankat dhe konsumatorët ashtu edhe për kompanitë e ndryshme shërbyese. Pagesat përmes Kos-Giro janë një formë e transfertës kreditore – urdhërpagesë në formë letre që mundëson realizimin e pagesave të faturave përmes bankës (pagesat e regjistrimit, taksat apo faturat e shërbimeve publike). Konsumatorët e

Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK) dhe shërbimit doganor kanë ndikuar në rritjen e vazhdueshme të vlerës dhe vëllimit të pagesave Kos-Giro. Instrument i rëndësishëm pagese, prezent në treg që nga fundi i vitit 2009, është edhe Debitimi Direkt. Edhe pse numri dhe vlera e pagesave të realizuara përmes debitimit direkt mbetet ende e ulët, duke qenë se përbën një instrument të ri në treg, bashkëngjitja e kompanive më të mëdha shërbyese në skemën e debitimit direkt pritet të ndikojë në rritjen e vazhdueshme të përdorimit të këtij instrumenti pagese. Debitimi direkt është instrument debiti, i përshtatshëm për pagesat periodike siç janë faturat e energjisë elektrike, ujit, ngrohjes, telefonit, etj. Për funksionimin e duhur të instrumentit të debitimit direkt, klienti duhet të nënshkruaj autorizimin për debitimin direkt, për të lejuar kompaninë të tërheq paratë nga llogaria e klientit në dobi të kompanisë. Kompania pastaj njofton klientin për shumën dhe datën e tërheqjes dhe dërgon të dhënat tek banka e vet, e cila përmes SEKN-së nis kërkesën për debitim direkt. Hapi i fundit i këtij instrumenti përfshinë procesin e ekzekutimit të kërkesës për debitim direkt përmes SEKN-së.

Pagesat elektronike, shumë të përhapura në ekonominë e zhvilluara, kryesisht kryhen përmes kartelave me funksion pagese që mund të jenë kartela debiti dhe kartela krediti. Kartelat e debitit mbeten kartelat më të përhapura në tregun e Kosovës. Këto kartela i mundësojnë kartëmbajtësit të tërheq para nga llogaria përmes ATM (angl. Automated Teller Machine) si dhe të bëjë pagesa në pika të shitjes POS (angl. Point-of-Sale). Kartelat e kreditit në anën tjetër paraqesin një linjë krediti të hapur për pronarin e kartelës, duke i mundësuar atij të bëjë pagesa si dhe të tërheq para sipas limitit të paracaktuar. Përdorimi i kartelave të kreditit kanë shënuar rritje të konsiderueshme në vitet e fundit. Internet banking apo e-banking është karakterizuar me rritje të vazhdueshme të përdorimit që nga prezantimi i tij. Tani pjesa më e madhe e bankave në sistemin bankar të Kosovës ofrojnë këtë shërbim dhe klientët mund të autorizojnë transfere, pagesa dhe të realizojnë porosi përmes kompjuterëve personal.

Sistemi ndërbankar i pagesave në Kosovë kliron pagesat në vlerë të madhe, pagesat në vlerë të vogël, pagesat prioritare, individuale, me shumicë, pagesat Kos-Giro dhe pagesat e debitimit direkt. Pagesat prioritare mund të jenë pagesa individuale por edhe pagesa me shumicë dhe përdoren kryesisht për pagesa urgjente komerciale.

Tabela 5. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	Gjashtëmujori i parë 2010	Gjashtëmujori i parë 2011	Gjashtëmujori i parë 2010	Gjashtëmujori i parë 2011
Normale	13,7	15,9	60,1	60,0
Prioritare	0,3	0,4	13,8	12,1
Kthyerë	0,0	0,0	0,0	0,0
Masive Normale (detale)	75,3	71,9	9,9	10,1
Xhiro (detale)	10,5	11,6	16,1	17,6
Masive Prioritare (detale)	0,1	0,1	0,0	0,0
Debitimi Direkt	0,1	0,2	0,0	0,1

Burimi: BQK, 2011

Numri dhe vlera e transaksioneve që përpunon SEKN ka shënuar rritje të vazhdueshme në vitet e fundit. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011, në sistemin SEKN është realizuar një

numër prej 2.0 milion transaksionesh, me një vlerë totale prej 2.2 miliard euro. Kundrejt gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, numri i gjithsej transaksioneve rezulton të jetë rritur për 7.8 përqind, ndërkaq vlera e gjithsej transaksioneve të shlyera në të njëjtën periudhë është rritur për 10.8 përqind. Ngjashëm me vitin e kaluar, numri dhe vlera e gjithsej transaksioneve të shlyera në gjashtëmujorin e parë të vitit rezulton të jetë e përqendruar në tremujorin e dytë të vitit 2011. Mesatarisht, çdo ditë në sistemin e SEKN janë procesuar dhe shlyer rreth 16,734 transaksione me një qarkullim mesatar ditor prej rreth 17.9 milion euro.

Vlen të theksohet se në SEKN, duke përjashtuar BQK-në si pjesëmarrëse në sistem, rreth 56.3 përqind e numrit të gjithsej transaksioneve menaxhohet nga tri banka pjesëmarrëse në sistem, përderisa rreth 69.9 përqind e vlerës së gjithsej transaksioneve menaxhohet nga tri bankat më të mëdha në sistemin bankar në vend.

5.2.2 Instrumentet e pagesave

Sa i përket numrit të transaksioneve të realizuara përmes SEKN, pagesat përmes Debitimit Direkt kanë shënuar rritjen më të shpejtë, nga 1,050 në 3,205. Në qershor 2011 krahasuar me qershor 2010, numri i pagesave prioritare shënoi rritje prej 26.9 përqind, përderisa në të njëjtën periudhë, numri i pagesave normale dhe pagesave Kos-Giro u karakterizuan me rritje prej 25.1 përkatësisht 18.8 përqind. Edhe sa i përket vëllimit të transaksioneve të realizuara përmes SEKN, duke pasur parasysh bazën e tyre ende të ulët, pagesat përmes debitimit direkt shënuan rritjen më të shpejtë vjetore (nga 954,224 mijë euro në qershor 2010 në 2.9 milion euro në qershor 2011). Rritje në vëllim shënuan edhe transaksionet Kos-Giro, që në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit paraprak u karakterizuan me rritje vjetore prej 21.0 përqind. Pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej transaksionet e kanë pagesat normale (60.0 përqind në gjithsej vlerën e transaksioneve), megjithëse edhe vlera e pagesave Kos-Giro dhe Debitimit Direkt kanë shënuar rritje të vazhdueshme (Tabela 1).

Deri në qershor 2011, numri i gjithsej llogarive bankare të vlefshme për të kryer pagesa arriti në 1.6 milion llogari të klientëve, një rritje vjetore prej 12.9 përqind.⁶ Nga gjithsej llogaritë bankare, rreth 59 mijë llogari përbëhen nga llogaritë E-Banking, llogari këto që përdoren 'online' nga interneti për tu qasur në shërbimet bankare. Këto llogari shënuan rritje vjetore prej 19.3 përqind në gjashtëmujorin e parë të këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Me gjithë rritjen e shënuar në vitet e fundit, shkalla e përdorimit të llogarive E-Banking ende konsiderohet e ulët, duke pasur parasysh se këto llogari përbëjnë vetëm 3.6 përqind të gjithsej llogarive bankare. Numri i kartelave që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe shërbime për pagesa të ndryshme (kartela debiti dhe krediti) arriti në 584,139 mijë në gjashtëmujorin e parë, një rritje prej 14.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011, numri i kartelave me funksion debiti arritën në 1.0 milion, përderisa numri i gjithsej kartelave të kreditit arriti në 99,384 mijë. Përkundër shkallës më të ulët të përdorimit, numri i kartelave të kreditit është karakterizuar me rritje më të shpejtë krahasuar me rritjen e numrit të kartelave të debitit. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011, numri i kartelave të debitit u karakterizua me një rritje vjetore prej 8.3 përqind

⁶ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë, numrin e llogarive E-Banking, numrin e llogarive që përdorin urdhëresën periodike ("standing order") dhe numrin e llogarive që përdorin Debitimin Direkt ("Direct Debit") – DD.

përderisa në të njëjtën periudhë, numri i kartelave të kreditit shënoi një rritje vjetore prej 53.0 përqind.

Tabela 6. Rrjeti i sistemit bankar

Përshkrimi	Qershor 2008	Qershor 2009	Qershor 2010	Qershor 2011
Numri i ATM-ve	219	282	380	441
Numri i POS-ve	2.837	4.612	5.493	6,654
Numri i llogarive 'e-banking'	11,242	17,496	49,188	58,675

Burimi: BQK, 2011

Sistemi bankar i Kosovës ka vazhduar zgjerimin e infrastrukturës bankare, duke lehtësuar kështu qasjen e klientëve në shërbimet bankare. Kjo shprehet edhe përmes rritjes së numrit të pajisjeve ATM dhe pajisjeve POS të instaluar nga bankat komerciale, të cilat shënuan rritje vjetore prej 16.1 përkatësisht 21.1 përqind. Në qershor 2011, numri i ATM-ve të instaluar arriti në 441 përderisa numri i POS-ve arriti në 6,654 mijë në të njëjtën periudhë (Tabela 6). Gjatë periudhës janar-qershor 2011, numri i tërheqjeve përmes ATM të klientëve të bankës dhe tërheqjeve nga klientët e bankave tjera arriti në 2.0 milion, me një qarkullim total prej 191.6 milion euro (147.4 milion euro në gjashtëmuorin e parë të vitit 2010). Në të njëjtën periudhë u procesuan rreth 587,448 mijë transaksione nga shfrytëzimi i pikave shitëse (POS) dhe pagesave përmes pikave shitëse me kartela të jashtme (POS), një qarkullim total prej 33.8 milion euro (22.4 milion euro në gjashtëmuorin e parë të vitit 2010). Nga vlera e gjithsej transaksioneve me kartela (ATM dhe POS), pjesëmarrja e tërheqjes së parave të gatshme nga ATM deri në qershor 2011 ishte rreth 82.4 përqind, ndërkaq rreth 14.5 përqind janë pagesa të klientëve me kartela në pajisjet POS, gjë që dëshmon për shkallën e lartë të përdorimit të parasë së gatshme në ekonominë e vendit.

Shkalla e zgjerimit të infrastrukturës bankare në Kosovë ishte relativisht e shpejtë dhe kjo ndikoi në përafrimin e Kosovës me vendet e rajonit në këtë aspekt. Sa i përket numrit të gjithsej kartelave, në vitin 2010 Kosova kishte 271 kartela për 1000 banorë, përcjellë nga Shqipëria me 207 kartela për 1000 banorë. Kroacia kishte numrin më të madh të kartelave prej 6.8 milion në vitin 2010 që do të thotë se kishte mbi 1500 kartela për 1000 banorë. Sidoqoftë, sa i përket ATM pajisjeve të instaluar, Kosova kishte 0.23 për 1000 banorë (415 në vitin 2010), Shqipëria kishte 0.24 për 1000 banorë (771 në vitin 2010), ndërsa Kroacia kishte numrin më të lartë të ATM-ve të instaluar në këtë periudhë me 0.86 për 1000 banorë (3,794). Sa i përket pagesave të realizuara përmes E-Banking, të dhënat tregojnë se Shqipëria ka numrin më të vogël të pagesave të realizuara përmes internetit (27,368 mijë në vitin 2010), pasuar nga Kosova (55,292 mijë në vitin 2010) dhe Maqedonia (221,599 mijë në vitin 2010). Edhe për këto pagesa, Kroacia prinë në rajon me numrin më të lartë të pagesave E-Banking prej 989,862 mijë në vitin 2010.

Duke kuptuar rolin e rëndësishëm të një sistemi funksional dhe efikas të pagesave, BQK ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në zhvillimin e sistemit ndërbankar të pagesave në vend duke monitoruar dhe stimuluar pjesëmarrësit në këtë sistem. Për të zhvilluar dhe modernizuar më tej sistemin kombëtar të pagesave, BQK ka hartuar një dokument që quhet Vizioni i së Ardhmes së Sistemit Kombëtar të Pagesave që përfshin vizionin për

strategjinë e zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave dhe planin e veprimit për zbatimin e këtij vizioni (Kutia 4).

Kutia 3. Strategjia e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), e mbështetur nga Banka Botërore, ka përpiluar Strategjinë e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave. Kjo strategji nëpërmjet përcaktimit të rrugës së zhvillimit ka vendosur objektivat dhe mënyrat e realizimit të tyre në afatin e mesëm. Formulimi i saj është konsideruar me rëndësi të madhe edhe duke qenë se e bën transparente për të gjithë akterët drejtimin e zhvillimit të sistemit të pagesave në Republikën e Kosovës.

Strategjia e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave është e strukturuar në nëntë shtylla kryesore: i) korniza ligjore, ii) pagesat me vlera të mëdha dhe ato urgjente, iii) pagesat me vlera të vogla, iv) transaksionet qeveritare, v) letrat me vlerë, vi) tregu monetar, vii) dërgesat nga jashtë, viii) mbikëqyrja e sistemit të pagesave dhe ix) bashkëpunimi dhe koordinimi mes akterëve të pagesave.

Në kuadër të implementimit të deritanishëm të strategjisë janë themeluar grupet punuese për të gjitha shtyllat e parapara në strategji dhe janë ndërmarrë një mori aktivitesh përkatëse. Konkretisht, janë përgatitur e termat e referencës për sistemet e reja të pagesave (shtyllat ii, iv dhe vi) si dhe është draftuar ligji mbi sistemin e pagesave (shtylla i). Në fushën e monitorimit të sistemit të pagesave (shtylla vii), BQK ka themeluar dhe zhvilluar funksionin përkatës në linjë me parimet dhe standardet bashkëkohore ndërkombëtare. Lidhur me monitorimin e sistemit të pagesave, vlen të theksohet edhe se janë bërë publikime të rregullta të treguesve analitikë për instrumentet e pagesave në Kosovë si dhe është plotësuar dhe rishikuar rregullativa e metodologjisë së raportimit dhe është draftuar rregullorja për statistika të instrumenteve të pagesave. Siç ishte paraparë në shtyllën ix të strategjisë, është funksionalizuar edhe Këshilli Kombëtar i Pagesave (KKP). KKP-ja përbëhet nga përfaqësuesit më të lartë të BQK-së, Thesarit/Ministrisë së Financave, Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe bankave komerciale. KKP-ja synon të mbështesë zhvillimin e sistemeve të qëndrueshme dhe efikase për kliringun dhe shlyerjen e pagesave dhe letrave me vlerë në Kosovë dhe mund të shërbejë si një forum për bashkëpunim për sigurimin e kushteve të duhura në sistemet rajonale dhe ndërkombëtare të pagesave. Në kuadër të KKP-së u themelua dhe filloi së vepruari edhe grupi i veçantë i punës për reduktimin e pagesave me para të gatshme.

Disa nga projektet madhore dhe më me rëndësi thelbësore për sistemin kombëtar të pagesave janë në proces të finalizimit. Ndër të tjera, vlen të theksohet projekti për paga të qeverisë dhe pensionet që pritet të automatizohet në kontekst të procesimit të të dhënave, pasi që deri më tani këto të dhëna janë procesuar në mënyrë manuale nga bankat komerciale. Projekt i një rëndësie të veçantë është edhe projekti për sistemin e shlyerjes dhe depozitimit për tregtimin e letrave me vlerë bazuar në paketën CSD (angl. Central Securities Depository), që planifikohet të implementohet në fillim të vitit të ardhshëm. Gjithashtu, në BQK po ndërmirën hapat e parë për implementimin e sistemit bashkëkohor për automatizimin e përpunimit dhe të rrjedhës së pagesave RTGS (angl. Real Time Gross Settlement). Ky sistem do të përpunojë kryesisht pagesat me vlerë të madhe (apo "me shumicë") dhe pagesat urgjente midis bankave në vend dhe institucioneve qeveritare. Vlen të theksohen edhe aktivitetet e ndërmarra për realizimin e projektit për zvogëlimin e përdorimit të parasë së gatshme për bankat, bizneset dhe individët. Ky projekt pritet të gjenerojë proceset dhe infrastrukturën e duhur për nxitjen e përdorimit të alternativave tjera për realizim të pagesave kundrejt përdorimit të parasë së gatshme.

6. Sistemi Bankar i Kosovës

6.1. Karakteristikat e përgjithshme të sistemit bankar

Struktura e sistemit bankar të Kosovës gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 ishte e ngjashme me vitin e kaluar. Në tregun bankar në vend vazhduan të operojnë tetë banka komerciale, prej të cilave gjashtë kishin pronësi të huaj ndërsa dy pronësi vendore. Në qershor 2011, bankat me pronësi të huaj dominuan tregun bankar në vend me një pjesëmarrje prej rreth 90.0 përqind të gjithsej asetëve të sistemit bankar, përderisa bankat me pronësi vendore menaxhuan pjesën e mbetur prej 10.0 përqind.


Tregu bankar në vend vazhdon të karakterizohet me shkallë të lartë të koncentrimit, ku 74.5 përqind e gjithsej asetëve të sistemit bankar menaxhohen nga tri bankat më të mëdha (79.6 përqind në qershor 2010). Megjithatë, rritja e vazhdueshme e aktivitetit të bankave më të vogla ka ndikuar që shkalla e koncentrimit të tregut të ndjekë një trend rënës që nga viti 2007. Rënia e shkallës së koncentrimit të tregut shprehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-

Hirschman (IHH). Sipas IHH për gjithsej asetet, në qershor 2011, tregu bankar u karakterizua me një shkallë koncentrimi prej 2,157 pikë, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, tregon për një rënie të shkallës së koncentrimit për 265.2 pikë të IHH. Shkalla e koncentrimit të tregut bankar vërehet të ketë shënuar rënie të vazhdueshme që nga viti 2008 edhe bazuar në IHH për gjithsej depozitat dhe kreditë e sistemit bankar (Figura 18).

Bankat komerciale kanë vazhduar zgjerimin e infrastrukturës së tyre, duke ofruar shërbimet e tyre më afër klientëve. Megjithatë, ritmi i zgjerimit të infrastrukturës vërehet të jetë ngadalësuar në krahasim me dy vitet paraprake, gjë që mund të reflektojë masat e ndërmarra nga bankat për zvogëlim të shpenzimeve, por gjithashtu reflekton faktin se tashmë bankat që operojnë në Kosovë kanë arritur të konsolidojnë mjaft mirë prezencën e tyre në territorin e Kosovës me njësitë e tyre bankare. Në qershor 2011, numri i degëve dhe nëndegëve të bankave komerciale në vend arriti në 301, që paraqet një rritje vjetore prej 5 njësi (7 njësi në vitin 2010, 43 njësi në vitin 2009). Në të njëjtën kohë, numri i të punësuarve në bankat komerciale shënoi rritje krahasuar me vitin 2010. Në qershor 2011, sistemi bankar punësonte 3,654 punëtor krahasuar me 3,561 punëtor sa kishte në qershor 2010.

Gjatë vitit 2011 janë shënuar avancime të mëtejme edhe për sa i përket anës rregullative të sistemit bankar, të cilat janë kurorëzuar me hartimin e Ligjit të ri për Bankat Komerciale, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare nga ana e BQK-së. Zbatimi i Ligjit të ri pritet të përforcojë edhe më tutje kapacitet mbikëqyrës të BQK-së në rolin e rregullatorit si dhe të kontribuojë në përforcimin e qeverisjes së brendshme në institucionet financiare (Kutia 4).

Figura 18. HHI për asetet, kreditë dhe depozitat



Burimi: BQK (2011)

Kutia 4. Ligji për bankat dhe institucionet financiare jobankare

Korniza rregullative dhe mbikëqyrëse e BQK-së është pasuruar më tej me ligjin e ri për Bankat Komerciale, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare. Ky ligj përfshinë praktikat më të reja dhe standardet ndërkombëtare të afarizmit bankar në funksion të rritjes së efikasitetit të licencimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit të sektorit financiar. Ndër qështjet më të rëndësishme të cilat i japin vlerë të shtuar ligjit të ri në raport me ligjin paraprak mund të veçojmë:

Zgjerimin e mekanizmave të mbikëqyrjes duke përfshirë opsionin e administrimit të bankave të cilat mund të përballen me probleme afatshkurtëra të likuiditetit por që konsiderohen solvent;

Forcimin e kërkesave rregullatore për qeverisje korporative, kërkesave për përshtatshmëri, testet 'i përshtatshëm dhe i duhur' të administratorëve të institucioneve financiare;

Rritjen e mekanizmave detyrues dhe saksioneve në rast mospajtueshmërie si dhe kërkesave të parimeve për menaxhimin e rreziqeve bankare;

Mbikëqyrjen e konsoliduar si dimension gjithëpërfshirës për monitorimin e profilit të përgjithshëm të grupit të institucioneve financiare;

Diferencimin më të qartë të kërkesave rregullative dhe mbikëqyrëse për bankat e inkuorporuara në treg në formë të filialeve (subsidiary) dhe degëve të bankave të huaja;

Përcaktimin e limiteve më prudenciale për sa i takon ekspozimeve ndaj grupeve të ndërlidhura dhe interesave të ndërlidhura me bankën;

Opsionin e bankingut Islam; dhe

Forcimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare.

Ky ligj pritet të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës deri në fund të vitit 2011.


6.2. Bilanci i gjendjes së sistemit bankar

6.2.1 Asetet

Sistemi bankar i Kosovës ka vazhduar të zgjerojë aktivitetin edhe gjatë periudhës së fundit, duke vazhduar kështu të jetë një ndër promotorët kryesor të aktivitetit ekonomik në vend. Duke arritur vlerën prej 2.5 miliard euro (52.8 përqind e PBB-së), gjithsej asetet e menaxhuara nga bankat komerciale në Kosovë shënuan rritje vjetore prej 12.7 përqind në qershor 2011.⁷ Kontribues thelbësorë në rritjen e përgjithshme të aseteve të bankave komerciale

vazhdojnë të jenë kreditë dhe investimet në letra me vlerë (Figura 19). Rikuperimi i ambientit ekonomik në vend dhe në ekonominë globale ndikuan në rritjen e besimit të

Figura 19. Kontributi në rritjen e aseteve të sistemit bankar sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

⁷ Kur kemi parasysh që për PBB-në është shfrytëzuar projeksioni i PBB-së për tërë vitin 2011, raporti i gjithsej aseteve ndaj PBB-së mund të jetë nënvlerësuar.

bankave komerciale, që u pasqyrua përmes rritjes më të shpejtë të kreditimit në ekonominë e Kosovës dhe rritjes së investimeve në letrave me vlerë në tregjet e jashtme. Kreditë dhe investimet në letra me vlerë kontribuuan në normën e rritjes vjetore të gjithsej asetëve me 9.9 përkatësisht 4.1 pp në vitin 2011, përderisa kontribut negativ në rritjen e gjithsej asetëve kishte bilanci me bankat komerciale që kontribuoi me -1.4 pp.

Aktiviteti i sistemit bankar vazhdon të jetë i përqendruar në aktivitetin ndërmjetësues financiar brenda ekonomisë së Kosovës, ndërkaq 25.3 përqind e asetëve në qershor 2011 ishin të investuara në sektorin e jashtëm (24.5 përqind në qershor 2010). Investimet në sektorin e jashtëm kryesisht përbëhen nga plasmanët e bankave komerciale që operojnë në Kosovë në bankat jashtë vendit si dhe nga investimet në letra me vlerë.


Tabela 7. Struktura e asetëve të sistemit bankar

Përshkrimi	Qershor 2008		Qershor 2009		Qershor 2010		Qershor 2011	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	184.5	11.5	241.9	12.5	268.1	12.1	265.3	10.6
Bilanci me bankat komerciale	200.4	12.5	286.7	14.9	351.6	15.8	319.5	12.8
Letrat me vlerë	43.4	2.7	34.1	1.8	114.0	5.1	205.6	8.2
Kreditë dhe lizingu	1089.7	68.1	1,280.9	66.5	1,404.6	63.3	1,624.9	65.0
Asetet fikse	33.4	2.1	40.1	2.1	42.6	1.9	45.0	1.8
Asetet tjera	48.2	3.0	43.5	2.3	37.8	1.7	40.8	1.6
Gjithsej	1,599.6	100.0	1,927.1	100.0	2,218.8	100.0	2,501.1	100.0

Burimi: BQK (2011)

Struktura e asetëve të sistemit bankar vazhdon të dominohet nga kreditë, të cilat në qershor 2011 rritën pjesëmarrjen në gjithsej asetet në 65.0 përqind nga 63.3 përqind në qershor 2010, gjë që reflekton trendin e përsheptuar të rritjes së kreditimit gjatë kësaj periudhe (Tabela 1). Investimet në letra me vlerë jashtë vendit vazhduan trendin e rritjes edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Duke arritur shumën prej 205.6 milion euro në qershor 2011 (114.0 milion euro në qershor 2010), pjesëmarrja e investimeve në letra me vlerë në gjithsej asetet e sistemit bankar arriti në 8.2 përqind, e cila paraqet nivelin më të lartë të investimeve të bankave në letra me vlerë që nga viti 2006. Investimet e bankave komerciale në letra me vlerë kryesisht përbëhen nga investimet në letra me vlerë të qeverive (86.2 përqind), korporatave financiare (13.6 përqind) dhe korporatave jofinanciare (0.2 përqind). Përsheptimi i rritjes së kreditimit dhe investimeve të bankave në letra me vlerë ka ndikuar në zvogëlimin e disa kategorive të tjera të asetëve të sistemit bankar, siç janë rezervat e bankave në BQK si dhe depozitat e bankave komerciale që operojnë në Kosovë në bankat jashtë vendit. Rezervat e bankave komerciale në BQK u zvogëluan nga 185.6 milion euro në qershor 2010 në 169.9 milion euro në qershor 2011, që paraqet një rënie vjetore prej 8.5 përqind (Figura 20). Përkundër zvogëlimit, rezervat e bankave komerciale vazhdojnë të jenë më të mëdha se sa niveli minimal i kërkuar nga

Figura 20. Normat vjetore të rritjes së komponentëve të asetëve, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

Investimet në letra me vlerë ka ndikuar në zvogëlimin e disa kategorive të tjera të asetëve të sistemit bankar, siç janë rezervat e bankave në BQK si dhe depozitat e bankave komerciale që operojnë në Kosovë në bankat jashtë vendit. Rezervat e bankave komerciale në BQK u zvogëluan nga 185.6 milion euro në qershor 2010 në 169.9 milion euro në qershor 2011, që paraqet një rënie vjetore prej 8.5 përqind (Figura 20). Përkundër zvogëlimit, rezervat e bankave komerciale vazhdojnë të jenë më të mëdha se sa niveli minimal i kërkuar nga


Banka Qendrore. Trend i ngjashëm karakterizoi edhe bilancet e bankave komerciale në vend me bankat jashtë vendit, të cilat shënuan rënie vjetore prej 13.9 përqind. Zvogëlimi i këtyre dy kategorive të aseteve dhe rritja investimeve të bankave drejtë kredive dhe investimeve në letra me vlerë tregon për një orientim të investimeve të sistemit bankar drejtë produkteve financiare më profitabile.

6.2.2 Kreditë

Aktiviteti kredidhënës i bankave komerciale vazhdon të përfaqësojë një ndër burimet kryesore të financimit për konsumin dhe investimet në vend. Rikuperimi i tregjeve financiare në ekonomitë e jashtme dhe përmirësimi i perceptimeve të bankave komerciale për ambientin ekonomik në Kosovë ka ndikuar në rritjen e besimit të bankave komerciale kundrejt ambientit të përgjithshëm ekonomik dhe, si rrjedhojë, kreditë e lëshuara nga


sistemi bankar i Kosovës u karakterizuan me një trend të përsheptuar të rritjes. Vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga sistemi bankar i Kosovës arriti vlerën prej 1.6 miliard euro në qershor 2011 (34.3 përqind e PBB-së), që paraqet një normë vjetore të rritjes prej 15.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 9.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Zhvillime të ngjashme karakterizuan edhe kreditë e reja të lëshuara nga sistemi bankar, të cilat në gjashtë muajtë e parë të vitit 2011 shënuan vlerën prej 433.1 milion euro, një rritje vjetore prej 15.8 përqind (Figura 21). Kjo ka bërë që aktiviteti kredidhënës i bankave në Kosovë ti kthehet normave dy shifrore të rritjes, pas një periudhe të ngadalësimit që pasoi tronditjet në ekonominë globale në dy vitet e kaluara. Përderisa në vitin e kaluar rritjen më të theksuar e kishin shënuar kreditë për ekonomitë familjare, ndërsa shtrëngimi i kredidhënies kryesisht kishte peshuar mbi kreditë për ndërmarrjet, gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 ishte pikërisht kreditimi i ndërmarrjeve private promotori kryesor i rritjes së nivelit të përgjithshëm të kredive të lëshuara nga sistemi bankar. Kreditë e lëshuara për ndërmarrjet shënuan rritje vjetore prej 13.5 përqind, duke kontribuar kështu me 9.5 pp në rritjen e gjithsej kredive (1.4 pp në qershor 2010). Në anën tjetër, kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare ngadalësuan trendin e rritjes gjatë kësaj periudhe, duke shënuar një normë vjetore të rritjes prej 16.9 përqind, krahasuar me normën e rritjes prej 32.5 përqind në qershor 2010 (Figura 22). Si rrjedhojë, edhe kontributi i kredive për ekonomitë familjare

Figura 21. Kreditë e reja në baza mujore, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

Figura 22. Norma vjetore e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2011)


në rritjen e gjithsej kredive të sistemit bankar ishte më i vogël gjatë kësaj periudhe (5.0 pp në qershor 2011, krahasuar me 7.9 pp në qershor 2010). Rritja e besimit të bankave komerciale ndaj ndërmarrjeve, si sektor me ndjeshmëri më të lartë ndaj lëvizjeve në ekonominë e brendshme dhe atë globale, ka ndikuar edhe në zvogëlimin e kostos së financimit të kreditimit për ndërmarrjet private, gjë që mund të ketë ndikuar edhe në rritjen e kërkesës për kredi nga ky sektor. Ndërsa, ngadalësimi i kredidhënies për ekonomitë familjare, deri në një masë, mund të jetë rrjedhojë e orientimit më të madh të sistemit bankar drejtë kreditimit të ndërmarrjeve gjatë kësaj periudhe.

Përkundër rritjes së përsheptuar të kredive për ndërmarrjet, pjesëmarrja e tyre në gjithsej kreditë në qershor 2011 ishte më e ulët krahasuar me qershor 2010. Pjesëmarrja e kredive për ndërmarrjet në qershor 2011 ishte 69.2 përqind, krahasuar me 70.6 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ndërkaq, kreditë për ekonomitë familjare vazhduan rritjen e pjesëmarrjes së tyre, duke arritur në 29.7 përqind në qershor 2011 krahasuar me 29.4 përqind në qershorin e vitit 2010 (Figura 23).

Struktura e kredive të lëshuara për ndërmarrjet, sipas veprimtarisë ekonomike, vazhdoi të jetë e ngjashme me periudhat e kaluara. Kreditë për sektorin e shërbimeve vazhdojnë të dominojnë strukturën e përgjithshme të kredive për ndërmarrjet me një pjesëmarrje prej 71.4 përqind. Në kuadër të kredive për sektorin të shërbimeve, pjesa më e madhe vazhdon të përbëhet nga kreditë e lëshuara për sektorin e tregtisë, të


cilat në qershor 2011 përfaqësuan 52.5 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet (Figura 24). Pjesëmarrje të konsiderueshme posedojnë edhe kreditë e lëshuara për sektorin e industrisë (që përfshinë minierat, prodhimtarinë, industrinë dhe ndërtimtarinë), të cilat përfaqësuan 25.1 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet. Një ndër sektorët me më së paku kredi të pranuar nga sistemi bankar vazhdon të jetë sektori i bujqësisë, me vetëm 3.6 përqind të gjithsej kredive të sistemit bankar në qershor 2011, pjesëmarrje kjo më e vogël krahasuar me vitin e kaluar (4.0 përqind). Kjo sugjeron se qasja konzervatore e sistemit bankar kundrejt sektorit të bujqësisë nuk ka shënuar ndonjë përparim përgjatë viteve të fundit. Kreditë e lëshuara për sektorin e bujqësisë, përveç vëllimit të ulët, karakterizohen edhe me normat më të larta të interesit, gjë e cila reflekton nivelin e lartë

Figura 23. Struktura e kredive sipas sektorëve, në



Burimi: BQK (2011)

Figura 24. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje




Burimi: BQK (2011)

të pasigurisë së bankave lidhur me kreditimin e këtij sektori. Niveli i lartë i normave të interesit për këtë sektor mund të dekurajojë edhe kërkesën për këto kredi, gjë e cila po ashtu mund të jetë një ndër faktorët që po i kontribuon vëllimit të ulët të kredive për sektorin e bujqësisë.

Përderisa kreditimi i pothuajse të gjithë sektorëve të ekonomisë shënoi ngadalësim të rritjes në qershor 2011, kreditë për sektorin e tregtisë dhe shërbimet tjera (shërbime tjera tregtare, shërbime hoteliere dhe restorante dhe shërbime tjera) u karakterizuan me trend më të shpejtë të rritjes. Andaj, përshpejtimi i rritjes së kreditimit të ndërmarrjeve në vitin 2011 mund të themi se ishte kryesisht rezultat i rritjes më të shpejtë të kredive për sektorin e tregtisë dhe shërbimeve tjera, përderisa kreditë për sektorët e tjerë të ekonomisë kishin trend më të ngadalshëm të rritjes. Kreditë për sektorin e tregtisë në qershor 2011 arritën vlerën prej 589.5 milion euro, duke shënuar rritje vjetore prej 21.3 përqind. Gjithashtu, kreditimi i ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime financiare arriti vlerën 24.8 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 37.0 përqind. Kreditë për sektorin e industrisë u karakterizuan me trend më të ngadalshëm të rritjes gjatë kësaj periudhe. Në qershor 2011, kreditë për sektorin e industrisë shënuan rritje vjetore prej vetëm 4.8 përqind, krahasuar me rritjen prej 20.6 përqind në qershor 2010. Brenda sektorit të industrisë, përpos minierave që shënuan rritje si në vëllim ashtu edhe në pjesëmarrje ndaj gjithsej kredive për ndërmarrjet, kreditimi i gjithë sektorëve tjerë shënoi ngadalësim. Kreditë për minierat, përkundër pjesëmarrjes ende të vogël në gjithsej kreditë për ndërmarrjet (1.1 përqind), shënuan një rritje vjetore prej 61.0 përqind në qershor 2011, duke arritur vlerën prej 12.7 milionë euro. Zvogëlimi i pjesëmarrjes së kredive të alokuara për sektorin e bujqësisë ishte rezultat i ngadalësit të rritjes në vëllimin e këtyre kredive. Kreditë për bujqësinë u rritën me vetëm 0.8 përqind në qershor 2011, krahasuar me rritjen prej 2.2 përqind në qershor 2010. Vlera e gjithsej kredive për bujqësinë në qershor 2011 arriti në 40.1 milion euro.

Sa i përket afatit të maturimit, kreditë me afat më të gjatë maturimi kanë vazhduar të dominojnë strukturën e gjithsej kredive, megjithëse u karakterizuan me zvogëlim të pjesëmarrjes në periudhën raportuese. Në qershor 2011, gjithsej kreditë me maturitet mbi dy vite përfaqësuan 68.6 përqind të gjithsej kredive të sistemit bankar (71.8 përqind të gjithsej kredive në qershor 2010). Struktura e kredive sipas afatit të maturimit vazhdoi të dominohet nga kreditë me afat maturimi mbi dy vite deri në pesë vite, që përbënë 41.8 përqind të gjithsej kredive në qershor 2011 (41.9 përqind në qershor 2010), pasuar nga kreditë me afat maturimi mbi pesë vite deri në dhjetë vite, të cilat përfaqësuan 22.8 përqind të gjithsej kredive (25.5 përqind të gjithsej kredive në qershor 2010). Rritje të pjesëmarrjes në vitin 2011 shënuan kreditë me afat maturimi deri në dy vite, që në qershor 2011 përbënë 31.4 përqind të gjithsej kredive krahasuar me 28.2 përqind të gjithsej kredive në periudhën e njëjtë në vitit e kaluar (Figura 25). Sa i përket rritjes së vlerës së kredive sipas afatit të maturimit,

Figura 25. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

në qershor 2011, kreditë me afat maturimi mbi një vit deri në dy vite shënuan rritje vjetore prej 26.6 përqind (rënie vjetore prej 34.8 përqind në qershor 2010), pasuar nga kreditë me maturitet prej mbi dy vite deri në pesë vite që shënuan rritje vjetore prej 15.9 përqind (rënie vjetore prej 31.8 përqind në qershor 2010). Kreditë me afat maturimi deri në një vit u karakterizuan me rritje vjetore prej 29.4 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 10.6 përqind në qershorin e vitit paraprak.

6.2.3 Detyrimet

Aktiviteti i sistemit bankar të Kosovës vazhdon të financohet duke u mbështetur kryesisht në burimet e financimit brenda ekonomisë së vendit, konkretisht në depozitat e mbledhura nga qytetarët brenda Kosovës. Në qershor 2011, depozitat kishin një pjesëmarrje prej 78.3 përqind në gjithsej detyrimet e sistemit bankar (Tabela 2). Një burim tjetër i rëndësishëm i financimit për bankat komerciale në vend janë edhe mjetet vetanake (kapitali vetanak), që në qershor 2011 kishin një pjesëmarrje prej 9.6 përqind. Megjithatë, duhet të theksohet se si depozitat ashtu edhe mjetet vetanake janë karakterizuar me një trend më të ngadalëshëm të rritjes gjatë vitit 2011, gjë që u reflektua edhe në pjesëmarrjen e tyre në gjithsej detyrimet. Mjetet vetanake shënuan rritje vjetore prej 6.9 përqind në qershor 2011, krahasuar me rritjen vjetore prej 10.3 përqind në qershor të vitit 2010. Rritja vjetore e fitimit të mbajtur të bankave me normë prej 30.8 përqind në qershor 2011 (-4.3 përqind në qershor 2010) ndikoi pozitivisht në rritjen e përgjithshme të vlerës së mjeteve vetanake, përdërisa ngadalësimi i rritjes së këtyre mjeteve kryesisht ishte pasojë e ngadalësimit të normës së rritjes së kapitalit aksionar të bankave nga 10.0 përqind në qershor 2010 në 3.7 përqind në qershor 2011.

Tabela 8. Struktura e detyrimeve të sistemit bankar

Përshkrimi	Qershor 2008		Qershor 2009		Qershor 2010		Qershor 2011	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	32.6	2.0	41.8	2.2	65.1	2.9	86.6	3.5
Depozitat	1264.4	79.0	1513.0	78.5	1751.5	78.9	1957.8	78.3
Huatë tjera	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Detyrimet tjera	112.4	7.0	152.1	7.9	152.4	6.9	183.1	7.3
Borxhi i ndërvuar	7.0	0.4	16.9	0.9	24.4	1.1	33.5	1.3
Mjetet vetanake	183.2	11.5	203.3	10.5	224.3	10.1	239.9	9.6
Gjithsej detyrimet	1,599.6	100.0	1,927.1	100.0	2,218.8	100.0	2,501.1	100.0

Burimi: BQK (2011)

Aktiviteti i sistemit bankar në vend, i përqendruar në kredidhënie, vijon të financohet kryesisht nga depozitat e qytetarëve të Kosovës. Megjithatë, që nga viti 2009 është vënë re një tendencë e rritjes së shfrytëzimit të financimit nga jashtë, duke mundësuar kështu rritjen e potencialit të bankave komerciale për të zgjeruar kredidhënien. Një nga komponentët e detyrimeve që ka shënuar rritje të vazhdueshme është borxhi i ndërvuar (angl. subordinated debt), që në qershor 2011, arriti vlerën 33.5 milion euro nga 24.4 milion euro sa ishte në qershorin e vitit paraprak. Megjithatë, pjesëmarrja e borxhit të ndërvuar në gjithsej detyrimet e sistemit bankar mbetet e ulët në vëtëm 1.3 përqind (1.1 përqind në qershor 2010). Gjithsej detyrimet e sistemit bankar ndaj sektorit të jashtëm arritën vlerën 212.8 milion euro në qershor 2011 (158.6 milion euro në qershor 2010) dhe përbëhen kryesisht nga kreditë (52.8 përqind të gjithsej detyrimeve të sistemit bankar ndaj sektorit të jashtëm) dhe depozitat e jorezidentëve në bankat komerciale që operojnë në Kosovë (47.2 përqind të gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm).


6.2.4 Depozitat

Në qershor 2011, gjithsej depozitat në sistemin bankar të Kosovës arritën vlerën prej 1.9 miliard euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 11.8 përqind. Trendi i ngadalësuar i rritjes vjetore që karakterizoi depozitat që nga qershori i vitit 2009 ishte evident edhe gjatë kësaj periudhe, kur norma e rritjes së depozitave ishte për 4.0 pp më e ulët krahasuar me vitin e kaluar. Ngadalësimi i rritjes së vlerës së depozitave ishte kryesisht pasojë e zvogëlimit të depozitave të qeverisë në bankat komerciale.⁸ Përjashtuar depozitat e qeverisë, vlera e gjithsej depozitave tjera shënoi rritje vjetore prej 21.3 përqind në qershor 2011 (6.8 përqind në qershor 2010), duke rezultuar kryesisht nga rritja e depozitave të ekonomive familjare dhe depozitave të ndërmarrjeve publike.

Burimi kryesor i depozitave për sistemin bankar të Kosovës vazhdojnë të jenë depozitat e ekonomive familjare, që në qershor 2011 arritën vlerën prej 1.4 miliard euro (69.2 përqind e gjithsej depozitave). Megjithatë, në periudhën e fundit është vënë re një tendencë ngadalësimi në rritjen e depozitave të ekonomive familjare, kur kemi parasysh rritjen vjetore prej 19.0 përqind në qershor 2011 krahasuar me rritjen

prej 26.3 përqind në qershor 2010. Ngadalësimi i rritjes vjetore të vlerës së depozitave të ekonomive familjare nuk u reflektua edhe në pjesëmarrjen e këtyre depozitave në gjithsej depozitat, që shënoi rritje për 4.2 pp (69.2 përqind të gjithsej depozitave në qershor 2011) (Figura 26). Depozitat e ndërmarrjeve në qershor 2011 arritën vlerën prej 380.0 milion euro, një rritje vjetore prej 24.1 përqind në qershor 2011, krahasuar me rënie vjetore prej 36.1 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritje më të theksuar shënuan depozitat e ndërmarrjeve publike, të cilat nga 75.7 milion euro në qershor 2010 arritën vlerën prej 119.0 milion euro në qershor të vitit 2011. Rritja e depozitave të ndërmarrjeve publike kryesisht rezultoi nga rritja e depozitave të ndërmarrjeve më të mëdha shërbyese si PTK-së, KEK-ut dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Rritje të pjesëmarrjes në gjithsej depozitat e sistemit bankar në vend kanë shënuar edhe depozitat e institucioneve tjera financiare dhe depozitat e jorezidentëve. Pjesëmarrja e depozitave të jorezidentëve në sistemin bankar të Kosovës është karakterizuar me trend rritës që nga qershori i vitit 2008. Depozitat e institucioneve tjera financiare arritën vlerën 102.7 milion euro në qershor 2011, një rritje vjetore prej 21.7 përqind. Depozitat e kompanive të sigurimit dhe fondeve pensional kanë pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të gjithsej depozitave të institucioneve tjera financiare. Në qershor 2011, depozitat e kompanive të sigurimit dhe fondeve pensionale kishin një pjesëmarrje prej 92.6 përqind në gjithsej depozitat që institucionet tjera financiare mbajnë në bankat komerciale, përderisa pjesëmarrja e mbetur ndahet mes institucioneve mikrofinanciare dhe ndihmësve financiarë.

Figura 26. Struktura e depozitave sipas sektorëve, në përqindje




Burimi: BQK (2011)

⁸ Zvogëlimi i depozitave të qeverisë ishte pasojë e tërheqjes së vazhdueshme të këtyre depozitave nga bankat komerciale gjatë vitit 2010 me përfundimin e ciklit të maturimit të tyre. Këto depozita rezultuan nga transferimi i dividendës së Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK) në llogari të qeverisë në tetor 2009.

Vlera e depozitave të jorezidentëve arriti në 99.7 milion euro në qershor 2011, që tregon për një rritje vjetore prej 33.7 përqind. Depozitat e jorezidentëve kishin një pjesëmarrje prej 5.1 përqind në gjithsej depozitat e sistemit bankar në qershor 2011 krahasuar me 4.3 përqind në qershorin e vitit të kaluar. Rritja e vazhdueshme e depozitave të jorezidentëve në vend është rezultat i normave të favorshme të interesit në depozita si dhe rritjes së besimit të publikut kundrejt sistemit bankar të Kosovës, gjë që ka rezultuar nga stabiliteti dhe performanca e mirë e këtij sistemi. Depozitat në sistemin bankar në Kosovë kanë ekspozim minimal ndaj lëvizjeve potenciale në normën e këmbimit, duke qenë se rreth 96.1 përqind e depozitave mbahen në valutën euro.

Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit vazhdoi të dominohet nga depozitat e afatizuara që përfaqësuan rreth 50.0 përqind të gjithsej depozitave në qershor 2011, pasuar nga depozitat e transferueshme dhe depozitat e kursimeve, të cilat përfaqësuan rreth 32.7 përkatësisht 17.3 përqind të gjithsej depozitave (Figura 27).

Figura 27. Struktura e depozitave të afatizuara sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

Depozitat me afat më të shkurtër maturimi vazhdojnë të dominojnë strukturën e depozitave të afatizuara. Në qershor 2011, depozitat me afat maturimi deri në një vit përfaqësuan 58.3 përqind të gjithsej depozitave të afatizuara, pasuar nga depozitat me afat maturimi mbi një vit deri në dy vite që përfaqësuan 24.1 përqind të gjithsej depozitave të afatizuara. Nëse vëzhgojmë trendin që kanë ndjekur depozitat e afatizuara gjatë vitit 2011, vëmë re një tendencë të rritjes së pjesëmarrjes së depozitave me afat më të gjatë maturimi dhe njëkohësisht, zvogëlimit të pjesëmarrjes së depozitave me afat më të shkurtër maturimi. Kështu, depozitat me afat maturimi deri në një vit zvogëluan pjesëmarrjen e tyre në gjithsej depozitat e afatizuara për 19.7 pp, ndërkaq depozitat me afat maturimi mbi dy vite kanë rritur pjesëmarrjen për 2.9 pp. Rritje më të theksuar të pjesëmarrjes kanë shënuar depozitat me afat maturimi mbi një vit deri në dy vite (16.9 pp). Një faktor që mund të ketë ndikuar pozitivisht në rritjen e depozitave me afat më të gjatë maturimi është edhe aprovimi i ligjit mbi sigurimin e depozitave, me ndikim direkt në rritjen e mëtejme të besimit të depozituesve në bankat komerciale. Po ashtu, normat më atraktive të interesit për depozitat me afat më të gjatë të maturimit paraqesin një faktor të rëndësishëm për zgjatjen e afatit të maturimit të depozitave.

6.2.5 Normat e interesit

Gjatë vitit 2011, lëvizja e normave të interesit u karakterizua me një tendencë të lehtë rënëse si për normat në depozita ashtu edhe për normat e interesit në kredi. Norma mesatare e interesit në depozita për gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 u zvogëlua në 3.4 përqind nga 3.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Një rënie e lehtë u shënuar edhe në normat e interesit në kredi, të cilat në gjysmën e parë të vitit 2011 kishin një mesatare prej 14.3 përqind, krahasuar me 14.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Dallimi në mes të normave të interesit në depozita dhe kredi (angl. interest rate


spread) në gjysmën e parë të vitit 2011 kishte një mesatare prej 10.9 pp, që paraqet një rritje vjetore prej 0.2 pp (Figura 28).

Normat e interesit për depozitat e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare ishin të ngjashme në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011. Norma mesatare e interesit për depozitat e ndërmarrjeve në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011 zbriti në 3.6 përqind nga 4.0 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë në vitin paraprak. Trend të ngjashëm ndoqën edhe normat e interesit për depozitat e ekonomive familjare, që zbritën në 3.6 përqind nga 3.9 përqind sa ishin në qershor

2010. Në anën tjetër, në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011, norma mesatare e interesit për kreditë e ekonomive familjare zbriti në 12.3 përqind (12.7 përqind në qershor 2010), ndërkaq norma mesatare e interesit për kreditë e ndërmarrjeve zbriti në 15.6 përqind (16.2 përqind). Sa i përket normave mesatare të interesit për kreditë e ekonomive familjare, përjashtim bëjnë kreditë konsumuese, që shënuan rritje të normës mesatare në këtë gjashtëmuajor, krahasuar me gjashtëmuajorin paraprak për 0.2 pp, duke arritur në 13.9 përqind. Normat e interesit në kreditë për blerjen e patundshmërive mbetën në nivel të njëjtë me gjysmën e parë të vitit paraprak, gjegjësisht në 11.4 përqind.

Sipas afatit të maturimit, normat më të larta të interesit u evidentuan për depozitat e ndërmarrjeve me afat maturimi mbi një vit deri në dy vite, të cilat arritën një mesatare prej 5.4 përqind në qershor 2011. Në kuadër të depozitave të ndërmarrjeve, norma më e ulët u ofrua për depozitat me afat maturimi deri në një muaj (2.3 përqind në qershor 2011). Për sa i përket depozitave të ekonomive familjare, norma më e lartë e interesit u ofrua për depozitat me afat maturimi mbi dy vite (5.1 përqind), përderisa norma më e ulët mesatare u ofrua për depozitat me afat maturimi mbi një muaj (2.5 përqind). Sipas qëllimit të shfrytëzimit të kredisë, kreditë dhënë ndërmarrjeve për qëllime investimi bartin norma më të ulëta të interesit krahasuar me kreditë dhënë ndërmarrjeve për qëllime tjera të shfrytëzimit. Norma më e ulët mesatare e interesit që paguajnë bizneset për kreditë investive është ofruar te kreditë me afat maturimi mbi pesë vite (12.1 përqind në qershor 2011), përderisa norma më e lartë mesatare e interesit u ofrua për kreditë investive me afat maturimi deri në një vit (17.9 përqind në qershor 2011). Po ashtu, kreditë e ofruara ndërmarrjeve për çështje tjera kanë normën më të lartë të interesit nëse kredia ka maturitet deri në një vit (18.7 përqind në qershor 2011) dhe normën më të ulët të interesit nëse kredia ka maturitet mbi pesë vite (13.5 përqind në qershor 2011). Sa i përket kredive për blerjen e patundshmërive, kreditë me maturitet mbi dhjetë vite kishin normë më të ulët të interesit (10.6 përqind në qershor 2011), krahasuar me kreditë me maturitet prej pesë deri në dhjetë vite (12.0 përqind në qershor 2011).

Figura 28. Mesatarja gjashtë mujore e normave të interesit, në përqindje




Burimi: BQK (2011)

6.3. Performanca dhe Rreziqet e Sistemit Bankar

Përkundër zhvillimeve dhe ambientit jo edhe aq të favorshëm në ekonominë globale, performanca e sistemit bankar të Kosovës vazhdoi të jetë pozitive dhe të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe ekonomik të vendit. Në periudhën qershor 2010 - qershor 2011, sistemi bankar i Kosovës regjistroi performancë pozitive edhe pse mund të vërehet një rënie e lehtë krahasuar me vitin paraprak (Figura 29). Sistemi bankar vazhdoi të jetë profitabil, por me një rënie të lehtë të indikatorëve të profitabilitetit. Bankat komerciale që operojnë në Kosovë në vazhdimësi kanë treguar kujdes të veçantë në menaxhimin e rreziqeve. Në këtë kontekst,

Figura 29. Harta e stabilitetit financiar




Burimi: BQK (2011)

bankat u treguan mjaft të kujdesshme dhe konzervative në menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, rrezikun kreditor dhe rrezikun e solvencës. Treguesit e likuiditetit, edhe pse kanë shënuar rënie të lehtë, vazhdojnë të dëshmojnë nivel të kënaqshëm të aftësisë së sistemit bankar për plotësimin e detyrimeve afatshkurtëra. Sa i përket rrezikut kreditor, mund të veçohet një rënie e cilësisë së portofolit kreditor, por duhet të theksohet fakti se kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara nga provizionet për humbje nga kreditë, çka nënkupton se niveli aktual i kredive joperformuese nuk paraqet ndonjë kërcënim serioz për qëndrueshmërinë e sistemit bankar. Për më tepër, sistemi bankar i Kosovës vazhdon të karakterizohet si njëri ndër sistemet me cilësinë më të mirë të portofolit kreditor në kuadër të vendeve të rajonit. Qasja e kujdesshme e sistemit bankar të Kosovës për sa i përket ruajtjes së qëndrueshmërisë shprehet edhe përmes shkallës së kapitalizimit, e cila në vazhdimësi është mbajtur në nivel mjaft të lartë, gjë që ka zvogëluar rrezikun e solvencës. Në qershor 2011, treguesit e kapitalizimit vazhduan të tejkalojnë kërkesat e rregullatorit, madje tejkaloan edhe standardet ndërkombëtare për menaxhimin e rrezikut të solvencës.

6.3.1 Performanca e sistemit bankar

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2011, sistemi bankar raportoi profit neto në vlerë prej 14.9 milionë euro, që është për 13 përqind më i ulët se sa në qershor 2010 (Figura 30). Zvogëlimi i profitit kryesisht ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të shpenzimeve në krahasim me të hyrat e përgjithshme të sistemit bankar, përkundër faktit se

Figura 30. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

ndërmjetësimi financiar shënoi rritje gjatë kësaj periudhe. Ndikimin më të madh në rritjen e shpenzimeve gjatë kësaj periudhe e kishte rritja e provizioneve për mbulimin e humbjeve potenciale nga kreditë.

Në qershor të vitit 2011, të hyrat e përgjithshme të sistemit bankar shënuan vlerën 114.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.2 përqind (Figura 31). Gjatë kësaj periudhe, të hyrat e përgjithshme nga interesi arritën në 93.7 milionë euro (84.5 milionë euro në qershor 2010), ndërsa të hyrat nga jointerеси ishin 21.1 milionë euro (18.7 milionë euro në qershor 2010). Përshpejtimi i rritjes së të hyrave të sistemit bankar ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të kreditimit të ekonomisë. Rritja e kreditimit ndikoi në rritjen e të hyrave nga interesi në kredi, që përbëjnë burimin kryesor të të hyrave për sistemin bankar. Në qershor 2011, të hyrat nga interesi në kredi shënuan vlerën prej 89.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.9 përqind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 33).

Ndikim pozitiv në rritjen e të hyrave nga interesi kishin edhe fondet e sistemit bankar të Kosovës që investohen në formë të plasmanëve në bankat jashtë vendit. Në qershor 2011, edhe përkundër faktit që plasmanët në bankat jashtë vendit u zvogëluan për 9.1 përqind, të hyrat nga kjo kategori ishin 1.9 milionë euro dhe shënuan një rritje vjetore prej 64.9 përqind. Ngritja e normës bazë të interesit nga ana ECB-së ndikoi edhe në ngritjen e normave të interesit në tregun ndërbankar jashtë vendit, gjë që u shfrytëzua mjaft mirë nga bankat vendore për të rritur të hyrat.


Figura 31. Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve



Burimi: BQK (2011)


93.7 milionë euro (84.5 milionë euro në qershor 2010), ndërsa të hyrat nga jointerеси ishin 21.1 milionë euro (18.7 milionë euro në qershor 2010).

Figura 32. Struktura e të hyrave, në përqindje



Burimi: BQK (2011)


Figura 33. Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive



Burimi: BQK (2011)

Të hyrat nga investimet në letra me vlerë vazhduan trendin rritës edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, duke arritur në 1.7 milionë euro apo një rritje prej 21.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ngritja e performancës së kësaj kategorie të të hyrave kryesisht ishte si rrjedhojë e vazhimit të rritjes së investimeve të bankave në letra me vlerë. Po ashtu, ndikim kishte edhe rritja e kostos së financimit të borxhit shtetëror (rritja e kthimit në obligacionet shtetërore) në disa vende të eurozonës, në të cilat bankat kanë investuar mjete prej të cilave inkasuan më shumë të ardhura nga interesi.

Figura 34. Struktura e të hyrave sipas kategorive, në përqindje




Burimi: BQK (2011)

Struktura e të hyrave të përgjithshme të sistemit bankar vazhdon të dominohet prej të hyrave nga interesi në kredi (Figura 34). Pjesëmarrja e kësaj kategorie shënoi një rënie të lehtë krahasuar më vitin paraprak dhe qëndroi në 78.3 përqind të gjithsej të hyrave të sistemit bankar (79.3 përqind në qershor 2010). Pjesëmarrja e lartë e kësaj kategorie shpjegohet me mungesën e zhvillimit të tregjeve dhe instrumenteve financiare në vend, gjë që do të ndikonte në rritjen e mundësive të bankave për të diversifikuar strukturën e investimeve dhe, rrjedhimisht, strukturën e të hyrave. Përqendrimi i lartë në të hyrat nga interesi në kredi bënë që të hyrat e sistemit bankar të ketë nivel mjaft të lartë të ndjeshmërisë ndaj performancës së një segmenti të veçantë të afarizmit bankar, që në rastin tonë është aktiviteti kredidhënës.

Peshë të rëndësishme në strukturën e të hyrave të përgjithshme të sistemit bankar zënë edhe të hyrat nga tarifat e komisionet në produktet bankare. Në qershor 2011, pjesëmarrja e të hyrave nga tarifat dhe komisionet ishte e ngjashme me vitin paraprak, duke qëndruar në 16.9 përqind. Kjo kategori e të hyrave në vitet e fundit ka shënuar rritje të pjesëmarrjes në gjithsej të hyrat e sistemit bankar si rrjedhojë e rritjes së gamës së shërbimeve nga ana e bankave.

Në qershor të vitit 2011, shpenzimet e sistemit bankar të Kosovës arritën vlerën prej 98.0 milionë euro, një rritje vjetore prej 16.9 përqind krahasuar me rënien prej 6.5 përqind në qershor 2010. Edhe pse bankat ishin relativisht të suksesshme në menaxhimin e përgjithshëm të shpenzimeve operacionale, përkeqësimi i cilësisë së portofolit kreditor gjatë periudhës qershor 2010 - qershor 2011 ndikoi mjaft në rritjen e shpenzimeve të provizioneve për mbulimin e humbjeve potenciale nga kreditë. Në qershor 2011, shpenzimet e provizioneve

Figura 35. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2011)


arritën në 19.7 milionë euro, që paraqet një rritje të konsiderueshme duke marrë parasysh se në qershor 2010 ishin vetëm 9.5 milionë euro. Nevoja për rritjen e provizioneve kryesisht i atribuohet rritjes së kredive joperformuese në sektorin bankar gjatë kësaj periudhe, gjë që detyroi bankat të ndajnë mjete shtesë për të mbuluar humbjet potenciale.

Me rritje u karakterizuan edhe shpenzimet e përgjithshme dhe administrative të sistemit bankar, të cilat në gjysmën e parë të vitit 2011 regjistruan një rritje vjetore prej 8.9 përqind, duke arritur vlerën prej 45.9 milionë euro (Figura 35). Në kuadër të këtyre shpenzimeve, rritje më të theksuar shënuan shpenzimet e tjera të jointeredit, të cilat shënuan vlerën prej 6.5 milionë euro apo një rritje prej 15.6 përqind krahasuar me vitin paraprak. Shpenzimet për personel dhe shpenzimet për qira u rritën për 8.9 përkatësisht 6.8 përqind.

Kategoria e vetme e shpenzimeve që shënoi rënie gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 ishin shpenzimet për interes, të cilat shënuan një rënie të lehtë vjetore prej 0.9 përqind, duke arritur vlerën prej 28.2 milionë euro. Këtu mund të veçohet rënia e shpenzimeve për interes në depozita nga 25.9 milionë euro sa ishin në qershor 2010, në 24.4 milionë euro në qershor 2011, përkundër rritjes së vëllimit të përgjithshëm të depozitave gjatë kësaj periudhe. Zvogëlimi i shpenzimeve për interes në depozita ishte si rrjedhojë e rënies së lehtë të normave të interesit për depozitat në sistemin bankar të Kosovës.


Struktura e shpenzimeve të sistemit bankar vazhdon të dominohet nga kategoria e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, mirëpo pjesëmarrja e kësaj kategorie ka shënuar rënie të vazhdueshme (Figura 36). Në qershor të vitit 2011, pjesëmarrja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative në gjithsej shpenzimet e sistemit bankar ishte 46.9 përqind (50.3 përqind në qershor 2010). Ndërsa, kategoria e shpenzimeve të interesit ka shënuar zvogëlim të pjesëmarrjes në gjithsej shpenzimet nga 33.9 përqind në qershor 2010 në 28.8 përqind në qershor 2011. Rritjen më të madhe në pjesëmarrje në strukturën e gjithsej shpenzimeve e ka shënuar kategoria e shpenzimeve të jointeredit, e cila në qershor 2011 arriti në 24.4 përqind të gjithsej shpenzimeve nga 15.8 përqind në qershor 2010. Në këtë kategori të shpenzimeve marrin pjesë edhe shpenzimet për provizione, të cilat përbëjnë 82.7 përqind të gjithsej shpenzimeve të jointeredit.

Figura 36. Struktura e shpenzimeve e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

Figura 37. Struktura e shpenzimeve e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)


6.3.2. Profitabiliteti dhe Efikasiteti i sistemit bankar

Zvogëlimi i profitit neto u reflektua edhe në përkeqësimin e treguesve të profitabilitetit të sistemit bankar, siç janë Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Asset: ROAA) dhe Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity: ROAE). Në qershor të vitit 2011, ROAA që po ashtu mund të shërbejë edhe si indikator i efikasitetit të sistemit bankar, shënoi rënie duke zbritur në 1.2 përqind krahasuar me 1.5 përqind në qershor 2010 (Figura 37). Po ashtu, ROAE zbriti në 12.9 përqind krahasuar me 14.9 përqind në vitin 2010.

Rritja më e shpejtë e shpenzimeve krahasuar me të hyrat ka ndikuar në përkeqësimin e shumicës së indikatorëve të efikasitetit për sistemin bankar. Një prej indikatorëve më të rëndësishëm për matjen e efikasitetit të sistemit bankar është raporti ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave (Figura 38). Në qershor 2011, ky raport u ngrit në 85.4 përqind nga 81.2 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Përkundër rritjes në periudhën e fundit, ky tregues vazhdon të jetë në nivel më të ulët krahasuar me vitin 2009 (87.9 përqind). Rënie të efikasitetit në sistemin bankar sugjeron edhe raporti ndërmjet të hyrave dhe gjithsej asetëve, që u zvogëlua në 4.59 përqind nga 4.65 përqind në qershor 2010. Përkeqësimi i këtij indikator sugjeron se sistemi bankar ishte më pak efikas në gjenerimin e të hyrave nga shfrytëzimi i asetëve.

Sidoqoftë, në disa aspekte vërehet rritje e efikasitetit të sistemit bankar edhe gjatë kësaj periudhe. Përkundër rritjes së numrit të të punësuarëve në periudhën e fundit, vlera mesatare e asetëve të menaxhuara nga një punëtor shënoi rritje vjetore prej 7.3 përqind në qershor 2011, duke arritur në 684.4 mijë euro (Tabela 9). Përmirësimi i këtij treguesi ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të asetëve të sistemit bankar gjatë kësaj periudhe (rritje vjetore prej 12.7 përqind në qershor 2011).

Figura 38. Raporti shpenzime/të hyra, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

Tabela 9. Treguesit e efikasitetit të sistemit bankar, në mijëra euro

Përshkrimi	Qershor 2008	Qershor 2009	Qershor 2010	Qershor 2011
Asete/nr. i punëtorëve	467.6	503.6	637.9	684.4
Profiti/nr. i punëtorëve	6.9	3.2	5.4	4.1
Numri i kredive/nr. i punëtorëve	68.0	66.6	75.8	92.3
NIM (në përqindje)	4.1	3.4	3.0	2.6

Burimi: BQK (2011)

Rritje e efikasitetit është shënuar edhe për sa i përket numrit mesatar të kredive të lëshuara për një punëtor, që në qershor 2011 u ngrit në 92.3 krahasuar me 75.8 në qershor

2010. Margjina Neto e Interesit (angl. Net Interest Margin: NIM) gjatë kësaj periudhe ishte 3.0 përqind dhe nuk ka pësuar ndonjë ndryshim krahasuar me vitin paraprak.

6.4. Rreziqet e Sistemit Bankar

6.4.1 Rreziku i likuiditetit


Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të karakterizohet me shkallë të kënaqëshme të likuiditetit, e cila bënë që detyrimet e bankave komerciale ndaj depozituesve dhe huadhënësve tjerë të kryhen me kohë dhe pa vështirësi. Shkalla e kënaqshme e likuiditetit në bankat komerciale që operojnë në vend është rezultat i menaxhimit të kujdesshëm të bilancit të gjendjes së bankave komerciale si në aspektin e aseteve ashtu edhe të detyrimeve. Në anën e aseteve, përkundër faktit që struktura e aseteve në masë të madhe dominohet nga kreditë, bankat kanë qenë të kujdesshme që të mbajnë nivele të mjaftueshme të aseteve edhe në instrumente më likuide. Ndërsa, për sa i përket anës së detyrimeve në bilancin e gjendjes, depozitat e mbledhura brenda Kosovës vazhdojnë të përfaqësojnë burimin kryesor të financimit për operacionet e sistemit bankar. Mbështetja e lartë në depozita si burim financimi ka bërë që bankat të kenë një burim më stabil të financimit dhe mos të bazohen në fonde afatshkurtëra, oferta e të cilave është më e luhatshme dhe kanë kosto më të lartë të financimit.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, struktura e financimit të bankave komerciale në Kosovë nuk ka shënuar ndonjë ndryshim të theksuar, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në qershor 2011, depozitat vazhduan të përfaqësojnë kategorinë dominuese në kuadër të gjithsej detyrimeve të sistemit bankar me një pjesëmarrje prej 78.3 përqind (78.9 përqind në qershor 2010). Një formë tjetër e financimit për operacionet bankare është edhe borxhi i ndërvarur i cili ka shënuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2010. Në qershor 2011, borxhi i ndërvarur përfaqësointe 1.3 përqind (1.1 në qershor 2010) të gjithsej detyrimeve. Ndërsa, pjesa tjetër e financimit përbëhet nga burimet vetanake që përfaqësojnë 9.6 përqind (10.1 përqind në qershor 2010) të gjithsej detyrimeve.

Një indikator i rëndësishëm i shkallës i likuiditetit në sistemin bankar është raporti ndërmjet kredive dhe depozitave. Gjatë pjesës së parë të vitit 2011, norma më e lartë e rritjes së kredive krahasuar me normën e rritjes së depozitave ka bërë që raporti kredi-depozita të shënojë rritje. Në qershor 2011, raporti kredi-depozita qëndroi në 83.0 përqind përderisa në qershor 2010 ky raport ishte 80.2 përqind (Figura 39). Raporti aktual ndërmjet kredive dhe depozitave është kryesisht në linjë me rekomandimet e BQK-së që bankat të mirëmbajnë raportin ndërmjet kredive dhe depozitave në mesatarisht 80 përqind.

Një tjetër tregues i rëndësishëm për shkallën e likuiditetit në sistemin bankar është raporti ndërmjet aseteve likuide dhe gjithsej aseteve. Në bazë të definicioneve të përdorura nga

Figura 39. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

FMN-ja, asetet likuide ndahen në asete likuide “themelore” dhe asete likuide “gjithëpërfshirëse” (angl. core liquid assets dhe broad liquid assets).⁹ Norma më e lartë e rritjes së kredive, të cilat janë instrumente që nuk klasifikohen si asete likuide, ka ndikuar në zvogëlimin e pjesëmarrjes së aseteve likuide, si ‘core’ ashtu edhe ‘broad’, në gjithsej asetet. Në qershor 2011, pjesëmarrja e aseteve likuide ‘core’ në gjithsej asetet e sistemit bankar qëndronte në 24.3 përqind, që paraqet një rënie prej 5pp krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjatë së njëjtës periudhë, pjesëmarrja e aseteve likuide ‘broad’ në gjithsej asetet qëndronte në 29.8 përqind që po ashtu paraqet një rënie prej 2.3 pp krahasuar me vitin paraprak. Zvogëlimi i pjesëmarrjes së aseteve likuide në gjithsej asetet kryesisht i atribuohet zvogëlimit të mjeteve të cilat investoheshin në formë të plasmanëve nga bankat që operojnë në Kosovë te bankat jashtë vendit.

Tregues tjetër i rëndësishëm për shkallën e likuiditetit është raporti ndërmjet aseteve likuide dhe detyrimeve afatshkurtëra. Përmes këtij treguesi mund të vlerësohet aftësia e bankave për të plotësuar detyrimet në afat të shkurtër, me fjalë të tjera, për të plotësuar kërkesat për tërheqje të depozitave apo pagim të borxheve tjera brenda një afati të shkurtër kohor. Në qershor 2011, raporti ndërmjet aseteve likuide ‘core’ dhe detyrimeve afatshkurta ishte 31.1


përqind (36.9 përqind në qershor 2010). Ndërsa, raporti ndërmjet aseteve likuide ‘broad’ dhe detyrimeve afatshkurta ishte 38.1 përqind (40.5 përqind në qershor 2010), (Figura 40). Sistemi bankar i Kosovës në vazhdimësi ka mirëmbajtur rezervat e likuiditetit në nivel më të lartë se sa niveli minimal i kërkuar nga Banka Qendrore. Bazuar në rregullat në fuqi, në dhjetor 2010 bankat komerciale që operojnë në Kosovë ishin të obliguara të mbanin mjete rezerve në shumën prej 159.5 milionë euro, përderisa rezervat e likuiditetit të mbajtura nga bankat në këtë periudhë kishin arritur vlerën prej 216.9 milionë euro, duke tejkaluar për 57.4 milionë euro nivelin e rezervës së obliguar. Gjendja e rezervave vazhdoi të jetë e ngjashme edhe deri në qershor 2011, kur vlera e rezervave të detyrueshme për bankat komerciale ishte 177.6 milionë euro, ndërsa bankat kishin të ndara mjete rezervë në vlerë prej 262.7 milionë euro, duke tejkaluar për 85.1 milionë euro nivelin e rezervës së detyrueshme (Figura

Figura 40. Raporti asete likuide "broad"/detyrime afatshkurtëra



Burimi: BQK (2011)

Figure 41. Rezervat e sistemit bankar bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)


⁹ Asetet likuide ‘core’ përfshijnë paranë e gatshme dhe bilancin në BQK, si dhe llogaritë rrjedhëse në bankat tjera dhe plasmanet në bankat tjera me maturitet deri në 90 ditë. Asetet likuide broad’ përfshijnë asetet likuide ‘core’ si dhe asetet e tregtueshme dhe letrat me vlerë me maturitet deri në 90 ditë.

41). Ky nivel i likuiditetit bënë që sistemi bankar i Kosovës të ketë nivel mjaft të lartë të qëndrueshmërisë edhe kundrejt tronditjeve të ndryshme potenciale në tregjet e fondeve financiare ose kundrejt tronditjeve të natyrës së tërheqjeve më të mëdha të depozitave, gjë e cila sugjerohet edhe nga rezultatet e stres-testit mbi rrezikun e likuiditetit (Seksioni 6.5.2). Sidoqoftë, shikuar nga aspekti i efikasitetit të sistemit bankar, rezervat e “tepërta” të likuiditetit janë të kushtueshme duke pasur parasysh faktin që bankat paguajnë interes për shfrytëzimin e atyre mjeteve, përderisa nuk pranojnë të hyra në kthim.

Bankat komerciale që operojnë në Kosovë vazhdimisht kanë treguar kujdes të lartë edhe për sa i përket strukturës së investimeve në tregjet e jashtme si në kontekst të produkteve financiare ashtu edhe në kontekst të vendeve ku janë investuar mjetet e tyre. Investimet e sistemit bankar të Kosovës në tregjet e jashtme kryesisht janë bërë në vendet dhe institucionet që janë pjesë e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (angl. EBRD) dhe, rrjedhimisht, këto investime konsiderohen të kenë shkallë më të lartë të sigurisë.


Struktura e investimeve të bankave në letra me vlerë në tregjet e jashtme kryesisht përqendrohet në tri kategori kryesore, të cilat përbëhen nga investimet në fletëobligacione të qeverive, të korporatave financiare dhe të korporatave jofinanciare. Në qershor të vitit 2009, 98.1 përqind e mjeteve të investuara në letra me vlerë përbëheshin nga fletëobligacione të korporatave financiare. Gjatë kësaj periudhe këto fletëobligacione konsideroheshin se bartin rrezik të ulët dhe kthim më të lartë në krahasim me alternativat tjera. Mirëpo, me evoluimin e krizës financiare gjatë vitit 2009, bankat komerciale që operojnë në Kosovë në mënyrë drastike ndryshuan strategjinë investive në letra me vlerë. Në figurën 42 mund të vërehet se si nga mesi i vitit 2009 bankat në vazhdimësi kanë zhvendosur investimet e tyre nga letrat me vlerë të korporatave financiare drejtë letrave me vlerë të qeverive. Në qershor 2010, 81.5 përqind e mjeteve të investuara në letra me vlerë ishin fletëobligacione qeveritare. Në përgjithësi, fletëobligacionet qeveritare konsiderohen me rrezik më të ulët por edhe me kthim më të ulët në krahasim me fletëobligacionet e korporatave financiare. Mirëpo, duke marrë parasysh që shumë vende, e në veçanti disa nga vendet e eurozonës, po përballen me probleme të borxhit të jashtëm, kjo

Figura 42. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

Figura 43. Hendeku i likuiditetit, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

ka ndikuar në rritjen e premieeve për fletëobligacionet qeveritare. Si rrjedhojë, edhe gjatë pjesës së parë të vitit 2011, bankat kanë rritur investimet në fletëobligacione qeveritare dhe, në qershor 2011, pjesëmarrja e mjeteve të investuara në këto instrumente arriti në 86.2 përqind të gjithsej investimeve në letra me vlerë. Ndërsa, vetëm 0.2 përqind të gjithsej mjeteve të investuara në letra me vlerë vazhdon të investohet në fletëobligacione të korporatave jofinanciare. Ekspozimi i bankave komerciale që operojnë në Kosovë në letrat me vlerë të korporatave jofinanciare mbetet tejet marginal, gjë që ndikon në zvogëlimin e përgjithshëm të rrezikut të aseteve të sistemit bankar, sidomos duke pasur parasysh ndjeshmërinë e lartë të tregjeve të aksioneve gjatë periudhave të krizave, gjë që është vërejtur qartë edhe në periudhat e fundit.

Analiza e hendekut të likuiditetit (angl. liquidity gap analysis) paraqet një tjetër mënyrë të vlerësimit të rrezikut të likuiditetit. Përmes kësaj analize përlllogaritet mjaftueshmëria e mjeteve me një afat të caktuar maturimi për përmbushjen e detyrimeve me po atë afat maturimi. Analiza e hendekut të likuiditetit është e bazuar në idenë se vlera e aseteve që maturojnë brenda një afati të caktuar duhet të përputhet me vlerën e detyrimeve që maturojnë brenda atij afati. Dallimi në mes këtyre dy shumave paraqet hendekun e maturitetit apo mospërputhjen në maturitet. Nëse vlera e aseteve është më e madhe se vlera e detyrimeve brenda një afati të caktuar të maturimit¹⁰ atëherë mund të thuhet se hendeku është pozitiv. Ndërsa, nëse vlera e aseteve është më e vogël se vlera e detyrimeve brenda një afati të caktuar të maturimit atëherë hendeku është negativ. Nga figurën 43, mund të vërehet se mospërputhja më e theksuar e afatit të maturimit është në kategorinë prej 'më shumë se 1 vit', ku vlera e aseteve që kanë këtë afat maturimi prej 'më shumë se një vit' në masë të konsiderueshme tejkalon vlerën e detyrimeve që kanë afat prej 'më shumë se një vit'.

Duke marrë parasysh se në sistemin bankar të Kosovës pjesa më e madhe e aseteve përbëhet nga kreditë si dhe pjesa më e madhe e detyrimeve përbëhet nga depozitat, atëherë mospërputhja e afatit të maturimit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve kryesisht pasqyron dallimet në mes të afatit të maturimit të kredive dhe depozitave. Në qershor 2011, 91.4 përqind e depozitave kishin afat maturimi prej 'më pak se 1 vit' (91.4 përqind në qershor 2010), ndërsa në të njëjtën periudhë, 53.4 përqind e gjithsej kredive kishin afat maturimi prej 'më shumë se 1 vit' (53.0 përqind në qershor 2011). Kjo mospërputhje ndërmjet afateve të maturimit të kredive dhe depozitave vështirëson menaxhimin e likuiditetit nga sistemi bankar. Andaj, bankat duhet të përqendrohen më shumë në tërheqjen e detyrimeve me afat maturimi më të gjatë, gjë që do ngushonte hendekun e afatit të maturimit, dhe në këtë mënyrë do të zvogëlonte rrezikun e likuiditetit. Po ashtu, rritja e fondeve me afat më të gjatë maturimi do të mund të ndikonte në zvogëlimin e kostos së financimit si dhe rritjes së mëtejme të kreditimit me afat më të gjatë maturimi.

Niveli i lartë ekzistues i likuiditetit në sistemin bankar bënë që zvogëlimi i disa nga indikatorët e likuiditetit të mos ketë ndikim të madh në gjendjen e përgjithshme të likuiditetit të këtij sistemi, duke bërë që bankat që operojnë në Kosovë pa ndonjë vështirësi të mund të vazhdojnë plotësimin e detyrimeve të tyre. Vazhdimi i rritjes së depozitave, madje me normë edhe më të lartë se sa në periudhën e kaluar, tregon për rritje të vazhdueshme të besimit të publikut në sistemin bankar dhe po ashtu paraqet një shtyllë të rëndësishme të likuiditetit për këtë sektor.

¹⁰ Maturiteti i aseteve dhe detyrimeve ndahet në këto periudha: 1 deri 7 ditë, 8 deri 30 ditë, 91 deri në 180 ditë, 181 deri në 365 ditë dhe më shumë se 1 vit.

6.4.2 Rreziku kreditor

Trendet pozitive në aktivitetin ekonomik në vend gjatë pjesës së dytë të vitit 2010 si dhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 ndikuan në përshpejtimin e rritjes së kreditimit nga sistemi bankar. Megjithatë, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, vërehet një përkeqësim i lehtë në cilësinë e portfolit kreditor, përkundër faktit që rritja ekonomike vazhdoi të jetë pozitive. Duke marrë parasysh se cilësia e kredive reagon me vonesë ndaj performancës së përgjithshme të ekonomisë dhe duke u bazuar në rezultatet e studimit të EFSE mund të sugjerohet se përkeqësimi i portfolit kreditor në masë të madhe është reflektim i rënies së cilësisë së kredive të lëshuara gjatë vitit 2007 dhe 2008, kur kreditimi në ekonomi regjistroi normat më larta të rritjes (Kutia 3).

Kutia 5. Ngarkesa me Borxh dhe Performanca e Kredive të Klientëve Mikro kreditor në Kosovë.

Në nëntor 2011, Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. European Fund for Shoutheast Europe: EFSE) në bashkëpunim me Qendrën Mikrofinanciare (angl. Microfinance Center) publikuan studimin mbi mbingarkesën e klientëve të mikro-kredive në Kosovë me borxh.¹¹ Qëllimi kryesor i studimit ishte të studiohet niveli i ngarkesës me borxh si dhe sjellja e klientëve që shfrytëzojnë mikro kreditë. Po ashtu, studimi u fokusua në identifikimin e faktorëve që kanë ndikuar në performancën e kredive, gjegjësisht në aftësinë e kredimarrësve për të kthyer kredinë. Studimi është bërë gjatë periudhës shtatorit 2010 - korrikut 2011, ndërsa në mostër janë përfshirë 1200 klientë të mikro kredive.¹² Nga gjithsej klientët, 61 përqind janë klientë të institucioneve mikrofinanciare, ndërsa 39 përqind janë klientë të sistemit bankar.

Gjetja kryesore e raportit sugjeron se klientët mikro kreditor në Kosovë nuk janë të mbingarkuar me borxh, gjë e cila sugjeron për aftësi të mirë paguese të këtyre klientëve, duke marrë parasysh se llogaritja e nivelit të ngarkesës me borxh ka marrë për bazë të hyrat mujore të ekonomive familjare përkatësisht profitet mujore të ndërmarrjeve dhe shumën mujore të pagesës së borxhit të këtyre klientëve. Në kuadër të klientëve të përfshirë në këtë studim, vetëm 25 përqind e tyre kanë rezultuar të jenë të mbingarkuar me borxh, prej të cilëve shtatë përqind kanë rezultuar josolvent.

Studimi ofron edhe një pasqyrë mjaftë të mirë të karakteristikave të klientëve mikro kreditor në Kosovë përmes së cilës tentohet të shpjegohen edhe faktorët që kanë përcaktuar performancën e mikro kredive. Një nga segmentet e hulumtuara në këtë studim ka të bëjë me garancionet kreditore të kredimarrësve në Kosovë, ku rezultatet sugjerojnë se klientët të cilët janë garantues të kredive që nuk performojnë mirë kanë më tepër të ngjarë të kenë probleme edhe në vetë kthimin e kredive të tyre. Kjo mund të ndodhë për shkak se performanca jo e mirë e kredisë për të cilën është garantuar e ngarkon edhe vetë garantuesin me pagesën e kësaj kredie, gjë e cila e rritë ngarkesën me borxh për klientin garantues dhe dobëson aftësinë e tij paguese. Kjo parashton nevojën që garantuesit potencial të kredive të klientëve të tjerë të pajisen në mënyrë më të mirë me informata rreth implikimeve potenciale të garancioneve kreditore dhe po ashtu kërkon një qasje më të kujdesshme nga bankat për sa i përket kreditimit të klientëve, të cilët veç janë garantues të klientëve të tjerë. Studimi po ashtu raporton se klientët që kanë më tepër se një kredi kanë më tepër probleme në kthimin e kredisë, krahasuar me klientët që kanë vetëm një kontratë kreditore aktive.

Studimi trajton kreditë edhe në aspekt të vitit kur janë lëshuar ato dhe vërehet se kreditë që janë lëshuar në vitin 2007 dhe 2008 janë paraqitur të jenë më problematike për sa i përket ripagimit. Deri në një masë, kjo mund të atribuohet rritjes më të shpejtë që ka shënuar aktiviteti kredidhënës në Kosovë gjatë këtyre dy viteve, kur norma vjetore e rritjes së kredisë bankare kishte arritur në 40.1

¹¹ EFSE and Microfinance Centre (2011), Study on Indebtedness of Microcredit Clients in Kosovo.


¹² Mikro kredia është definuar si kontratë kredie për qëllime afariste, e cila në momentin e lëshimit ka një vlerë deri në 10,000 euro.

përkatësisht 32.7 përqind, krahasuar me 8.9 dhe 13.2 përqind, përkatësisht, për vitet 2009 dhe 2010. Rritja më e shpejtë e kredisë gjatë viteve 2007 dhe 2008 mund të jetë prirë nga kritere më të relaksuara të kreditimit, gjë e cila ka mund të rezultojë në sigurimin e qasjes në kredi edhe për klientët me rankim jo të mirë kreditor. Sidoqoftë, studimi po ashtu raporton se problemet e kthimit të kredisë më së shumti paraqiten në fazat afër maturimit të afatit të kthimit të kredisë, gjë e cila mes tjerash mund të ndodhë edhe për shkak të vlerësimit joadekuat të performancës së pritshme të kredimarrësit nga ana e institucioneve kredidhënëse ose nga paraqitja e faktorëve të paparashikuar me ndikim në performancën e kredimarrësit. Duke pasur parasysh që studimi është bërë në periudhën 2010-2011, kjo gjetje deri diku shpjegon faktin që kreditë e lëshuara gjatë vitit 2007 dhe 2008 kanë rezultuar më proplematike për sa i përket kthimit, pasi që ato tani mund të jenë afër përfundimit të afatit të maturimit.

Përzgjedhja e klientëve për tu kredituar nga institucionet kredidhënëse në Kosovë mjaft shumë vështirësohet nga historia e shkurtë e kredimarrësve në vend, gjë e cila deri diku i atribuohet edhe periudhës relativisht të shkurtër të funksionimit të sistemit financiar të Kosovës. Bazuar në të dhënat e raportuara në studim, 49 përqind e huamarrësve mikrokreditor kanë përvojë kreditore prej jo më tepër se dy vite. Kjo pasiguri që rrjedhë nga historia e shkurtër kreditore e klientëve mund të paraqes edhe një ndër faktorët me ndikim në normat e interesit në vend, të cilat vazhdojnë të konsiderohen si të larta. Sidoqoftë, kontribut të rëndësishëm në zvogëlimin e pasigurisë gjatë fazës së përzgjedhjes së klientëve për tu kredituar nga institucionet kredidhënëse ka dhënë zhvillimi i Regjistrimit të Kredive të Kosovës nga ana e BQK-së, që ka mundësuar shkëmbimin e historisë kreditore dhe informatave tjera kreditore ndërmjet këtyre institucioneve për të gjithë kredimarrësit.

Në qershor 2011, pjesëmarrja e kredive të klasifikuara në gjithsej portofolin kreditor vazhdoi trendin rritës, duke u ngritur në 10.7 përqind nga 10.2 përqind sa ishte në qershor 2010 (9.0 përqind në qershor 2009).¹³ Rritje ka shënuar edhe pjesëmarrja e kredive me probleme në gjithsej kreditë, e cila në qershor 2011 arriti në 8.2 përqind krahasuar me 7.1 përqind sa ishte në qershor 2010 (5.6 përqind në qershor 2009) (Figura 44).

Figura 44. Struktura e kredive sipas klasifikimit



Burimi: BQK (2011)


¹³ Bazuar në rregulloren e BQK-së, kreditë në sistemin bankar të Kosovës klasifikohen në pesë kategori kryesore: standarde, vrojtuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë e klasifikuara përfshijnë kategoritë: vrojtuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë me probleme përfshijnë kategoritë: nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë jopërfomuese përfshijnë kategoritë: të dyshimta dhe të humbura.

Kategoria më e rëndësishme për sa i përket përshkrimit të cilësisë së portfoliot kreditor përbëhet nga Kreditë Joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL). Në qershor 2011, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej portofolin kreditor të sistemit bankar arriti në 5.9 përqind nga 4.5 përqind sa ishte në qershor 2010. Në figurën 45 mund të shihet se në tremujorin e parë të vitit 2011, NPL-të arritën në 6.2 përqind, që njëherit paraqet nivelin më të lartë NPL-ve që nga fillimi i funksionimit të sistemit bankar të Kosovës. Sidoqoftë, gjatë tremujorit të dytë të vitit, NPL-të u rikthyen në normën prej 5.9 përqind, që njëherësh tregon për një gjendje relativisht stabile në cilësinë e portfoliot kreditor. Në qershor 2011, vlera e përgjithshme e NPL-ve arriti në 94.2 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 30.6 përqind.

Megjithatë, vazhdimi i rritjes së vlerës së NPL-ve me ritëm më të shpejtë në krahasim me rritjen e gjithsej kredive do të nënkuptonte edhe përkeqësim të mëtutjeshëm të cilësisë së portfoliot kreditor (Figura 46). Vështirësitë nëpër të cilat po kalon ekonomia e eurozonës, e të cilat mund të reflektohen edhe në sektorin real të ekonomisë së Kosovës, parashtrojnë nevojën për vazhdim të rrjedhjes së kredisë bankare, si një burim i rëndësishëm financimi për sektorin real të ekonomisë së Kosovës, por në të njëjtën kohë parashtrojnë nevojën edhe për një kujdes të shtuar për sa i përket respektimit të standardeve të kreditimit të shëndoshë nga ana e bankave komerciale.


Nga gjithsej tetë banka sa operojnë në Kosovë, në qershor 2010, gjashtë prej tyre shënuan përkeqësim në cilësinë e portfoliot kreditor, ndërsa vetëm një bankë raportoi zvogëlim të pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej portofolin kreditor.

Figura 45. Raporti NPL/gjithsej kreditë, në përqindje




Burimi: BQK (2011)

Figura 46. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve



Burimi: BQK (2011)

Figura 47. Struktura e kredive joperformuese, në përqindje




Burimi: BQK (2011)

Struktura e NPL-ve, vazhdon të dominohet nga kreditë e klasifikuara si të humbura, të cilat përbëjnë 59.5 përqind të gjithë NPL-ve, kurse kreditë e klasifikuara si të dyshimta përbëjnë 40.5 përqind të gjithë NPL-ve. Nga figura 47 mund të vërehet rënie e pjesëmarrjes së kredive të klasifikuara si të humbura, ndërsa pjesëmarrja e kredive të klasifikuara si të dyshimta ka shënuar rritje.

Struktura e NPL-ve sipas agjentëve ekonomik tregon se rritje të NPL-ve ka pasur si te kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare ashtu edhe te kreditë e lëshuara për bizneset (Figura 48). Në qershor 2011, nga gjithësej kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare, 1.8 përqind përfaqësoheshin nga kreditë joperformuese krahasuar me 1.2 përqind në qershor 2010. Ndërsa, për sa i përket kredive të lëshuara për ndërmarrjet, 5.7 përqind e këtyre kredive ishin joperformuese krahasuar me 5.0 përqind sa ishin në qershor 2010. Kjo strukturë e NPL-ve tregon se, krahasuar me kreditë për ekonomitë familjare, kreditë e lëshuara për ndërmarrjet vazhdojnë të jenë më problematike për sa i përket kthimit.


Shikuar sipas industrisë, sektori i tregtisë paraqet sektorin më të rëndësishëm për sistemin bankar të Kosovës për sa i përket madhësisë së ekspozimit. Përkeqësimi i cilësisë së kredive gjatë kësaj periudhe ishte i pranishëm edhe te kreditë e lëshuara për sektorin e tregtisë, te të cilat NPL-të rritën pjesëmarrjen në 6.4 përqind të gjithë kredive, krahasuar me 5.1 përqind në qershor 2010 (Figura 49). Një tjetër sektor i rëndësishëm që shënoi rritje të NPL-ve ishte edhe sektori i shërbimeve ku NPL-të rritën pjesëmarrjen nga 4.7 përqind në qershor 2010 në 5.4

Figura 48. NPL-të sipas sektorëve, në përqindje




Burimi: BQK (2011)

Figura 49. NPL-të sipas industrive



Burimi: BQK (2011)

Figura 50. NPL-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2011)

përqind në qershor 2011. Përmirësim i cilësisë u regjistrua në portofolin e kredive për sektorin e minierave, prodhimtarisë, bujqësisë si dhe atë të ndërtimtarisë. Gjatë kësaj periudhe, bankat u treguan më të kujdesshme në kreditimin e këtyre sektorëve duke zvogëluar ekspozimin kreditor ndaj tyre.

Sistemi bankar i Kosovës në vazhdimësi është treguar mjaft konservativ për sa i përket mbulimit të NPL-ve me provizione për humbje nga kreditë. Mirëpo, rritja më e lartë e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej portofolin kreditor ka ndikuar në zvogëlimin e mbulueshmërisë së kredive me provizione. Megjithatë, niveli aktual i provizioneve vazhdon të mbulojë me mbi 100 përqind vlerën e përgjithshme të kredive joperformuese dhe, si i tillë, nuk kërcënon stabilitetin financiar. Në qershor 2011, shkalla e mbulimit të NPL-ve me provizione për humbje nga kreditë ishte 117 përqind, kurse mesatarja për katër vitet e fundit ishte 129 përqind (Figura 50). Shuma e përgjithshme e provizioneve në qershor 2011 arriti në 109.9 milionë euro ose për 25.9 milionë euro më e lartë se sa në vitin paraprak.


6.4.2.1 Koncentrimi i rrezikut kreditor

Analiza e koncentrimin të rrezikut kreditor mundëson identifikimin e rreziqeve të mundshme për sistemin bankar që mund të rrjedhin nga ekspozimet e mëdha kreditore kundrejt një numri të caktuar të kredimarrësve, kredi këto që mund të kërcënojnë më seriozisht stabilitetin e sistemit bankar në rast të dështimit të tyre. Rritja e ekspozimeve të mëdha paraqet nivel më të lartë të rrezikut kreditor, pasi që në këtë mënyrë sistemi bëhet më i

ndjeshëm ndaj performancës së një numri të caktuar të kredive, të cilat kanë peshë më të madhe në gjithsej portofolin kreditor. Në këtë kontekst, rritja e koncentrimin të rrezikut kreditor paraqet ndjeshmëri më të lartë të sistemit bankar ndaj performancës së një dege të caktuar të industrisë apo një grupi të caktuar të kredimarrësve.

Sipas rregulloreve të BQK-së, kreditë të cilat tejkalojnë 10 përqind të kapitalit të klasit të parë klasifikohen si ekspozime të mëdha. Deri në qershor 2011, shuma e kredive që konsiderohen si ekspozime të mëdha vazhdoi të rritet. Në këtë periudhë, shuma e ekspozimeve të mëdha arriti në 131.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 49.0 përqind (Figura 51). Ndërsa, numri i kredive të klasifikuara si ekspozime të mëdha në qershor 2011 ishte 41 krahasuar me 43 në qershor 2010. Rritja e shumës së ekspozimeve të mëdha dhe, në anën tjetër, zvogëlimi i numrit të këtyre ekspozimeve tregojnë për rritje të shkallës së koncentrimin kreditor. Rritja e shkallës së koncentrimin shprehet edhe nga raporti ndërmjet ekspozimeve të mëdha dhe kapitalit të klasit të parë, që në qershor 2011 arriti në 55.6 përqind nga 39.9 përqind në qershor 2010.

Figura 51. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK (2011)


6.4.3 Rreziku i solvencës

6.4.3.1 Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit

Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të karakterizohet nga një shkallë e lartë e solvencës, me një shkallë kapitalizimi që në vazhdimësi ka tejkalar minimumin e kërkuar rregullativ. Shkalla e kapitalizimit paraqet një nga treguesit më të rëndësishëm të qëndrueshmërisë së sistemit bankar, duke pasur parasysh faktin që kapitali konsiderohet të jetë shtylla kryesore për mbulimin e humbjeve potenciale në rast të ndonjë tronditje në sistemin bankar. Për më tepër, struktura e kapitalit të sistemit bankar të Kosovës përmban një normë mjaft të lartë të kapitalit të klasit të parë, gjë që paraqet një cilësi mjaft të mirë të kapitalit të sistemit bankar.

Niveli aktual i kapitalizimit të sistemit bankar të Kosovës, shprehur përmes Treguesit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR)¹⁴, është mjaft i kënaqshëm duke marrë parasysh se dukshëm tejkalon normën minimale prej 12 përqind të përcaktuar nga BQK-ja (Figura 52). Në qershor 2011, CAR për sistemin bankar qëndronte në 17.2 përqind. Megjithatë, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, CAR shënoi një rënie prej 0.5 pp, e cila kryesisht i atribuohet rritjes më të shpejtë të aseteve të peshuara ndaj rrezikut (angl. Risk Weighted Assets: RWA) në krahasim me rritjen e kapitalit. Në qershor 2011, norma vjetore e rritjes së kapitalit ishte 9.4 përqind, përderisa norma e rritjes së RWA-ve shënoi rritje vjetore prej 19.2 përqind. Rritja e RWA-ve gjatë kësaj periudhe kryesisht reflekton normën më të lartë të rritjes së kredive të lëshuara nga sistemi bankar si dhe zërave jashtë-bilancor, të cilat përfaqësojnë komponentët kryesore të RWA-ve.

Figura 52. Kapitalizimi i sistemit bankar



Burimi: BQK (2011)

Tabela 10. Distribimi i aseteve sipas shkallës së CAR

Përshkrimi	Numri i Bankave			Përqindja e gjithsej aseteve të menaxhuara nga bankat		
	12-15 %	15-18%	> 18 %	12-15 %	15-18%	> 18 %
2008	1	1	6	38.9%	35.6%	25.5%
2009	0	6	2	0.0%	84.6%	15.4%
2010	3	1	4	13.9%	14.7%	71.4%
2011	2	2	4	14.6%	19.3%	66.1%

Burimi: BQK, 2011

¹⁴ Sipas rregullave të BQK-së, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me RWA-të.

Përveç raportimit të CAR-së për tërë sistemin, rëndësi të veçantë ka edhe analiza e këtij treguesi në kontekst të bankave individuale. Gjatë periudhës observuese, gjashtë banka shënuan zvogëlim të CAR-së, ndërsa dy banka shënuan rritje. Sidoqoftë, është i rëndësishëm fakti se të gjitha bankat që operojnë në Kosovë janë mirë të kapitalizuara dhe nuk kanë pasur ndonjë vështirësi në përmbushjen e kriterit prej 12 përqind për normën e CAR-së. Në qershor 2011, pjesa më e madhe e asetëve të sistemit bankar të Kosovës menaxhoheshin nga bankat të cilat kanë nivel të CAR-së më të lartë se 18 përqind (Tabela 10).

Katër nga bankat që operojnë në Kosovë, të cilat bashkërisht menaxhojnë 66.1 përqind të gjithsej asetëve të sistemit bankar, kanë raportuar CAR më të lartë se 18 përqind. Ndërsa, dy nga gjithsej bankat, të cilat menaxhojnë 19.3 përqind të gjithsej asetëve, kanë raportuar nivel të CAR-së në intervalin nga 15 deri në 18 përqind.


Bankat komerciale që operojnë në Kosovë në vazhdimësi kanë mbajtur nivele më të larta të kapitalit se që u është kërkuar me rregulloren perkatëse të BQK-së. Në qershor 2011, gjithsej kapitali i bankave ishte 283.7 milionë euro, ndërsa gjithsej kapitali rregullator i kërkuar bazuar në rregulloren e BQK-së ishte 197.9 milionë euro (Figura 53). Kapitali i mbajtur nga bankat, në qershor 2011, tejkalonte për 85.8 milionë euro kapitalin e kërkuar rregullativ.

6.4.3.2 Kapitali

Në qershor 2011, kapitali i sistemit bankar shënoi rritje vjetore prej 9.4 përqind, duke arritur vlerën prej 283.7 milionë euro (259.3 milionë euro në qershor 2010). Që nga qershori i vitit 2008, kapitali i sistemit bankar ka ndjekur një trend rritës, por norma e rritjes shënoi ngadalësim të vazhdueshëm (Figura 54). Ngadalësimi i rritjes së gjithsej kapitalit ishte kryesisht rezultat i rritjes më të ngadalshme të kapitalit aksionar, që njëkohësisht përbën pjesën më të madhe të gjithsej kapitalit të sistemit bankar.


Kapitali i sistemit bankar të Kosovës burim kryesor të financimit vazhdon ta ketë kapitalin aksionar dhe fitimin e realizuar nga bankat. Po ashtu, bankat kanë filluar të shfrytëzojnë mënyra alternative për ta financuar kapitalin, ku mund të veçohet rritja e përdorimit të borxhit të ndërvarur (angl. subordinated debt), që kategorizohet si pjesë e kapitalit të klasit

Figura 53. Gjithsej kapitali dhe kapitali rregullativ, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

Figura 54. Gjithsej kapitali dhe norma vjetore e rritjes, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

të dytë. Ndërsa, bankat që operojnë në Kosovë vazhdojnë të mos shfrytëzojnë instrumente financiare më të sofistikuara, si për shembull instrumentet financiare hibride. Ky fakt mund të konsiderohet pozitiv sepse këto instrumente financiare bartin nivel më të lartë të rrezikut (siç u vërtetua në krizën e fundit financiare globale), me implikime të mundshme për qëndrueshmërinë e sistemit bankar.


Përveç vlerës, një element tjetër i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e sistemit bankar është edhe cilësia e kapitalit me të cilin posedon banka. Cilësia e kapitalit të një banke kryesisht i referohet madhësisë së pjesëmarrjes së kapitalit aksionar në gjithsej kapitalin e një banke, ku sa më e madhe pjesëmarrja e kapitalit aksionar aq më cilësore vlerësohet të jetë struktura e kapitalit. Sistemi bankar i Kosovës mund të konsiderohet që ka një cilësi mjaftë të mirë të kapitalit, duke pasur parasysh faktin që kapitali aksionar përbën rreth 60 përqind të gjithsej kapitalit të këtij sistemi. Cilësia e kapitalit, në mes tjerash, ka rol të rëndësishëm për rankimin kreditor të bankave, duke ndikuar drejtpërdrejtë në koston e financimit të jashtëm si dhe në lehtësinë e bankave për qasje në financim të jashtëm. Cilësia e mirë e kapitalit mund të jetë edhe njëri nga faktorët që po i mundëson sistemit bankar të Kosovës rritjen e vazhdueshme të financimit nga jashtë, ku një nga instrumente më të pranishme është borxhi i ndërvarur.

Në qershor 2011, struktura e kapitalit të sistemit bankar dominohej nga kapitali i klasit të parë që kishte vlerën prej 237.1 milionë euro, ndërsa kapitali i klasit të dytë shënoi vlerën prej 46.5 milionë euro. Gjatë katër viteve të fundit, pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin e sistemit bankar në vazhdimësi ka shënuar rënie (Figura 55). Në qershor 2011, kapitali i klasit të parë përbënte 83.6 përqind të gjithsej kapitalit të sistemit bankar (85.0 përqind në qershor 2010). Zvogëlimi ka ndodhur për shkak të rritjes së pjesëmarrjes së kapitalit të klasit të dytë, i cili arriti në 16.4 përqind nga 15.0 përqind sa ishte në qershor 2010. Brenda kapitalit të klasës së dytë, rritje më të theksuar shënoi borxhi i ndërvarur dhe provizionet e përgjithshme. Në qershor 2011, borxhi i ndërvarur shënoi rritje vjetore prej 26.5 përqind (59.3 përqind në qershor 2010). Po ashtu, provizionet e përgjithshme shënuan rritje vjetore prej 9.0 përqind (15.2 përqind në qershor 2010).

6.4.3.3 Kapitali i klasit të parë

Kapitali aksionar vazhdon të jetë kategoria dominuese në strukturën


Figura 55. Struktura e kapitalit të sistemit bankar



Burimi: BQK (2011)

shënuar rënie (Figura 55). Në qershor 2011, kapitali i klasit të parë përbënte 83.6 përqind të gjithsej kapitalit të sistemit bankar (85.0 përqind në qershor 2010). Zvogëlimi ka ndodhur për shkak të rritjes së pjesëmarrjes së kapitalit të klasit të dytë, i cili arriti në 16.4 përqind nga 15.0 përqind sa ishte në qershor 2010. Brenda kapitalit të klasës së dytë, rritje më të theksuar shënoi borxhi i ndërvarur dhe provizionet e përgjithshme.

Figura 56. Struktura e kapitalit të klasit të parë, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)


e përgjithshme të kapitalit të klasit të parë me pjesëmarrje prej 68.9 përqind. Fitimi për vitin aktual, fitimi i pashpërndarë si dhe fondet rezervë po ashtu paraqesin kategori të rëndësishme të kapitalit të klasit të parë. Në qershor 2011, kjo kategori përfaqësonte rreth 29.7 përqind të gjithsej kapitalit të klasit të parë (Figura 56). Ndërsa, mjetet jo materiale dhe vlera e emrit të mirë kishin një pjesëmarrje prej 1.4 përqind në gjithsej kapitalin e klasit të parë.

Në qershor 2011, kapitali i klasit të parë arriti vlerën prej 237.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.5 përqind. Kapitali aksionar, si kategoria kryesore e kapitalit të klasit të parë shënoi rritje vjetore prej 2.2 përqind, duke arritur vlerën prej 167.95 milionë euro. Kjo normë e rritjes së kapitalit aksionar është më e ulët se sa në qershor të vitit 2010, kur norma e rritjes ishte 10.0 përqind. Ndërsa, vlera e fitimit të vitit aktual, fitimit të pashpërndarë dhe fondeve rezervë arriti 72.51 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 22.1 përqind. Mjetet jomateriale dhe emri i mirë shënuan vlerën prej 3.32 milionë euro, që paraqet nivel të ngjashëm me vitin paraprak (3.28 milionë euro në qershor 2010).

6.4.3.4 Asetet e peshuara ndaj rrezikut

Gjithsej vlera e RWA-ve të sistemit bankar arriti në 1.65 miliardë euro në qershor 2011, që paraqet një rritje vjetore prej 19.2 përqind (16.3 përqind në qershor 2010). Struktura e RWA-ve dominohet nga asetet me peshë të rrezikut prej 100 përqind, pjesëmarrja e të cilave arriti në 77.6 përqind nga 69.0 përqind sa ishte në qershor 2010 (Figura 57). Rritja e pjesëmarrjes së kësaj kategorie është rezultat i normës më të lartë e rritjes së kredive dhe zërave jashtëbilancor. Ndërsa, asetet me peshë të rrezikut prej 75 përqind zvogëluan pjesëmarrjen në 15.8 përqind të gjithsej RWA-ve krahasuar me 24.2 përqind në qershor 2010. Kjo kategori përbëhet nga kreditë e garantuara me hipotekën e parë në pasuri të patundshme, me vonesë kthimi prej më pak se 30 ditë. Kategoria me pjesëmarrjen më të ulët në strukturën e RWA-ve përbëhet nga asetet me peshë të rrezikut prej 50 përqind, pjesëmarrja e të cilave arriti në 1 përqind të gjithsej RWA-ve nga 0.4 sa ishte në qershor 2010.¹⁵

Figura 57. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2011)

6.5. Analiza stres-test

Krahas analizimit të gjendjes aktuale të ekspozimit të sistemit bankar ndaj rrezikut kreditor, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të solvencës, analiza stres-test paraqet një vegël shtesë përmes së cilës është vlerësuar qëndrueshmëria e sektorit ndaj tronditjeve potenciale, si në portofolin kreditor ashtu edhe në asetet likuide. Rezultatet e shtjelluara më poshtë kanë për bazë të dhënat e sektorit bankar për muajin qershor 2011. Gjatë kësaj

¹⁵ Kjo kategori përbëhet nga kërkesat me maturim prej 1 viti ose më pak në bankat që veprojnë në vendet e OECD-së, por që nuk janë të klasifikuara ose që janë rankuar nga Standard & Poor's me B ose me gradë më të ulët apo që janë klasifikuar nga Moody's me P-3 ose me gradë më të ulët.

analize është testuar qëndrueshmëria e sistemit bankar të Kosovës ndaj rrezikut kreditor, të kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe rrezikun nga norma e këmbimit, si dhe është testuar aftësia e sistemit bankar që të ruaj gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike mbi tërheqjen e depozitave.

6.5.1 Rreziku kreditor

Metodologjia

Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se kriza ekonomike në vendet e Bashkimit Evropian do të vazhdojë të reflektohet në ekonominë e Kosovës përmes zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Si rezultat, kjo supozohet të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike, duke zgjeruar kështu hendekun e prodhimit dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë e portofolit kreditor. Në këtë skenar është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 4 përqind në pesë vitet e fundit si dhe është supozuar një rënie ekonomike më e theksuar prej 2.0 përqind për vitin 2011, gjë që do të rriste hendekun e prodhimit për 6.0 përqind. Për të vlerësuar ndikimin e hendekut të prodhimit në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL), janë shfrytëzuar koeficientët e elasticitetit nga një analizë e papublikuar e FMN-së për disa vende të Evropës qendrore dhe juglindore.¹⁶ Rrjedhimisht, duke konsideruar një koeficient të elasticitetit të NPL ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të rritej për 4.8pp. Rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe rrezikun nga norma e këmbimit, ku është supozuar rënie e normave të interesit dhe zhvlerësim i valutës euro ndaj valutave të tjera si rezultat i zhvillimeve në disa vende të eurozonës. Rrjedhimisht, përveç rritjes së pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë, në këtë skenar po ashtu është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan për 20 përqind¹⁷ si dhe zvogëlimi i normave të interesit për 2.0 pp. Rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve, zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe zvogëlimi i normave të interesit ndikon humbjet/fitimet në të hyrat neto nga interesi duke marrë parasysh hendekun e maturiteteve të kredive dhe depozitave. Krahas supozimeve për tronditjet e lartpërmendura, po ashtu është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se të hyrat nga 'provizionet dhe të ngjashme' dhe të hyrat tjera nga jo-interesi në vitin 2011 do të jenë ekuivalente me 60 përqind të këtyre të hyrave në vitin 2010 (kjo për shkak se është supozuar se nuk do të ketë rritje të kredive – mbeten në nivel të njëjtë), përderisa komponentet tjera të pasqyrës së të ardhurave janë supozuar të kenë nivel të ngjashëm me ato të vitit 2010.

Rritja e supozuar e NPL-ve është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, në vëzhgim, nënstandarde) drejtë kategorive joperformuese (të dyshimta dhe të humbura). Rritja e NPL-ve është shpërndarë proporcionalisht në kuadër të kategorisë së kredive të dyshimta dhe të kredive të humbura, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të këtyre kategorive në gjithsej NPL-të. Rritja e NPL-ve reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas

¹⁶ IMF unpublished note "CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise", July 2009.

¹⁷ Supozim i bazuar në të dhënat historike mbi luhatjen e kursit të këmbimit valutor euro/dollar amerikan.

klasifikimit. Supozimi për rritjen e NPL-ve aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

Me gjithë faktin se në skenarin e analizuar është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutor, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sistemit bankar vazhdon të jetë shumë i vogël. Pjesa dërmuese e portofolios së kredive është në euro, kreditimi në valutë të huaj pothuaj se nuk ekziston, duke bërë që rreziku nga norma e këmbimit valutor të mbetet minor.

Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 2pp (si për asetet ashtu edhe për detyrimet në bilancin e gjendjes). Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në margjinën neto të interesit (angl. Net Interest Margin: NIM), duke marrë parasysh afatin e maturimit të kredive dhe depozitave. Sistemi bankar i Kosovës ka ekspozim të ulët edhe ndaj këtij rreziku, me që pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sistemin bankar të Kosovës kanë normë fikse të interesit. Andaj, sistemi bankar është shumë pak i ndjeshëm ndaj lëvizjeve të normave të interesit në periudhë afatshkurtër.

Qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është vlerësuar në kuptim të ndikimit të rritjes së NPL-ve, zhvlerësimit të valutës euro dhe rënies së normave të interesit në nivelin e kapitalit rregullativ të sektorit bankar, aseteve të peshuara me rrezik dhe, rrjedhimisht, treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR).

Rezultatet

Gjendja ekzistuese e sistemit bankar të Kosovës për sa i përket kapitalizimit të bankave është mjaft e favorshme, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit në 17.2 përqind. Gjithashtu, sistemi bankar vazhdon të qëndroj mirë edhe për sa i përket nivelit të kredive jo-performuese në raport me gjithsej kreditë (5.9 përqind) dhe mbulueshmërisë së humbjeve eventuale nga këto kredi me anë të provizioneve, të cilat mbulojnë NPL-të me 116.7 përqind. Andaj, sistemi bankar tregon nivel të lartë të qëndrueshmërisë ndaj rrezikut kreditor edhe nën kushtet e paraqitjes së skenarit hipotetik të përshkruar më lartë.

Nën supozimin se pjesëmarrja e NPL-ve në portfolion e kredive të sektorit do të rritet për 4.8pp, euro do të zhvlerësohet ndaj dollarit amerikan për 20 përqind, dhe normat e interesit do të zvogëlohen për 2.0pp, në nivel të sistemit bankar në tërësi CAR do të mbetet në mbi 12 përqind, përderisa në nivel të bankave individuale vetëm njëra prej bankave do të kishte CAR nën nivelin prej 12 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore. Megjithatë, në mënyrë që niveli i CAR-së të kësaj banke të ngritej në minimumin rregullativ prej 12 përqind, do të duhej një injektim kapitali ekuivalent me vetëm 0.14 përqind të PBB-së.

Nën këtë skenar, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të arrinte në 10.7 përqind, përderisa në nivel të bankave individuale kjo pjesëmarrje e NPL-ve do të sillej brenda intervalit 4.9 përqind deri në 14.2 përqind. Supozimet e sipërpërmendura të tronditjeve, rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve, zhvlerësimi i euros ndaj dollarit amerikan, si dhe zvogëlimi i normave të interesit do të bënte që gjithsej humbja e sistemit bankar të arrinte vlerën prej 43.9 milionë euro. Megjithatë, jo e tëra kjo vlerë mund të konsiderohet si humbje eventuale me që duhet të merret parasysh fakti se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i pritur për periudhën e konsideruar.

6.5.2 Rreziku i likuiditetit

Metodologjia

Analiza e rrezikut të likuiditetit mbështetet në skenarin e tërheqjes së një vlere më të theksuar të depozitave nga sistemi bankar dhe matë aftësinë e sistemit që të përballojë një tronditje të tillë. Në këtë analizë është konsideruar tërheqja e depozitave përgjatë një periudhe pesë ditore, duke mos marrë parasysh mundësinë e qasjes së bankave në financim nga jashtë. Skenari mbi rrezikun e likuiditetit është bazuar në një supozim mjaft konservativ: tërheqje të depozitave me një normë prej 8 përqind të gjithsej depozitave në baza ditore përgjatë një periudhë pesë ditore. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jolikuide në para të gatshme do të ishte vetëm një përqind e këtyre mjeteve brenda ditës. Gjithashtu është supozuar se bankat kanë qasje të plotë në rezervat e tyre, ndërsa nuk është marrë parasysh mundësia e financimit të bankave përmes burimeve të jashtme të financimit.

Qëndrueshmëria e sistemit bankar në këtë analizë është testuar në kuptim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së asetëve likuide të bankave për të përballuar një tërheqje të tillë të depozitave.

Rezultatet

Në pjesët më të hershme të këtij publikimi është cekur se sistemi bankar i Kosovës konsiderohet të jetë mjaft likuid, gjë që vërtetohet edhe nga niveli mjaft i lartë i indikatorëve të likuiditetit. Asetet themelore (core) likuide dhe ato gjithëpërfshirëse (broad) përbëjnë 24.3 përqind, përkatësisht 29.8 përqind të gjithsej asetëve të sistemit bankar. Andaj, edhe në rast se skenari i lartpërmendur do të shfaqej në praktikë, sistemi bankar tregon një qëndrueshmëri mjaft të lartë kundrejt rrezikut të likuiditetit.

Tabela 11. Përmbledhje e rezultateve të stress-testit: Rreziku i likuiditetit

Përshkrimi	Numri i bankave 1/	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)	Raporti kredi/depozita (në përqindje)
Pas ditës së parë	0	0	84.7
Pas ditës së dytë	1	1,754	97.5
Pas ditës së tretë	1	4,573	105.9
Pas ditës së katërt	4	20,342	115.1
Pas ditës së pestë	4	41,301	125.2

Shënim:1/ Numri i bankave të cilat do të kishin nevojë për mjete likuide shtesë.

Në përgjithësi, rezultat e stres-testit, bazuar në skenarin e tërheqjes së vazhdueshme pesë-ditore të depozitave, sugjerojnë se sistemi bankar i Kosovës paraqitet të ketë nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë edhe në rast se do të paraqiteshin norma më të larta të tërheqjes së depozitave. Nën supozimin hipotetik të tërheqjes së depozitave në mënyrë të vazhdueshme për pesë ditë me radhë me normën e supozuar më lartë, problemet e para të likuiditetit në banka fillojnë të shfaqen pas ditës së dytë, dhe atë vetëm në njërin prej bankave. Niveli i tërheqjes së depozitave nga secila bankë është konsideruar të jetë 8 përqind e gjithsej depozitave të tyre. Pas ditës së dytë, shumica e mjeteve likuide shtesë për


bankën e afektuar do të ishte 1.75 milionë euro (0.038 përqind e PBB-së). Përderisa, raporti kredi/depozita do të arrinte në 97.5 përqind (duke supozuar se niveli i kredive nuk do të vazhdonte të rritej gjatë kësaj periudhe). Pas ditës së katërt, problemet me mjetet likuide do të shfaqeshin edhe në tri banka të tjera, duke e sjellë numrin e bankave të afektuara në katër. Në këtë rast, vlera shtesë e mjeteve likuide të nevojshme për tejkalimin e problemeve me likuiditet do të arrinte vlerën prej 20.3 milionë euro (Tabela x). Pas ciklit pesë-ditor të tërheqjes së depozitave, numri i bankave të cilat shfaqeshin problemet e likuiditetit do të mbetej në katër, përderisa vlera e mjeteve likuide shtesë do të arrinte në 41.3 milionë euro (0.9 përqind e PBB-së). Në këtë fazë, nën supozimin se vlera e kredive nuk ndryshon, raporti kredi/depozita do të arrinte në 125.2 përqind në nivel të sistemit bankar.

7. INSTITUCIONET TJERA FINANCIARE

7.1. Kompanitë e Sigurimit

Sistemi i kompanive të sigurimit vazhdoi të zgjerojë aktivitetin e tij edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Megjithatë, pesha e këtij sistemi në gjithsej sektorin financiar të vendit vazhdon të jetë relativisht e ulët me vetëm 3.1 përqind të gjithsej aseteve të sektorit financiar të menaxhuara nga kompanitë e sigurimit. Deri në qershor 2011, industria e kompanive të sigurimit përbëhej nga gjithsej 11 kompani. Prej tyre, 10 kompani ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet jojetësore, ndërsa vetëm një kompani ishte e licencuar për ofrimin e sigurimit jetësor, ndërsa dy të tjera në proces të aplikimit për licencë për sigurim jetësor. Struktura e pronësisë së kompanive të sigurimit mbetet e ngjashme me vitet paraprake, ku 8 kompani të sigurimit janë me pronësi të huaj, ndërsa tri kompani tjera kanë pronësi vendore. Asetet e kompanive të sigurimit me pronësi të huaj përfaqësojnë 77.5 përqind të gjithsej aseteve të këtij sektori.


Figura 58. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit



Burimi: BQK (2011)

ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet jojetësore,

Figura 59. Struktura e detyrimeve të kompanive të sigurimit



Burimi: BQK (2011)

Gjithsej asetet e sistemit të kompanive të sigurimit në gjysmën e parë të vitit 2011 arritën vlerën prej 103.4 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 14.8 përqind. Kategoria dominuese në kuadër të aseteve të kompanive të sigurimit janë depozitat, me pjesëmarrje prej rreth 50 përqind të gjithsej aseteve (Figura 58). Gjatë kësaj periudhe, depozitat e kompanive të sigurimit arritën vlerën prej 52 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 6.5 përqind. Depozitat e kompanive të sigurimit kryesisht janë të investuara në bankat komerciale që operojnë në Kosovë.


Në anën e detyrimeve, kapitali aksionar dhe rezervat teknike janë kategoritë me peshën më të madhe, me pjesëmarrje prej 40, përkatësisht 49 përqind në gjithsej detyrimet e sistemit të kompanive të sigurimit (Figura 59). Kapitali aksionar gjatë kësaj periudhe shënoi rritje vjetore prej 11.6 përqind, ndërsa rezervat teknike shënuan rritje vjetore prej 16.9 përqind.

Raporti ndërmjet kapitalit dhe aseteve, që shprehë nivelin e kapitalizimit të kompanive të sigurimit, në gjysmën e parë të vitit 2011 ishte 41.1 përqind, që paraqet një nivel të ngjashëm me atë të qershorit të vitit 2010. Ndërsa, raporti ndërmjet kapitalit dhe rezervave teknike, që tregon aftësinë e kompanive të sigurimit për të përballuar humbjet potenciale, në qershor 2011 ishte 81.1 përqind, në krahasim me 84.9 përqind në qershor 2010.¹⁸ Ky raport u zvogëlua kryesisht për shkak të rritjes më të shpejtë të kapitalit në krahasim me rritjen e rezervave teknike.

Fitimi neto i kompanive të sigurimit deri në qershor 2011 ishte 1.2 milionë euro, krahasuar me 0.7 milionë euro sa ishte në qershor të vitit 2010. Përmirësimi i rezultatit financiar u reflektua edhe në përmirësimin e dy treguesve të performancës, si Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets: ROAA) dhe Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity: ROAE). Indikatorin ROAA u ngrit në 1.1 përqind, krahasuar me 0.8 përqind sa ishte në qershor të vitit 2010. Po ashtu, ROAE u ngrit në nivel prej 2.8 përqind, nga 1.9 përqind në qershor të vitit 2010.

Në qershor 2011, numri i policave të shitura nga kompanitë e sigurimit që operojnë në Kosovë arriti në 243.7 mijë, që paraqet një rritje prej 6.1 përqind në krahasim me numrin e policave të shitura në peiudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Vlera e primeve të pranuar gjatë kësaj periudhe arriti në 38.1 milionë euro dhe shënoi rritje vjetore prej 9.3 përqind (Figura 60). Raporti ndërmjet primeve të pranuar dhe gjithsej aseteve të kompanive të sigurimit në qershor 2011 ishte 34 përqind (38.7 përqind në qershor 2010).

Figura 60. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

¹⁸ Rezervat teknike janë të nevojshme për të siguruar përmbushjen e përhershme të detyrimeve të kompanive të sigurimit ndaj të siguruarve deri në skadim të marrëveshjes së sigurimit.

Në kuadër të primeve të pranuar, vetëm rreth 1 përqind janë gjeneruar nga policat e sigurimit jetësor. Veprimtaria e kompanive të sigurimit në Kosovë kryesisht është koncentruar në ofrimin e policave për sigurimin e përgjegjësishë ndaj palës së tretë (*angl. Third Party Liability: TPL*), të cilat njëherit gjenerojnë edhe pjesën më të madhe të primeve të pranuar (61.2 përqind të gjithsej primeve), (Figura 61). Vlera e primeve nga TPL-të arriti në 23.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.2 përqind. Pjesën më të madhe të primeve të policave TPL qytetarët e paguajnë përmes bankave komerciale që operojnë në Kosovë. Një pjesë tjetër e rëndësishme e primeve të pranuar rrjedhë nga shitja e policave vullnetare (31.4 përqind e gjithsej primeve), të cilat gjeneruan prime në vlerë prej 11.9 milionë euro (rritje vjetore prej 18.9 përqind).

Vlera e dëmeve të paguara nga ana e kompanive të sigurimit deri në qershor 2011 shënoi vlerën prej 13.1 milionë euro dhe u zvogëlua për 0.9 përqind. Duke marrë parasysh se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, dëmet e paguara kishin shënuar normë të rritjes prej 65 përqind, mund të thuhet se rritja e vlerës së dëmeve të paguara është ngadalësuar ndjeshëm. Në ngadalësimin e dëmeve të paguara kryesisht ka

kontribuar rënia e pagesave për policat TPL, të cilat gjatë kësaj periudhe shënuan rënie vjetore prej 11.9 përqind (rritje vjetore prej 56.2 përqind në qershor 2010), (Figura 62). Pagesat për mbajtësit e policave TPL përbëjnë pjesën më të madhe të dëmeve të paguara (rreth 68.2 përqind të gjithsej dëmeve të paguara). Pjesa tjetër e dëmeve të paguara prej 28.7 përqind, përbëhet nga pagesat për mbajtësit e policave kufitare, si dhe pagesat për policat vullnetare.

7.2. Fondet pensionale

Asetet e sistemit pensional të Kosovës deri në qershor 2011 arritën vlerën prej 551.5 milionë euro, krahasuar me 412.5 milionë euro sa ishin në qershor të vitit 2010. Pjesa më e madhe e aseteve pensionale përbëhet nga asetet e Trustit të Kursimeve Pensionale të

Figura 61. Struktura e primeve të pranuar të kompanive të sigurimit






Figura 62. Struktura e dëmeve të paguara të kompanive të sigurimit



Kosovës (TKPK), ndërsa një pjesë më e vogël e tyre menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve.

Në gjysmën e parë të vitit 2011, performanca e TKPK-së u përmirësua dukshëm në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 63). Në qershor 2011, çmimi për një aksion të TKPK-së arriti në 1.059 euro, krahasuar me 0.955 në qershor 2010 (çmimi bazë gjatë kontributit

Figura 63. Çmimi i aksionit tëTKPK-së dhe indeksi DJI




Burimi: Trusti (2011), DJI (2011)

llogaritët 1.0 euro për aksion). Për rrjedhojë, ndryshe nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar kur TKPK shënoi kthime negative në investime, në gjysmën e parë të vitit 2011, TKPK realizoi kthim pozitiv në investime në vlerë prej 14.5 milionë euro (9.5 milionë humbje në periudhën janar-qershor 2010). Kthimet pozitive në investimet e TKPK-së mund t'i atribuohen diversifikimit të mjeteve të investuara si dhe përmirësimit të performancës së tregjeve globale. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011, TKPK rriti investimet në instrumente tjera, si bono dhe letra me vlerë, meqë këto instrumente ofronin norma më të larta të kthimit. Po ashtu, duke marrë parasysh se pjesa dërmuese e investimeve të TKPK-së është e fokusuar në tregjet financiare të vendeve e zhvilluara, lëvizjet pozitive në këto tregje u reflektuan ndjeshëm edhe në performancën investimeve të TKPK-së.

Nga gjithsej asetet e TKPK-së, 6.2 përqind janë të investuara në bankat komerciale në Kosovë si dhe 6.2 përqind tjera janë të depozituara në BQK. Pjesa tjetër e aseteve të TKPK-së është e investuar jashtë vendit (kryesisht SH.B.A., Britani e Madhe dhe Japoni). Prej tyre, në qershor 2011 rreth 36 përqind e aseteve ishin të investuara në ekuitete (Figura 64). Ndërsa, një pjesë tjetër e konsiderueshme është investuar në bono (rreth 25.5 përqind) dhe në tregun e parave (rreth 11.6 përqind). Në anën tjetër, Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve, pjesën më të madhe të investimeve i ka të alokuara në depozita bankare dhe obligacione (rreth 95 përqind), kurse pjesa tjetër e investimeve mbahet në formë të parave të gatshme, aksioneve etj.

Figura 64. Struktura e investimeve të trustit



Burimi: BQK (2011)


7.3. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiarë

Aktiviteti i institucioneve mikrofinanciare (IMF) vazhdon të jetë i përqendruar në financimin e bizneseve të vogla dhe ekonomive familjare. Ky sektor zë një pjesë relativisht të vogël në sektorin financiar të Kosovës me një pjesëmarrje prej 4.1 përqind në gjithsej asetet e sektorit financiar. Sektori i institucioneve mikrofinanciare në Kosovë numëronte gjithsej 17 institucione në qershor 2011.

Industria mikrofinanciare në Kosovë vazhdimisht është karakterizuar me një shkallë relativisht të lartë të koncentrimit të tregut. Megjithatë, shkalla e koncentrimit ka shënuar rënie të vazhdueshme dhe kjo rënie ishte më e theksuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Kjo tregohet përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman për asete, i cili sugjeron se shkalla e koncentrimit në qershor 2011 u zvogëluar në 1,479 pikë, krahasuar me 1,924 pikë sa ishte në qershor të vitit 2010 (Figura 65). Rënia e shkallës së koncentrimit në tregun e IMF-ve sugjerohet edhe nga figura 66, ku vërehet zvogëlimi i pjesëmarrjes së aseteve të tri IMF-ve më të mëdha në treg për 9pp. Zvogëlimi i shkallës së koncentrimit në këtë industri, nënkupton rritje të presioneve konkurruese ndërmjet institucioneve mikrofinanciare në Kosovë.


Numri i kredive të lëshuara nga këto institucione, deri në qershor 2011, ka arritur në 63,834 që paraqet një rritje vjetore prej 4 përqind. Ndërsa, vlera e portofolit të kredive të lëshuara nga institucionet mikrofinanciare arriti në 115.2 milionë euro dhe shënoi rritje vjetore prej vetëm 1.2 përqind, që tregon për një zgjerim modest të aktivitetit kredidhënës të IMF-ve gjatë kësaj periudhe (Figura 67). Pjesëmarrja e kredive

Figura 65. HHI për asetet e IMF-ve




Burimi: BQK (2011)

Figura 66. Asetet sipas madhësisë së IMF-ve, në



Burimi: BQK (2011)

Figura 67. Kreditë e lëshura nga IMF-të, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

të lëshuara nga IMF-të në gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori financiar i Kosovës ishte 6.6 përqind në qershor 2011, që paraqet nivel më të ulët krahasuar me atë të periudhës së njëjtë të vitit të kaluar (7.5 përqind). Vlera mesatare e një kredie të lëshuar nga institucionet mikrofinanciare gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 ishte 1,804.7 euro, krahasuar me 1,896.2 euro sa ishte në gjysmën e parë të vitit 2010.

Në gjysmën e parë të vitit 2011, industria e IMF-ve përmirësoi dukshëm performancën e saj. Kjo për arsye se, deri në qershor 2011, IMF-të kaluan në fitim prej 0.8 milionë euro, nga humbja prej 1.1 milionë eurosh që kishin realizuar në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në fillim të vitit 2011, njëra ndër IMF-të më të mëdha që operojnë në vend, gjegjësisht KEP Trust, u kaplua nga disa probleme të qeverisjes së brendshme, të cilat vështirësuan funksionimin normal të këtij institucioni. Megjithatë, BQK-ja në rolin e rregullatorit ishte aktive në zgjidhjen e këtij kontesti, duke vënë këtë institucion nën administrim të përkohshëm dhe duke rikthyer me sukses gjendjen në normalitet, gjë që rezultoi me përfundimin e administrimit të përkohshëm nga BQK-ja (Kutia 6).

Kutia 6. Administrimi i përkohshëm në KEP Trust - rivendosja e qeverisjes

Institucioni mikro-financiar KEP Trust ishte venë nën administrim të përkohshëm nga BQK-ja në janar të vitit 2011 pas vetë-shpërbërjes së qeverisjes dhe dështimit të themeluesve për rivendosjen e këtij funksioni në pajtim me statutin e institucionit. Bordi drejtues dhe menaxhmenti nuk mund të përfaqësoheshin në drejtimin dhe menaxhimin e institucionit pasi që nuk ishin rizgjedhur siç kërkohej me vetë statutin e institucionit.

Sipas termave të angazhimit, nga administratori i përkohshëm, përveç drejtimin të institucionit me të gjitha të drejtat ekzekutive, kërkohej që brenda tre muajve nga emërimi të vazhdojë përpjekjet me themeluesit për rivendosjen e strukturave qeverisëse në institucion. Në pamundësi të realizimit të objektivit kryesor brenda kësaj periudhe, administrimi i përkohshëm u vazhdua disa herë, deri në takimin e organizuar nga BQK-ja me të gjitha palët e interesit në KEP Trust në tetor të 2011. Ky takim rezultoi me marrëveshje mes themeluesve për rizgjedhjen e bordit drejtues, anëtarët e të cilit duhej ti nënshtroheshin testit të përshtatshmërisë nga BQK-ja para se të transferohej e drejta ekzekutive nga administratori te bordi drejtues në nëntor 2011.

Masa e administrimit të përkohshëm u përfundua me 09 nëntor 2011 pas rezultateve pozitive të testit të përshtatshmërisë së anëtarëve të bordit drejtues të nominuar nga themeluesit e këtij institucioni dhe emërimit të drejtorit menaxhues. Rrjedhimisht, e drejta ekzekutive u bartë nga administratori te bordi i ri drejtues.

Procesi i administrimit gjatë kësaj periudhe arriti të ruaj vazhdimësinë e institucionit duke përmbushur obligimet kontraktuale ndaj kreditorëve në shumë prej 12 milion euro, ruajtjen e nivelit të likuiditetit, cilësisë së portofolit kreditor dhe kapitalit.

Ndihmësit financiarë në Kosovë përbëhen nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për këmbimin e parave (ATP). Numri i ndihmësve financiarë që operojnë në Kosovë, në qershor 2011 ishte 32 që paraqet një rritje prej tri institucioneve që nga qershori i vitit 2010. Deri në qershor 2011, përmes ndihmësve financiarë janë transferuar 115.8 milionë euro, apo 7 përqind më shumë transfere se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nga kjo vlerë, 99.8 milionë euro janë transfere hyrëse në Kosovë, ndërsa 16 milionë euro tjera janë transfere dalëse. Shuma e transfereve të dërguara përmes ATP-ve paraqet 4.1 përqind të gjithsej transfereve të realizuara përmes sektorit financiar të Kosovës. Ndërsa, pjesa më e madhe e

transfereve vazhdon të realizohet përmes bankave komerciale (80.5 përqind të gjithsej transfereve deri në qershor 2011).

Tema Specifike*

* Pikëpamjet e shprehura në temat specifike janë të autorit ose autorëve dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimin zyrtar të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Temat specifike paraqesin hulumtim në progres nga autori ose autorët dhe janë publikuar për të hapur diskutime dhe komente.

8. Anketa mbi Kreditimin Bankar për Kosovën

Astrit PANXHA* dhe Arben MUSTAFA†

8.1. Hyrje

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve për një vlerësim sa më të mirë të zhvillimeve kreditore në Kosovë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka filluar të zhvillojë Anketën mbi Kreditimin Bankar, e cila pritet që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth zhvillimeve të standardeve kreditore, rregullave dhe kushteve kreditore, perceptimin e rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua. Duke marrë parasysh zhvillimet kreditore për ekonominë, një analizë më e hollësishme mbi sjelljen e kreditimit bankar do ndihmojë të kuptuarit e faktorëve që ndikojnë në gatishmërinë e bankave për të dhënë hua dhe, në këtë mënyrë, do të rrisë kapacitetet për parashikimin e vëllimeve kreditore dhe rritjen PBB-së. Anketa e Kreditimit Bankar për Kosovën mbështetet në metodologjinë e zhvilluar nga Banka Qendrore Evropiane për të vlerësuar sjelljen e bankave që operojnë në eurozonë për sa i përket aktivitetit kredidhënës.

Njëra nga karakteristikat më të rëndësishme të sjelljes së kreditimit bankar ndërlidhet me standardet kreditore, të cilat pasqyrojnë kriteret e bankës për aprovim e kredive. Shtrëngimi i standardeve kreditore është gjetur të ketë ndikim negativ në rritjen kreditore, ndërsa standardet më të lehtësuara kreditore shpijnë në rritje më të madhe të kredive të lëshuara nga bankat (Lown et al., 2000). Standardet kreditore dhe rritja kreditore paraqiten të jenë faktorë të rëndësishëm për aktivitetin ekonomik, në bazë të studimeve që sugjerojnë se ato paraqesin përcaktues të rëndësishëm të cikleve biznesore. Sipas Asea and Blomberg (1998), bankat janë të prira drejtë aplikimit të standardeve më të lehtësuara kreditore gjatë fazave të ekspansionit ekonomik, duke shkaktuar në këtë mënyrë një rritje më të madhe të kredive dhe një aktivitet më intensiv ekonomik. Po ashtu, në një anketë për 11 vende të eurozonës për periudhën 1999 – 2008, Capiello et al. (2010) kanë gjetur se standardet kreditore kanë pasur ndikim të konsiderueshëm negativ në rritjen reale të PBB-së. Capiello et al. (2010) gjithashtu kanë kontrolluar veçmas për ndikimin e rritjes kreditore në rritjen reale të PBB-së dhe kanë gjetur një ndikim të konsiderueshëm pozitiv. Rëndësia e rritjes së kredive, si përcaktuese i cikleve biznesore, po ashtu njihet nga studimet tjera siç janë Erckstein and Sinai (1986) si dhe Wojnilower (1985), të cilët kanë gjetur se shtrëngimet kreditore kanë paraqitur përcaktues të rëndësishëm të shumicës së recesioneve në Shtetet e Bashkuara.

Lidhshmëria ndërmjet rritjes së kredive dhe rritjes së PBB-së ishte e dukshme edhe në Kosovë. Ky raport ishte sidomos i dukshëm në vitet 2009 dhe 2010. Evoluimi i krizës globale që kishte filluar në vitin 2007/2008 është reflektuar deri në një masë edhe në Kosovë, ku si rritja kreditore ashtu edhe rritja e PBB-së shënuan ngadalësim gjatë vitit 2009, përderisa norma e rritjes mbeti pozitive. Ndërkaq, viti 2010, i cili konsiderohet si viti kur filloi të rikuperohet ekonomia globale, në Kosovë është karakterizuar si me ngritje të normës së rritjes së kredive ashtu edhe me normë më të lartë të rritjes së PBB-së. Edhe pse nuk është zhvilluar ndonjë studim empirik deri me tani lidhur me këtë çështje, trendët e

* Astrit Panxha është Ekonomist i Lartë në Departamentin e Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike në BQK.

† Arben Mustafa është Drejtor i Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike në BQK.

rritjes së kredive dhe të PBB-së real sugjerojnë për një lidhje pozitive ndërmjet tyre. Duke marrë parasysh mungesën e tregut të kapitalit, mundësitë e firmave në Kosovë për të ngritur fondet më së shumt varen nga qasja në kreditë e lëshuara nga sistemi bankar. Prandaj, lidhja ndërmjet rritjes kreditore dhe aktivitetit ekonomik në Kosovë mund të jetë madje edhe më e fuqishme se sa në vendet më të zhvilluara. Në këtë mënyrë, analizimi i sjelljes së kreditimit bankar në Kosovë është i një rëndësie shumë të madhe për një parashikim më të mirë të cikleve biznese në vend. Përveç kësaj, zbërthimi i faktorëve që ndikojnë sjelljen e kreditimit bankar paraqet një mjet të mirë për identifikimin sa më të mirë të faktorëve specifik që ndikojnë në ndryshimet e gatishmërisë së bankave për të dhënë hua, në normat e interesit, në rregullat dhe kushtet tjera si dhe në faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi.

Të dhënat e përfituara nga kjo anketë do të mund të shërbejnë si informacione plotësuese për statistikën rreth aktivitetit të sistemit bankar, duke mundësuar kështu një analizë më të plotë të zhvillimeve në këtë sektor. Për më tepër, përgjigjet e dhëna nga bankat rreth zhvillimeve në kërkesën e klientëve për kredi si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimin e kërkesës, mundësojnë një vëzhgim më të mirë të zhvillimeve edhe në sektorin real të ekonomisë. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme kur kemi parasysh faktin që ekzistojnë kufizime të mëdha për sa i përket të dhënave mbi performancën e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve. Me qëllim të rritjes së transparencës publike, rezultatet e përgjithshme të anketës do të jenë në dispozicion edhe të publikut dhe do të publikohen nga BQK-ja në baza tremujore. Duke parasysh parasysh që kjo është faza fillestare e implementimit të kësaj ankete, rezultatet mund edhe mos të reflektojnë me shumë saktësi situatën reale, andaj edhe interpretimi i tyre duhet bërë me kujdes të shtuar.

Pjesa e mbetur e këtij dokumenti është organizuar si në vijim: seksioni 2 përshkruan metodologjinë e anketës, seksioni 3 paraqet rezultatet e anketës, dhe seksioni 4 paraqet përmbledhjen e këtij artikulli.

8.2. Metodologjia

Forma e anketës për sistemin bankar në Kosovë është bazuar në anketën e bërë nga ECB, ndërsa janë bërë edhe disa modifikime për të bërë sa më të përshtatshme për rrethanat aktuale të sistemit bankar të Kosovës.²¹ Pjesa kryesore e anketës përbëhet nga pyetësi, i cili është përpiluar në atë mënyrë që të mbulojë ndryshimet në standardet kreditore, rregullat dhe kushtet për kreditë si dhe kërkesën për kredi. Pyetësi përbëhet nga 18 pyetje, të cilat janë të formuluar për të reflektuar zhvillimet në tregun për kredi për dy sektorët e ekonomisë, gjegjësisht ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Për më tepër, dhjetë pyetje kanë të bëjnë me faktorët e ofertës (shtatë lidhur me standardet kreditore dhe tri lidhur me rregullat dhe kushtet e kredive të reja), dhe shtatë pyetje kanë të bëjnë me faktorët e kërkesës. Anketa do të bëhet çdo tre muaj dhe pyetjet janë të formuluar në mënyrë specifike për të shpjeguar zhvillimin gjatë tre muajve të kaluar dhe pritjet e bankave lidhur me zhvillimet në tregun kreditor gjatë tre muajve të ardhshëm.

Pyetjet janë formuluar duke përdorur shkallët për të reflektuar ndryshimet në standardet kreditore, rregullat dhe kushtet e kredive si dhe kërkesën për kredi. Janë shfrytëzuar dy shkallë: 'e lehtësuar në masë të konsiderueshme' dhe 'e lehtësuar deri në një masë' të cilat nënkuptojnë se bankat kanë lehtësuar standardet kreditore si dhe rregullat dhe kushtet e

²¹ Anketa mbi Kreditimin Bankar për Eurozonën "Occasional paper series no.23", February 2005, ECB.

kredive. Në mënyrë të ngjashme, janë përfshirë edhe dy shkallët tjera: 'e shtrënguar në masë të konsiderueshme' dhe 'e shtrënguar deri në një masë', të cilat nënkuptojnë se bankat kanë shtrënguar standardet kreditore dhe rregullat dhe kushtet e kredive.²² Po ashtu, ekzistojnë edhe opsionet 'kryesisht kanë mbetur jo të ndryshuara' dhe 'jo e aplikuar - NA', ku e para paraqet opsionin neutral, ndërsa e dyta nënkupton se bankat nuk dijnë se cili ka qenë ndikimi në standardet kreditore, rregullat dhe kushtet për kredi, etj.

Grup mostra për anketën mbi kreditimin bankar përbëhet nga shtatë banka²³ që operojnë në Kosovë. Për shkak të natyrës kualitative të anketës, peshimi i rezultateve nuk është aplikuar. Mostra gjithashtu është reprezentative në mënyrë adekuate dhe siguron një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se bankat të cilat janë përgjigjur në anketë përfaqësojnë rreth 97 përqind të aktivitetit të përgjithshëm kreditor. Rezultatet në këtë anketë janë të përgjithësuara dhe janë të prezantuara në atë formë që mbron konfidencialitetin e bankave individuale të cilat janë përgjigjur në anketë.

Anketa e parë ishte kryer në bazë të zhvillimeve për tremujorin e dytë të vitit 2011 dhe në këtë anketë i referohemi si anketa e korrikut 2011 (e cila i referohet periudhës prej marsit deri në qershor të vitit 2011), ndërsa anketa e dytë është kryer për tremujorin e tretë, dhe i referohemi si anketa e tetorit 2011 (e cila i referohet periudhës prej korrikut deri në shtator 2011).

8.3. Pasqyra e rezultateve

8.3.1. Ndërmarrjet

Standardet kreditore²⁴: Rezultatet e raportuara në anketën e tetorit tregojnë për një lehtësim të përgjithshëm neto të standardeve kreditore të zbatuara për aprovimin e kredive apo linjave kreditore për ndërmarrjet gjatë tre muajve të kaluar. Në anketën e tetorit, 29 përqind e të gjitha bankave që janë përgjigjur kanë raportuar për një lehtësim neto²⁵ të standardeve kredituese për ndërmarrjet. Lehtësimi i përgjithshëm neto është më i lartë krahasuar me anketën e korrikut, kur të gjitha bankat raportuan për standarde kryesisht të pandryshuara për kreditë e ndërmarrjeve (Tabela 1).

Rezultatet ndryshojnë në mënyrë substanciale kur shikohen ndryshimet e standardeve kreditore sipas madhësisë së ndërmarrjeve. Lehtësim neto i konsiderueshëm i standardeve kreditore është raportuar për kreditë dhe linjat kreditore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Në anketën e tetorit, lehtësimi neto i standardeve kreditore të bankave për NVM-të ishte 29 përqind, që është dukshëm më i lartë krahasuar me anketën e mëparshme, ku 14 përqind e bankave raportuan për shtrëngim neto të standardeve kreditore. Sa i përket ndërmarrjeve të mëdha, të gjitha bankat në anketë kanë raportuar se standardet kreditore kanë mbetur kryesisht të pandryshuara. Megjithatë, rezultati është mjaft i ndryshëm krahasuar me anketën e korrikut, kur 14 përqind e bankave raportuan për shtrëngim neto të standardeve kreditore. Për sa i përket periudhës së maturimit të

²² Në pyetjet lidhur me kërkesën, opsionet 'të lehtësuara' dhe 'të shtrënguara' janë zëvendësuar me 'të rritura' dhe 'të zvogëluara'

²³ Në Kosovë operojnë 8 banka, prej të cilave 7 banka janë përgjigjur në anketë, ndërsa 1 bankë që nuk është përgjigjur në anketë paraqet vetëm një pjesë të vogël të aktivitetit të përgjithshëm kreditor në vend.

²⁴ Standardet kreditore paraqesin kriteret e brendshme të bankave, të cilat e reflektojnë politikën kreditore të bankës. Këto kriteret mund të jenë të shkruara ose të pashkruara dhe definojnë llojet e kredive të cilat konsiderohen nga bankat si të dëshirueshme ose jo të dëshirueshme për tu kredituar. ²⁵Përqindja pozitive neto tregon se një pjesë e madhe e bankave i kanë shtrënguar standardet kreditore ("shtrëngim neto"), ndërsa përqindja negative neto tregon se një pjesë më e madhe e bankave i kanë lehtësuar standardet kreditore ("lehtësim neto").

kredive, bankat raportuan se standardet kreditore si për kreditë afatshkurtra ashtu edhe për ato afatgjate kanë mbetur kryesisht të pandryshuara.

Tabela 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për kreditë apo linjat kreditore për ndërmarrjet gjatë tre muajve të kaluar (në %)


	Në përgjithësi		Kreditë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme		Kreditë për ndërmarrjet e mëdha		Kreditë afatshkurtra		Kreditë afatgjata	
	Qershor 2011	Shtator 2011	Qershor 2011	Shtator 2011	Qershor 2011	Shtator 2011	Qershor 2011	Shtator 2011	Qershor 2011	Shtator 2011
Janë shtrënguar në masë të konsiderueshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Janë shtrënguar deri në një masë	0	0	14	0	14	14	0	0	0	0
Kryesisht kanë mbetur të pandryshuara	100	71	86	71	86	71	100	100	100	100
Janë lehtësuar deri në një masë	0	29	0	14	0	14	0	0	0	0
Janë lehtësuar në masë të konsiderueshme	0	0	0	14	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Përqindja neto	0	-29	14	-29	14	0	0	0	0	0
Numri i bankave që janë përgjigjur	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7

Burimi: BQK, 2011:

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshimi ndërmjet shumës së përqindjes për “të shtrënguara në masë të konsiderueshme” dhe “të shtrënguara deri në një masë” dhe shumës së përqindjes për “të lehtësuara deri në një masë” dhe “të lehtësuara në masë të konsiderueshme”.

Lehtësimi neto i standardeve kryesisht ishte përcaktuar nga ana faktorëve të ofertës së kreditimit të të transmetuar nëpërmjet bilancit të gjendjes së bankave. Faktorët si kostoja e bankave lidhur me pozitën e kapitalit dhe mundësia për të pasur qasje në financim nga tregu janë raportuar të kenë kontribuar në lehtësim neto të standardeve kreditore (Figura 1). Lehtësimi neto i këtyre dy faktorëve mbeti i njëjtë në 14 përqind, krahasuar me tremujorin e dytë të 2011. Po ashtu, pozita e likuiditetit të bankave ka kontribuar në lehtësimin neto të standardeve kreditore me 29 përqind, që është më i lartë krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2011, kur qëndronte kryesisht i pandryshuar. Përveç kësaj, presioni nga konkurrenca nga bankat tjera, në tremujorin e tretë të vitit 2011 kontribuoi në lehtësimin e standardeve kreditore, me një lehtësim neto prej 29 përqind që paraqet normë të ngjashme me atë të tremujorit të dytë të vitit 2011.

Figura 1. Ndikimi i faktorëve në standardet kreditore të aplikuara për aprovimin e kredive apo linjave kreditore për ndërmarrjet gjatë tre muajve të kaluar (në %)



Burimi: BQK (2011)

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshimi ndërmjet shumës së përqindjes për “shtrënguara në masë të konsiderueshme” dhe “shtrënguara deri në një masë” dhe shumës së përqindjes për “lehtësuara deri në një masë” dhe “lehtësuara në masë të konsiderueshme”.


Ndërsa, perceptimet rreth rreziqeve që ndërlidhen me ambientin e përgjithshëm ekonomik ndikuan në shtrëngimin e standardeve kreditore. Në tremujorin e tretë të vitit 2011, pritjet lidhur me aktivitetin e përgjithshëm ekonomik dhe rrezikun mbi kërkesën e kolateralit kanë shkaktuar shtrëngim neto të standardit kreditor për 29 përqind. Ngjashëm, edhe rreziqet specifike të industrisë apo firmës kanë ndikuar në shtrëngimin e standardeve kreditore. Shtrëngimi neto i kësaj kategorie u ngrit në 43 përqind, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2011, kur qëndronte në 29 përqind.

Sa i përket pritjeve për tre muajt e ardhshëm, të gjitha bankat raportuan se në përgjithësi nuk presin të aplikojnë ndryshime të standardeve për kredi apo linjave kreditore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Mirëpo, bankat kanë raportuar se do të ketë shtrëngim neto prej 14 përqind për standardet apo linjat kreditore për ndërmarrjet e mëdha.

Rregullat dhe kushtet²⁶: Rezultatet e anketës së tetorit lidhur me ndryshimet në rregullat dhe kushtet e përgjithshme për kredi apo linja kreditore për ndërmarrjet gjatë tre muajve të kaluar tregojnë se bankat kryesisht i kanë lehtësuar rregullat dhe kushtet e tyre krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Në tremujorin e tretë të vitit 2011, përqindja neto e bankave që raportuan për ngushtim të marginës së normës së interesit për kreditë mesatare për ndërmarrjet qëndroi në 43 përqind, që paraqet një nivel të njëjtë sikurse në tremujorin e dytë të vitit 2011 (Figura 2). Gjithashtu, edhe lehtësimi neto i ngarkesave tjera përveç normave të interesit u raportua nga 29 përqind e bankave, gjë që është më e lartë krahasuar me tremujorin e dytë kur qëndroi në 14 përqind. Megjithatë, sa i përket madhësisë së kredive dhe periudhës së maturimit të kredive për ndërmarrjet, bankat kanë raportuar për një shtrëngim neto prej 14 përqind.

Figura 2. Ndryshimi i kushteve dhe rregullave për aprovimin për kreditë dhe linjat kreditore për ndërmarrjet gjatë tre muajve të kaluar (në %)



Burimi: BQK (2011)

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshimi ndërmjet shumës së përqindjes për "shtrënguara në masë të konsiderueshme" dhe "shtrënguara deri në një masë" dhe shumës së përqindjes për "lehtësuara deri në një masë" dhe "lehtësuara në masë të konsiderueshme"

²⁶ Rregullat dhe kushtet i referohen obligimeve specifike për të cilat kanë arritur pajtim kredihënësi dhe kredimarrësi. Në këtë anketë, rregullat dhe kushtet kanë të bëjnë me normat e interesit, madhësinë e kredisë, ngarkesat tjera përveç normave të interesit, afati i maturimit të kredisë, kërkesat për kolateral, etj.

Kërkesa për kredi: Në anketën e tetorit, bankat raportuan për zvogëlim në masë të konsiderueshme të kërkesës për kredi apo linja kreditore nga ndërmarrjet në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2011. Rënia e kërkesës për kredi ishte më e theksuar për ndërmarrjet e mëdha, ku në baza neto, 43 përqind e bankave raportuan për zvogëlim të kërkesës, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2011, kur u raportua për rritje neto²⁷ nga 29 përqind e bankave. (Tabela 2). Në mënyrë të ngjashme, kërkesa për kredi apo linja kreditore për NVM ka pësuar zvogëlim neto, ndonëse me ritëm me të ngadalshëm krahasuar me ndërmarrjet e mëdha. Në anketën e tetorit, në baza neto, 29 përqind e bankave raportuan për zvogëlim të kërkesës së NVM-ve për kredi apo linja kreditore krahasuar me rritjen neto prej 57 përqind në tremujorin e dytë. Për sa i përket kërkesës për kredi në bazë të periudhës origjinale të maturimit, si për kreditë afatshkurtra edhe për ato afatgjata, bankat raportuan se kërkesa mbeti kryesisht e pandryshuar.

Tabela 2. Ndryshimet në kërkesën për kredi apo linja kreditore për ndërmarrjet gjatë tre muajve të kaluar (në %)

	Në përgjithësi		Kreditë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme		Kreditë për ndërmarrjet e mëdha		Kreditë afatshkurtra		Kreditë afatgjata	
	Qershor 2011	Shtator 2011	Qershor 2011	Shtator 2011	Qershor 2011	Shtator 2011	Qershor 2011	Shtator 2011	Qershor 2011	Shtator 2011
Është zvogëluar në masë të konsiderueshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Është zvogëluar deri në një masë	14	57	0	57	29	57	0	29	29	29
Kryesisht ka mbetur e pandryshuar	14	14	43	14	14	29	43	43	29	43
Është rritur deri në një masë	71	29	57	29	57	14	57	29	43	29
Është rritur në masë të konsiderueshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Përqindja neto	57	-29	57	-29	29	-43	57	0	14	0
Numri i bankave që janë përgjigjur	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7

Burimi: BQK, 2011.


Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshim ndërmjet shumës së përqindjes për "është rritur në masë të konsiderueshme" dhe "është rritur deri në një masë" dhe shumës së përqindjes për "është zvogëluar deri në një masë" dhe "është zvogëluar në masë të konsiderueshme".

Në rezultatet e anketës së tetorit, 57 përqind e bankave raportuan se konkurrenca nuk kishte ndikim në ndryshimin e kërkesës për kredi, ndërsa 43 përqind e bankave raportuan se konkurrenca ndikoi në zvogëlimin e kërkesës për kredi apo linja kreditore për ndërmarrjet. Kjo tregon se, në baza neto, 43 përqind e bankave kanë raportuar për ndikim negativ të konkurrencës në kërkesën për kredi apo linja kreditore për ndërmarrjet (Figura 3). Ndërsa, ndikim në rritjen neto të kërkesës kishte ristrukturimi i borxhit për ndërmarrjet që kontribuoi me 14 përqind, që nënkupton se një pjesë e ndërmarrjeve kanë rritur kërkesën për kredi të reja me qëllim të ristrukturimit të kredive ekzistuese.

Në analizën e tetorit, bankat janë shfaqur mjaft optimiste për sa i përket rritjes së kërkesës për kredi apo linja kreditore për ndërmarrjet gjatë tre muajve të ardhshëm. Përqindja neto e bankave që kanë raportuar se presin rritje të kërkesës së kredis për ndërmarrjet në përgjithësi ishte 71 (Në anketën e qershorit ishte 29 përqind). Shikuar për nga madhësia e ndërmarrjeve, në tre muajt e ardhshëm, bankat presin të ketë rritje më të theksuar të kërkesës për kredi nga NVM-të (71 përqind e bankave në baza neto). Për sa i përket kërkesës për kredi nga ndërmarrjet e mëdha, në baza neto, 43 përqind e bankave kanë raportuar se presin rritje të kërkesës, që paraqet ritëm më të ngadalshëm të rritjes së kërkesës për kredi nga ndërmarrjet e mëdha në krahasim me NVM-të.

²⁷ Përqindja pozitive neto tregon se bankat kanë raportuar rritje të kërkesës (rritje neto), ndërsa përqindja negative neto tregon se bankat kanë raportuar për zvogëlim të kërkesës (zvogëlim neto).

Figura 3. Ndikmi i faktorëve në ndryshimin e kërkesës për kredi apo linja kreditore për ndërmarrjet gjatë tre muajve të kaluar (në %)



Burimi: BQK (2011)

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshimi ndërmjet shumës së përqindjes për “është rritur në masë të konsiderueshme” dhe “është rritur deri në një masë” dhe shumës së përqindjes për “është zvogëluar deri në një masë” dhe “është zvogëluar në masë të konsiderueshme”

Gjithashtu, bankat gjatë tre muajve të ardhshëm presin ndërmarrjet të rrisin kërkesën për kreditë me maturitet të gjatë (57 përqind e bankave në baza neto), si dhe për kreditë me maturitet të shkurtër (43 përqind e bankave në baza neto).

8.3.2 Ekonomitë familjare

8.3.2.1 Kreditë për ekonomitë familjare për blerjen e shtëpive

Standardet kreditore: Në anketën e tetorit, bankat në Kosovë kanë raportuar se gjatë tre muajve të kaluar ka pasur lehtësim neto të standardeve kreditore për kreditë e ekonomive familjare që janë të destinuara për blerjen e shtëpive. Në përgjithësi, 14 përqind e bankave (në baza neto) kanë raportuar lehtësim²⁸ të standardeve kreditore për këto kredi, në krahasim me 29 përqind sa është raportuar në anketën e korrikut (Tabela 3). Në anketën e tetorit, pjesa më e madhe e bankave (86 përqind) kanë raportuar se standardet kreditore për kreditë për blerjen e shtëpive kanë mbetur kryesisht të pandryshuara (71 përqind në qershor të vitit 2011).

Faktori që është cekur më së shumti nga bankat që ka kontribuar në lehtësimin neto të standardeve kreditore për kreditë e ekonomive familjare për blerjen e shtëpive ishte presioni nga konkurrenca (Figura 4). Në anën tjetër, pritjet përkitazi me aktivitetin e përgjithshëm ekonomik janë raportuar të kenë kontribuar në shtrëngimin neto të standardeve kreditore. Rezultatet tregojnë se 14 përqind e bankave (në baza neto) kanë raportuar për shtrëngim të standardeve kreditore për shkak të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik (në anketën e qershorit ky tregues për të gjitha bankat që janë përgjigjur ishte kryesisht neutral).

²⁸ Përqindja pozitive neto tregon se një pjesë e madhe e bankave i kanë shtrënguar standardet kreditore (“shtrëngim neto”), ndërsa përqindja negative neto tregon se një pjesë më e madhe e bankave i kanë lehtësuar standardet kreditore (“lehtësim neto”).

Tabela 3. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për aprovimin e kredive për ekonomitë familjare për blerjen e shtëpive gjatë tre muajve të kaluar (në %)


	Kreditë për blerjen e shtëpive	
	Qershor 2011	Shtator 2011
Janë shtrënguar në masë të konsiderueshme	0	0
Janë shtrënguar deri në një masë	0	0
Kryesisht kanë mbetur të pandryshuara	71	86
Janë lehtësuar deri në një masë	29	14
Janë lehtësuar në masë të konsiderueshme	0	0
Gjithsej	100	100
Përqindja neto	-29	-14
Numri i bankave që janë përgjigjur	7	7

Burimi: BQK, 2011.

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshim ndërmjet shumës së përqindjes për “të shtrënguar në masë të konsiderueshme” dhe “të shtrënguar deri në një masë” dhe shumës së përqindjes për “të lehtësuara deri në një masë” dhe “të lehtësuara në masë të konsiderueshme”.

Perceptimet e bankave rreth perspektivës së tregut të shtëpive, në anketën e tetorit, paraqiten të mos kenë pasur ndikim në standardet kreditore të bankave për lëshimin e kredive për blerjen e shtëpive, përderisa në anketën e korrikut 14 përqind e bankave (në baza neto) kishin raportuar se ky faktor ka ndikuar në lehtësimin e standardeve kreditore për këto kredi. Kostoja e fondeve dhe kufizimet në bilancin e gjendjes janë raportuar të kenë pasur kryesisht ndikim neutral në standardet kreditore për blerjen e kredive.

Figura 4. Ndikimi i faktorëve në standardet kreditore të aplikuara për aprovimin kredive për ekonomitë familjare për blerjen e shtëpive gjatë tre muajve të kaluar (në %)



Burimi: BQK (2011)


Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshimi ndërmjet shumës së përqindjes për “shtrënguar në masë të konsiderueshme” dhe “shtrënguar deri në një masë” dhe shumës së përqindjes për “lehtësuara deri në një masë” dhe “lehtësuara në masë të konsiderueshme”.

Sa i përket pritjeve rreth zhvillimeve në tre muajt e ardhshëm, të gjithat bankat që janë përgjigjur në anketë presin që standardet kreditore për kreditë për blerjen e shtëpive do të mbesin kryesisht të pandryshuara.

Rregullat dhe kushtet kreditore: Në anketën e tetorit, rezultatet tregojnë se gjatë tre muajve të kaluar bankat zvogëluan margjinën e interesit për kreditë mesatare të

ekonomive familjare të destinuar për blerjen e shtëpive (Figura 5). Po ashtu, lehtësim neto prej 14 përqind u raportua edhe për sa i përket ngarkesave tjera përveç normës së interesit. Ndërsa, për periudhën raportuese, ndryshimi më i theksuar në rregullat dhe kushtet e kreditimit u aplikua në lidhje me kërkesën për kolateral. Përqindja e bankave (në baza neto) që raportoi lehtësim të kërkesave për kolateral te kreditë e ekonomive familjare për blerje të shtëpive u rrit në 29 përqind në tremujorin e tretë, nga 14 përqind sa ishte në tremujorin e dytë të vitit 2011. Sidoqoftë, në disa aspekte, bankat shtrënguan rregullat dhe kushtet për kreditë e ekonomive familjare për blerje të shtëpive. Këto ndryshime u fokusuan në zvogëlimin e raportit ndërmjet vlerës së kredisë dhe çmimit të blerjes së shtëpise si dhe në shkurtimin e maturitetit për këtë kategori të kredive.

Figura 5. Ndryshimi i kushteve dhe rregullave të aplikuara për ekonomitë familjare për blerjen e shtëpive gjatë tre muajve të kaluar (në %)



Burimi: BQK (2011)

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshimi ndërmjet shumës së përqindjes për "shtrënguar në masë të konsiderueshme" dhe "shtrënguar deri në një masë" dhe shumës së përqindjes për "lehtësuara deri në një masë" dhe "lehtësuara në masë të konsiderueshme"

Kërkesa për kredi: Në anketën e tetorit, bankat kryesisht raportuan për rritje të kërkesës për kreditë e ekonomive familjare për blerje të shtëpive, por me ritëm më të ngadalshëm krahasuar me tremujorin e dytë. Në tremujorin e tretë, në baza neto²⁹, 14 përqind e bankave raportuan se kërkesa për kredi për blerje të shtëpive ka shënuar rritje, krahasuar me 43 përqind sa u raportua në anketën e korrikut (Tabela 4).

Rezultatet nga anketa e tetorit, sugjerojnë se pritjet për perspektivën e tregjeve të shtëpive kishin ndikim pozitiv në rritjen e kërkesës për kreditë e ekonomive familjare për blerjen e shtëpive (Figura 6). Gjithashtu, në baza neto, 29 përqind e bankave raportuan se kursimet e ekonomive familjare ndikuan në rritjen e kërkesës për kreditë e ekonomive familjare për blerjen e shtëpive gjatë tremujorit të tretë 2011. Në rezultatet e anketës së tetorit, 57 përqind e bankave raportuan se konkurrenca nuk kishte ndikim në ndryshimin e kërkesës për kredi, ndërsa 43 përqind e bankave raportuan se konkurrenca ndikoi në zvogëlimin e kërkesës për kredi për ekonomitë familjare për blerje të shtëpis.

²⁹ Përqindja pozitive neto tregon se bankat kanë raportuar rritje të kërkesës (rritje neto), ndërsa përqindja negative neto tregon se bankat kanë raportuar për zvogëlim të kërkesës (zvogëlim neto).

Tabela 4. Ndryshimet në kërkesën për kredi për ekonomitë familjare për blerje të shtëpisë gjatë tre muajve të kaluar (në %)

	Kreditë për blerjen e shtëpive	
	Qershor 2011	Shtator 2011
Është zvogëluar në masë të konsiderueshme	0	0
Është zvogëluar deri në një masë	0	14
Kryesisht ka mbetur e pandryshuar	57	57
Është rritur deri në një masë	43	29
Është rritur në masë të konsiderueshme	0	0
Gjithsej	100	100
Përqindja neto	43	14
Numri i bankave që janë përgjigjur	7	7


Burimi: BQK, 2011

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshim ndërmjet shumës së përqindjes për “është rritur në masë të konsiderueshme” dhe “është rritur deri në një masë” dhe shumës së përqindjes për “është zvogëluar deri në një masë” dhe “është zvogëluar në masë të konsiderueshme”.

Kjo tregon se, në baza neto, 43 përqind e bankave kanë raportuar për ndikim negativ të konkurrencës në kërkesën për kredi për ekonomitë familjare për blerje të shtëpisë.

Sa i përket shpenzimeve konsumuese jo të ndërlidhura me tregun e shtëpive, sigurisë së konsumatorit dhe burimeve tjera të financimit, bankat kryesisht raportuan se ndikimi i tyre në kërkesën për kredi ishte kryesisht i pandryshuar.

Figura 6. Ndikmi i faktorëve në ndryshimin e kërkesës për kredi të ekonomive familjare për blerjen e shtëpive gjatë tre muajve të fundit (në %)



Burimi: BQK (2011)

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshimi ndërmjet shumës së përqindjes për “është rritur në masë të konsiderueshme” dhe “është rritur deri në një masë” dhe shumës së përqindjes për “është zvogëluar deri në një masë” dhe “është zvogëluar në masë të konsiderueshme”.

Në anketën e tetorit, pjesa më e madhe e bankave të anketuara raportuan se kërkesa për kreditë e ekonomive familjare për blerjen e shtëpive gjatë tre muajve të ardhshëm pritet të mbetet kryesisht e pandryshuar.

8.3.2.2 Kreditë konsumuese dhe huazimet tjera

Standardet kreditore: Rezultatet e anketës së tetorit tregojnë se, gjatë tre muajve të kaluar, shumica e bankave kanë lehtësuar standardet e tyre kreditore të aplikuara për aprovimin e kredive konsumuese dhe huazimeve tjera për ekonomitë familjare (Tabela 5). Rezultatet e anketës tregojnë një përqindja neto të bankave që kanë raportuar për lehtësim të standardeve kreditore për këto kredi prej 43 përqind.³⁰ Ky nivel është i njëjtë sikurse në tremujorin paraprak. Nga anketa mund të vërehet se lehtësimi neto i standardeve kreditore është më i theksuar për kreditë konsumuese dhe huazimet tjera krahasuar me atë për kreditë për blerjen e shtëpive.


Tabela 5. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për aprovimin e kredive konsumuese dhe huazimeve tjera për ekonomitë familjare gjatë tre muajve të kaluar (në %)

	Kreditë konsumuese dhe huazime tjera	
	Qershor 2011	Shtator 2011
Janë shtrënguar në masë të konsiderueshme	0	0
Janë shtrënguar deri në një masë	0	0
Kryesisht kanë mbetur të pandryshuara	57	57
Janë lehtësuar deri në një masë	43	43
Janë lehtësuar në masë të konsiderueshme	0	0
Gjithsej	100	100
Përqindja neto	-43	-43
Numri i bankave që janë përgjigjur	7	7

Burimi: BQK, 2011.

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshim ndërmjet shumës së përqindjes për “të shtrënguar në masë të konsiderueshme” dhe “të shtrënguar deri në një masë” dhe shumës së përqindjes për “të lehtësuara deri në një masë” dhe “të lehtësuara në masë të konsiderueshme”.

Figura 7. Ndikimi i faktorëve në standardet kreditore të aplikuara për aprovimin kredive konsumuese dhe huazimeve tjera për ekonomitë familjare gjatë tre muajve të kaluar (në %)



Burimi: BQK (2011)

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshimi ndërmjet shumës së përqindjes për “shtrënguar në masë të konsiderueshme” dhe “shtrënguar deri në një masë” dhe shumës së përqindjes për “lehtësuara deri në një masë” dhe “lehtësuara në masë të konsiderueshme”.

³⁰ Përqindja pozitive neto tregon se pjesë e madhe e bankave i kanë shtrënguar standardet kreditore (“shtrëngim neto”), ndërsa përqindja negative neto tregon se një pjesë më e madhe e bankave i kanë lehtësuar standardet kreditore (“lehtësim neto”).


Lehtësimiti neto i standardeve kreditore për kreditë konsumuese dhe huazimet tjera për ekonomitë familjare është shkaktuar kryesisht nga konkurrenca në sistemin bankar. Në anketën e tetorit, përqindja neto e bankave që kanë raportuar për lehtësim të standardeve kreditore si rezultat i presionit nga konkurrenca ishte 14 përqind (Figura 7). Në anën tjetër, aftësia paguese e konsumatorëve dhe rreziku mbi kërkesat e kolateralit janë raportuar të kenë kontribuar në shtrëngimin neto të standardeve kreditore. Shtrëngimi neto ishte më evident si rezultat i aftësisë paguese të konsumatorëve, e më pak për shkak të rrezikut mbi kërkesat e kolateralit.

Kostoja e fondeve dhe kufizimet në bilancin e gjendjes si dhe konkurrenca nga blerjet e shtëpive nga burimet jobankare janë raportuar të kenë qenë kryesisht neutrale. Po ashtu, pritjet përkitazi me aktivitetin e përgjithshëm ekonomik kanë mbetur kryesisht të pandryshuara dhe nuk kanë kontribuar në ndryshimet në standardet kreditore për kreditë konsumuese dhe huazimet tjera për ekonomitë familjare.

Rezultatet e anketës së tetorit sugjerojnë se përqindja neto e bankave që në tre muajt e ardhshëm pritet të lehtësojnë standardet kreditore për kreditë konsumuese dhe huazimet tjera për ekonomitë familjare është 29 përqind. Krahasuar me anketën e tremujorit të dytë, kur, në baza neto, 43 përqind e bankave prisnin ti lehtësojnë standardet kreditore gjatë tremujorit të ardhshëm, pritjet në tremujorin e tretë paraqiten të jenë më pak optimiste.

Rregullat dhe kushtet: Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011, bankat kanë raportuar se kanë lehtësuar rregullat dhe kushtet kreditore për kreditë konsumuese dhe huazimeve tjera të ekonomive familjare.

Figura 8. Ndryshimi i kushteve dhe rregullave të aplikuara për kreditë konsumuese dhe huazimet tjera për ekonomitë familjare gjatë tre muajve të fundit (në %)



Burimi: BQK (2011)

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshimi ndërmjet shumës së përqindjes për "shtrënguara në masë të konsiderueshme" dhe "shtrënguara deri në një masë" dhe shumës së përqindjes për "lehtësuara deri në një masë" dhe "lehtësuara në masë të konsiderueshme"

Bazuar në përgjigjet e dhëna nga bankat, lehtësimiti i rregullave dhe kushteve kreditore për këto kredi kryesisht është bërë në aspektin e kërkesave për kolateral. Për tremujorin e tretë, 43 përqind e bankave (në baza neto) kanë raportuar për lehtësim të kërkesave për kolateral (Figura 7). Ky nivel është më i lartë krahasuar me tremujorin paraprak (në anketën e qershorit, përqindja neto e bankave që raportuan për lehtësim të kërkesave për kolateral ishte 29 përqind). Përveç kësaj, bankat kanë raportuar se kanë lehtësuar rregullat dhe kushtet për këto kredi edhe përmes ngushtimit të marginës së interesit për kredi. Në

anketën e tetorit, 14 përqind e bankave në baza neto kanë raportuar se kanë ngushtuar marginën e normës së interesit, krahasuar me 29 përqind në anketën e korrikut. Në anën tjetër, bankat kanë shtrënguar rregullat dhe kushtet për këto kredi në aspektin e pagesave tjera përveç normave të interesit, të cilat kanë shënuar rritje.

Kërkesa për kredi: Në anketën e tetorit, në baza neto, 43 përqind e bankave raportuan se kërkesa e ekonomive familjare për kredi konsumuese dhe huazime të tjera mbeti e pandryshuar në krahasim me tremujorin paraprak ³¹ (Tabela 6).

Tabela 6. Ndryshimet në kërkesën për kreditë konsumuese dhe huazimet tjera për ekonomitë familjare gjatë tre muajve të kaluar (në %)

	Kreditë konsumuese dhe huazime tjera	
	Qershor 2011	Shtator 2011
Është zvogëluar në masë të konsiderueshme	0	0
Është zvogëluar deri në një masë	0	29
Kryesisht ka mbetur e pandryshuar	29	43
Është rritur deri në një masë	57	29
Është rritur në masë të konsiderueshme	14	0
Gjithsej	100	100
Përqindja neto	71	0
Numri i bankave që janë përgjigjur	7	7


Burimi: BQK, 2011.

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshim ndërmjet shumës së përqindjes për “është rritur në masë të konsiderueshme” dhe “është rritur deri në një masë” dhe shumës së përqindjes për “është zvogëluar deri në një masë” dhe “është zvogëluar në masë të konsiderueshme”.

Për sa i përket faktorëve të veçantë që kanë ndikuar në kërkesën e ekonomive familjare për këto kredi, bankat raportuan se rritja e në mallra konsumuese ka qenë njëri ndër faktorët që ka ndikuar më së shumti në rritjen e kërkesës për kredi konsumuese dhe huazime tjera nga ekonomitë familjare (Figura 9). Po ashtu, në baza neto, 14 përqind e bankave raportuan se ndikim në rritjen e kërkesës për këtë kategori të kredive kishte edhe siguria e konsumatorëve. Në rezultatet e anketës së tetorit, 71 përqind e bankave raportuan se konkurrenca nuk kishte ndikim në ndryshimin e kërkesës për kredi, ndërsa 29 përqind e bankave raportuan se konkurrenca ndikoi në zvogëlimin e kërkesës për kredi konsumuese dhe huazime tjera nga ekonomitë familjare. Kjo tregon se, në baza neto, 29 përqind e bankave kanë raportuar për ndikim negativ të konkurrencës në kërkesës për kredi konsumuese dhe huazime tjera nga ekonomitë familjare. Ndërsa, ndikim në zvogëlimin e kërkesës për kreditë konsumuese dhe huazimet tjera për ekonomitë familjare kishte kryesisht konkurrenca nga bankat tjera si dhe burimet tjera të financimit për ekonomitë familjare.

³¹ Përqindja pozitive neto tregon se bankat kanë raportuar rritje të kërkesës (rritje neto), ndërsa përqindja negative neto tregon se bankat kanë raportuar për zvogëlim të kërkesës (zvogëlim neto).

Figura 9. Ndikmi i faktorëve në ndryshimin e kërkesës për kredi konsumuese dhe huazimet tjera të ekonomive familjare gjatë tre muajve të fundit (në %)



Burimi: BQK (2011)

Shënim: Përqindja neto definohet si ndryshimi ndërmjet shumës së përqindjes për "është rritur në masë të konsiderueshme" dhe "është rritur deri në një masë" dhe shumës së përqindjes për "është zvogëluar deri në një masë" dhe "është zvogëluar në masë të konsiderueshme".

Për sa i përket pritjeve për tremujorin e ardhshëm, neto përqindja e bankave që raportuan se presin të ketë rritje në kërkesës për kreditë konsumuese dhe huazimet tjera për ekonominë familjare qëndroi në 14 përqind (niveli i njëjtë me anketën e korrikut).

8.4. Përmbledhje

Ky artikull ka paraqitur rezultatet dhe metodologjinë e Anketës së Kreditimit Bankar për Kosovën, të cilën Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka filluar ta zbatojë me bankat komerciale që operojnë në Kosovë. Qëllimi primar i kësaj ankete është të vëzhgojë më për së afërmi zhvillimet në tregun kreditor në Kosovë, si anën e ofertës për kredi ashtu edhe në anën e kërkesës për kredi.

Rezultatet e anketës së tetorit sugjerojnë se gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011 bankat në përgjithësi i kanë lehtësuar standardet për kredi për ndërmarrjet. Sidoqoftë, lehtësimi më i theksuar është raportuar për NMV-të, ndërsa për ndërmarrjet e mëdha standardet kreditore kanë mbetur kryesisht të pandryshuara. Bankat po ashtu raportojnë se gjatë kësaj periudhe janë lehtësuar kushtet dhe rregullat për kreditë për ndërmarrje krahasuar me tremujorin e kaluar. Përkundër këtyre lehtësimeve, rezultatet e anketës sugjerojnë se gjatë tremujorit të tretë ka pasur zvogëlim të konsiderueshëm të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet. Zvogëlimi ishte më i theksuar për ndërmarrjet e mëdha se sa për NVM-të.

Sa i përket, ekonomive familjare, bankat raportuan për dy kategori të kredive, gjegjësisht për kreditë për blerje të shtëpive dhe për kreditë konsumuese dhe huazimet tjera. Rezultatet e anketës së tetorit në përgjithësi tregojnë se, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011, bankat kanë lehtësuar standardet e kreditimit për kreditë e ekonomive familjare të destinuar për blerje të shtëpive. Po ashtu, bankat kanë raportuar se kanë lehtësuar edhe rregullat dhe kushtet e kreditimit për blerje të shtëpive dhe atë sidomos në aspektin e zvogëlimi të marginës së normës interesit, që nënkupton se ekonomive familjare u janë ofruar kredi me norma më të ulëta të interesit për blerjen e shtëpive. Megjithatë, bankat raportojnë se gjatë tremujorit të tretë ka pasur ngadalësim në rritjen e kërkesës për kredi

të destinuara për blerje të shtëpisë krahasuar me anketën e korrikut. Rezultatet të ngjashme janë përfituar edhe për sa i përket kredive konsumuese dhe huzimeve tjera të ekomive familjare, ku po ashtu është raportuar për lehtësim të standardeve kreditore si dhe të rregullave dhe kushteve për kredi, përderisa kërkesa për këto kredi raportohet të ketë mbetur kryesisht e pandryshuar.

Anketa për Kreditimin Bankar për Kosovën është fazën fillestare të implementimit, andaj edhe rezultatet e paraqitura në këtë artikull mund të mos reflektojnë me shumë saktësi situatën reale dhe, si të tilla, duhet të interpretohen me kujdes.

9. Përcaktuesit e Kredive Joperformuese në Vendet e Tranzicionit

Albulenë KASTRATI*

9.1. Hyrje

Ky artikull hulumton faktorët që ndikojnë në kreditë joperformuese (KJP) në ekonomitë e tranzicionit, me të dhëna makroekonomike, të marra kryesisht nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në periudhën 1994-2009. Duke marrë parasysh se niveli i KJP-ve shërben si një matës i efikasitetit dhe stabilitetit bankar (Rinaldi dhe Sanchis-Arellano 2006, King and Goodfriend, 1997) si dhe duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit bankar në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, është me interes të gjenden faktorët kryesorë të performancës së huasë në vendet e tranzicionit.

Pjesërisht, niveli i KJP-ve në vendet e tranzicionit mund të shpjegohet duke u bazuar në historinë e procesit të tranzicionit në këto vende. Sektori bankar në vendet e tranzicionit ka evoluar nga sistemi i një institucioni të vetëm, siç është banka shtetërore (Berglof dhe Bolton, 2001). Me fillimin e procesit të tranzicionit, sektori financiar i ekonomive në tranzicion u transformua nga një sistem i centralizuar, në një sistem të tregut të lirë, d.m.th. filloi privatizimi i njësive bankare shtetërore në banka private komerciale, si dhe filloi hyrja e bankave të reja në treg. Ky proces u manifestua me prezencën e një sërë bankash të reja, shumica e të cilave ishin me pronësi të huaj. Bashkë me privatizimin e njësive të bankave shtetërore, bankat komerciale private gjithashtu trashëguan edhe asetet dhe detyrimet e bankave të mëparshme, ku përfshiheshin depozitat në vend, kreditë nga banka qendrore si dhe portfolio të kredive ndaj ndërmarrjeve të kualitetit të panjohur. Duke qenë se bankat shtetërore në vendet e tranzicionit kanë gjeneruar nivele relativisht të larta të kredisë për të nxitur rritjen ekonomike, megjithatë, praktikat e bankave shtetërore në aspekt të shqyrtimit dhe monitorimit të kredive, janë treguar si relativisht të pasukseshme. Rrjedhimisht, edhe mosdetyrimi për shlyerjen e kredive mund të ketë rezultuar në rritjen e KJP-ve. Prandaj, njësitë që kishin një përqindje më të ulët të KJP-ve patën fatin të privatizohen në fazat e para të procesit të tranzicionit (kryesisht gjatë viteve '90). KJP-të mund të jenë rritur edhe për shkak të hyrjeve të reja, mungesës së kriterëve adekuate të licencimit dhe mungesës së mbikëqyrjes së duhur. Prandaj, në këtë fazë të tranzicionit, KJP-të e trashëguara ishin më tepër pasojë e historisë dhe inercisë, se sa një rrjedhojë e operacioneve në treg.

Megjithatë, më vonë gjatë procesit të tranzicionit (gjatë viteve 2000), përveç menaxhimit të brendshëm të bankave, faktorë të tjerë si niveli i reformave në sektorin bankar, hyrja në fuqi dhe zbatimi i ligjeve të reja, apo edhe niveli i rritjes ekonomike u bënë faktorë të rëndësishëm të nivelit të KJP-ve. Përveç faktorëve të lartë përmendur, është më rëndësi të konsiderohet edhe recesioni i fundit që pasoi pas krizës globale financiare në vitin 2008, si pasojë e të cilit, aftësia e firmave dhe ekonomive familjare për të shlyer kreditë u zvogëlua, gjë që shkaktoi rritje të konsiderueshme të KJP-ve.

* Albulenë Kastrati është Ekonomiste në Departamentin e Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike në BQK.

9.2. Rishikim i literaturës

Raporti i KJP-ve ndaj totalit të kredive konsiderohet si një tregues konvencional i rrezikshmërisë së sistemit bankar, që tregon si cilësinë e mjedisit operativ, ashtu edhe aftësinë e bankave për të vlerësuar nivelin e rrezikut (Podpiera dhe Weill, 2007).

Një prej faktorëve që mund të ketë ndikim në nivelin e KJP-ve, është rritja ekonomike. Në periudhat e zhvillimit ekonomik, performanca e ndërmarrjeve, si dhe të ardhurat e ekonomive familjare kanë tendencë të rriten. Rrjedhimisht, edhe aftësia për të shlyer kredinë rritet. Prandaj, zhvillimi ekonomik pritet të reduktojë nivelin e KJP-ve (Hou, 2007).

Përveç rritjes ekonomike, faktor tjetër që konsiderohet të ketë ndikim në shfaqjen e KJP-ve është edhe prezenca e bankave me pronësi të huaj. Bankat me pronësi të huaj janë bërë protagonistë kryesorë në sistemin financiar të ekonomive në tranzicion, duke marrë parasysh se zotërojnë mbi 80 përqind të asetëve të sektorit financiar. Bonin et al., (2004) sugjerojnë se pronësia e huaj pritet të rrisë performancën dhe efikasitetin bankar, dhe për pasojë të kontribuojë në nivele më të ulëta të KJP-ve. Investitorët e huaj zakonisht sjellin teknologji të re dhe kapital njerëzor në bankat vendore, të cilat akoma janë të ngarkuara me trashëgiminë e periudhës centraliste (Buch, 1997). Meqë shumica e bankave me pronësi të huaj në vendet e tranzicionit (të cilat do të analizohen më poshtë), kanë origjinën nga vendet e BE-së, pretendohet që këto banka të kenë teknika më të mira të vlerësimit të rrezikut, gjë që sjellë performancë më të mirë bankare dhe me kalimin e kohës, rënie të KJP-ve. Në anën tjetër, bankat në pronësi shtetërore janë gjithashtu një nga faktorët që mund të çojnë në një përqindje më të lartë të KJP-ve, kryesisht për shkak të keqmenaxhimit të burimeve dhe mungesës së stimujve adekuatë ndaj personelit (Berglof dhe Bolton, 2001).

Një faktor tjetër që konsiderohet të ketë ndikim të konsiderueshëm në nivelin e KJP-ve, është edhe niveli i konkurrencës në tregun bankar. Përderisa disa studime hulumtuese sugjerojnë një treg bankar konkurrues mund të përmirësojë kualitetin e kredive, studime tjera mbajnë qëndrim të kundërt. Bazuar në hipotezën e Keely (1990) apo "charter value", rritja e konkurrencës do të ulte koston oportune të bankave në falimentim, d.m.th do të inkurajonte bankat të ndërmarrin rrezik më të lartë në mënyrë që të ruajnë fitimet. Prandaj, financimi i projekteve me risk të lartë, mund të ndikojë në rritjen e KJP-ve. Në anën tjetër, Boyd dhe De Nicolo (2005) argumentojnë se një sistem bankar konkurrues ka më pak gjasa të vuaj nga KJP-të. Kjo pikëpamje e paraqet konkurrencën në tregun bankar si të dobishme për mirëqenien e bankave, sepse rritja e konkurrueshmërisë do të ulëte nivelin e normave të interesit, duke ulur kështu edhe probabilitetin që kredimarrësit të përfshihen në projekte risikoze për të kthyer kredinë.

Një determinues tjetër me ndikim në shfaqjen e KJP-ve, janë edhe kreditë e lëshuara për sektorin privat. Kjo për shkak se kreditë e sektorit privat karakterizohen me një nivel më të lartë të rrezikshmërisë, krahasuar me kreditë e lëshuara ndaj qeverisë.

Faktorë tjetër makroekonomik me ndikim të konsiderueshëm në mënyrën se si bankat operojnë, janë edhe normat nominale të interesit (Roe et al., 1997). Normat e larta të interesit konsiderohen se intensifikojnë përzgjedhjen jo të duhur të huamarrësve, ku huamarrësit e 'këqinj' tentojnë të marrin më shumë hua dhe huamarrësit e 'mirë' tentojnë të marrin më pak hua. Sa më e lartë norma e interesit të kredisë, për shkak të infomatave

josimetrike mes kredimarrësve dhe bankave, firmat mund të përfshihen në projekte rriske, me qëllim të rritjes së fitimit të pritur. Sa më i lartë të jetë rreziku i ndërmarrë nga kredimarrësit, aq më i lartë do të jetë probabiliteti i dështimit të projektit investues, që reflektohet në moskthim të kredisë (Williamson, 1987).

Përderisa normat nominale të interesit influencin kryesisht çasjen e bankave ndaj kredidhënies, inflacioni është një tjetër faktor makroekonomik, i cili nga ana tjetër mund të ndikojë në sjelljen e huamarrësit. Literatura ofron dëshmi të një marrëdhënie pozitive ndërmjet përqindjes së inflacionit dhe kredive KJP-ve. Sa më e lartë të jetë norma e inflacionit, mundësia që huamarrësi të mos mund të shlyej borxhin rritet, pasi bëhet më e vështirë për huamarrësin të shlyejë kredinë me kushtet e dakorduara në fillim (në rastin e pagave fikse) apo kolateralin që mbështet kredinë. Megjithatë, në rastet kur për shkak të inflacionit të rritur norma reale e interesit që huamarrësi do të kthejë do të jetë negative, atëherë, bazuar në 'ekuacionin e Fisherit', do të jetë më e lehtë për huamarrësin të shlyejë kredinë, pra norma e KJP-ve do të bie (Cziráký dhe Gillman, 2006).

Përveç faktorëve makroekonomikë, në nivelin e KJP-ve ndikim të rëndësishëm mund të kenë edhe faktorët institucionalë, siç është zbatimi i ligjit. Megjithatë, zbatimi i ligjit në vendet e tranzicionit mund të ketë ndikim të dyanshëm. Vendet me sistem gjyqësor më pak efikas prirën të kenë përqindje më të lartë të KJP-ve, pasi që kolaterali nuk ekzekutohet lehtë dhe huamarrësi nuk detyrohet të shlyejë kredinë e marrë. Nga ana tjetër, implementimi i ligjit, gjithashtu mund të inkurajojë bankat të rrisin vëllimin e kredive të lëshuara me kushte të favorshme dhe monitorim të ulët (Qian dhe Strahan, 2007), duke inkurajuar kështu rritje të KJP-ve.

Niveli i reformave në sektorin bankar paraqet një tjetër faktor të rëndësishëm institucional në raport me KJP-të në vendet e tranzicionit (Roe et al., 1997). Kjo për arsye se, një sistem bankar i reformuar (përafrimi i ligjeve dhe rregullativave bankare me Standardet Ndërkombëtare, funksionimi i konkurrencës së lirë dhe mbikqyrje efektive, afatizimi i kredive ndaj ndërmarrjeve private si dhe kapitlizimi i qëndrueshëm i sistemit bankar, etj.) zbaton teknika më të avancuara për lëshimin e kredive dhe vlerësimin e rrezikut në treg, duke zvogëluar kështu edhe informatat josimetrike në mes të kredimarrësit dhe kredidhënësit. Prandaj, vendet me sistem bankar më të reformuar pritet të kenë raport më të ulët të KJP-ve.

8.3. Të dhënat dhe metodologjia

Në këtë studim trajtohen variabla të përgjithshme makroekonomike me qëllim të identifikimit të disa faktorëve që kanë ndikim në stabilitetin dhe efikasitetin bankar, d.m.th. në nivelin e KJP-ve në vendet e tranzicionit.

Qëllimi kryesor i këtij artikulli është që të hulumtojë faktorët që ndikojnë në KJP në këto vende të tranzicionit: Shqipëri, Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Bosnje dhe Hercegovinë, Gjeorgji, Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Moldavi, Mal të Zi, Kosovë, Rumani, Serbi dhe Ukrainë. Arsyeja e përzgjedhjes së këtij grupi shtetesh qëndron te ngjashmëria që kanë këto vende në aspekt të zhvillimit ekonomik, në veçanti, si dhe karakteristikat e ngjashme në sektorin bankar (Komisioni Evropian, 2009; UNDP, 2009). Secili vend në model përmbanë 5 deri në 15 observime vjetore, nga viti 1994 deri në vitin 2009. Numri i përgjithshëm i observimeve në këtë studim është 190. Të dhënat janë marrë nga Raporti i Tranzicionit BERZH (2010), FMN (2010), Banka Botërore dhe bankat qendrore të vendeve përkatëse.

Modeli i vlerësuar ka formën e më poshtme:³³

$$\ln KJP_{it} = \ln KJP_{it-1} + \beta_1 PBB_{it} + \beta_2 BSH_{it} + \beta_3 BH_{it} + \beta_4 NB_{it}^{34} + \beta_5 KP_{it} + \beta_6 INT_{it} + \beta_7 CPI_{it} + \beta_8 IZL_{it} + \beta_9 IRSB_{it} + \beta_{10} T_t + u_{it} \dots \dots \dots (1)$$

i- shteti (*i*=1,2,...15)

t- viti (*T*=1,2...14)

Tabela 1. Përshkrimi i variablave në model

Variablat	Përshkrimi
<i>Variabla e varur</i>	
KJP	Raporti i kredive joperformese ndaj gjithsej kredive.
<i>Variablat e pavarura</i>	
NB	Totali I numrit të bankave
BSH	Përqindja e aseteve me pronësi shtetërore ndaj gjithsej aseteve të sektorit bankar.
BH	Përqindja e aseteve me pronësi të huaj ndaj gjithsej aseteve të sektorit bankar.
KP	Gjithsej kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare, si për qindje e PBB-së.
INT	Norma e interesit nominal.
PBB	Norma reale e rritjes ekonomie.
PBBt-1	Norma reale e rritjes ekonomie të vitit të mëparshëm.
CPI	Mesatarja vjetore e çmimeve të konsumit.
IZL	*Efikasiteti I sistemit gjyqësor dhe zbatimimi I ligjit.
IRSB	**Shkalla e funksionimit të rregullave, standardeve, mbikqyrjes efektive, etj.
D1995	Variabël diskrete.
D1996	Variabël diskrete.
D1997	Variabël diskrete.
D1998	Variabël diskrete.
D1999	Variabël diskrete.
D2000	Variabël diskrete.
D2001	Variabël diskrete.
D2002	Variabël diskrete.
D2003	Variabël diskrete.
D2004	Variabël diskrete.
D2005	Variabël diskrete.
D2006	Variabël diskrete.
D2007	Variabël diskrete.
D2008	Variabël diskrete.
D2009	Variabël diskrete.

*Indeksi IZL rangohet prej -2.5 deri në 2.5. IZL=-2.5 paraqet shkallën më të ulët të efikasitetit institucional dhe zbatimit t ligjeve bankare, ndërsa IZL=2.5 paraqet shkallën më të lartë të efikasitetit institucional.

**Indeksi IRSB rangohet prej 1 në 4. IRSB=1 tregon progres të pamjaftueshëm në implementimin e reformave banakre. IRSB=4 tregon progres të konsiderueshëm në zbatimin e reformave bankare.

³³ Në kapitullin vijues modeli i vlerësuar merr formën e diferencimit (niveli i parë) të sistemit GMM, me qëllim të evitimit të dukurisë së autokorrelacionit.

³⁴ Konkurrenca në këtë studim vlerësohet përmes një variable të përafërt, siç është numri i bankave.

9.3. Rezultatet

Ky kapitull prezenton rezultatet e vlerësuara sipas metodës së sistemit GMM. Po ashtu, koeficientët janë diferencuar edhe njëherë (diferencim i rendit të parë). Diferencimi i rendit të parë është praktikuar në model sepse ka kontribuar në përmirësimin e rezultateve. Viti i referimit është viti 1994. Bazuar në modelin e vlerësuar, rezultatet janë si vijojnë.

Tabela 2. Rezultatet e regresionit

Variablat	Variabla e varur LnKJP
	Koeficientët
Konstanta	1.45
LnKJPt-1	18.2***
Numri i Bankave	10.1*
Bankat Shtetërore	-0.00481
Bankat e Huaja	0.00521
Kreditë ndaj Sektorit Privat	0.0144
Norma e Interesit Nominal	0.0971
PBB	-0.262**
PBBt-1	-0.027
Inflacioni	-0.0451**
Indeksi i Reformave të Sektorit Bankar	-0.899
Indeksi i Zbatimit të Ligjit	-0.356
Viti 1995	1.81
Viti 1996	-1.81
Viti 1997	0.496
Viti 1998	2.23
Viti 1999	4.08
Viti 2000	0.406
Viti 2001	0.866
Viti 2002	0.396
Viti 2003	-0.212
Viti 2004	0.613
Viti 2005	-0.194
Viti 2006	0.594
Viti 2007	-0.222
Viti 2008	2.76
Viti 2009	5.10*

***p<0.01, **p<0.05, *p<0.1*

KJP-të e vitit të kaluar vlerësohen si statistikisht të rëndësishme në model, duke treguar kështu se KJP-të kanë natyrë dinamike (Tabela 2). Rezultati sugjeron se nëse norma e KJP-ve në periudhën e kaluar rritet, edhe norma e tanishme e KJP-ve do të rritet. Të dhënat në këtë model fillojnë nga fundi i viteve '90-ta, që konsiderohet si një periudhë e ndryshimeve financiare, veçanërisht në vendet baltike dhe ato të ish bashkimit sovjetik, dhe një periudhë turbulencash në vendet e Ballkanit. Ndaj bankat e këtyre vendeve mund të kenë trashëguar 'kredi të këqija' nga vitet e mëparshme, të cilat mund të kenë përkeqësuar kualitetin e portfolios së kredive. Për më tepër, rezultati tregon se norma rritjes ekonomike është statistikisht e rëndësishme, dhe ka raport negativ me raportin e KJP-ve. Ky rezultat është në linjë me pritjet teorike, pasi që në kohën e rritjes ekonomike, aftësia e ndërmarrjeve dhe individëve për të shlyer kredinë pritjet të rritet, ndërsa raporti i KJP-ve bie. Numri i bankave, si një matës konkurrencës në tregun bankar, ka ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm në raportin e KJP-ve. Kjo tregon se nëse numri i bankave që operojnë në vendet e tranzicionit rritet, raporti i KJP-ve po ashtu do të rritet. Ky rezultat është në përputhje me hipotezën e Keely (1990) apo "charter value", e cila sugjeron se rritja e konkurrencës i ofron bankave stimuj për të ndërmarrë rrezik më të lartë, gjë e cila çon në një nivel më të lartë të KJP-ve. Norma e inflacionit rezulton të ketë ndikim negativ dhe është statistikisht e rëndësishme në raport me normën e KJP-ve. Kjo gjetje është në përputhje me teorinë e cila sugjeron se inflacioni i lartë, në disa raste mund të shkaktojë normën reale negative të interesit, gjë që e bën më të lehtë shlyerjen e kredisë nga huamarrësit. Përveç variablave tjera, në këtë studim (model) kontrollohet gjithashtu sjellja e KJP-ve gjatë viteve 1995-2009. Të gjitha vitet në model (1995-2008) tregojnë për një ndikim statistikisht të parëndësishëm në normën e KJP-ve, në krahasim me vitin e referimit (1994), me përjashtim të vitit 2009, i cili tregohet të jetë statistikisht i rëndësishëm dhe me ndikim pozitiv në normën e KJP-ve. Viti 2009 është një vit i dalluar sa i përket normës së KJP-ve, duke pasur parasysh fillimin e krizës financiare në vitin 2008, efektet e së cilës janë transferuar kryesisht gjatë vitit 2009.

Në anën tjetër, faktorë të rëndësishëm që u trajtuan në këtë studim janë vlerësuar me ndikim josisignifikant në raportin e KJP-ve, siç janë: bankat shtetërore, bankat me pronësi të huaj, kreditë ndaj sektorit privat, norma nominale e interesit, rritja ekonomike e vitit të kaluar, reformat e sistemit bankar dhe implementimi i ligjit. Në këtë kontekst, duhet marrë në konsideratë se modeli i këtij studimi mund të jetë subject i kufizimeve (mangësive) potenciale, si pasojë e kualiteti të të dhënave për shkak të raportimit jo konsistent në vendet e tranzicionit në model krahasuar me nivelin e raportimit në vendet e zhvilluara, si dhe një seri kohore relativisht e shkurtë, që zakonisht është karakteristike e vendeve në tranzicion.

9.4. Përmbledhje

Ky artikull hulumtoi përcaktuesit e kredive joperformuese në ekonominë e tranzicionit. KJP-të janë një indikator i rëndësishëm i performancës dhe brishtësisë së sektorit bankar, që mund të ndikojnë në stabilitetin e përgjithshëm financiar, siç është treguar kohët e fundit gjatë krizës financiare në vitin 2008. Në këtë drejtim, ne kemi përdorur të dhëna nga 15 vende të tranzicionit, me një seri kohore që përfshin vitet 1994-2009. Me qëllim të hulumtimit të faktorëve që ndikojnë në raportin e KJP-ve, ky studim vlerësoi rezultatet përmes panelit dinamik. Bazuar në gjetjet e këtij studimi, KJP-të e vitit të kaluar kanë tendencë që të përsëritën edhe në vitin aktual, duke lënë të kuptohet se në rast të rritjes së KJP-ve, bankat duhet të aplikojnë politika më rigorozë të kreditimit. Nga ana tjetër, normat reale të rritjes ekonomike, inflacioni dhe konkurrenca në tregun bankar tregojnë se

faktorët që janë jashtë kontrollit të bankave mund të ndikojnë në raportin e KJP-ve. Së fundi, një gjetje e rëndësishme në këtë artikull është se viti 2009 rezultoi me efekt të rëndësishëm në rritjen e KJP-ve. Ky rezultat është në përputhje me zhvillimet që kanë karakterizuar vitin 2009, sidomos pjesën e parë të vitit, duke pasur parasysh zhvillimin e krizës financiare 2008-2009 dhe recesionet që pasuan.

10. Përcaktuesit e Investimeve të Emigrantëve: a ka Hapësirë për Politikëbërje?

Sokol HAVOLLI* dhe Boštjan JAZBEC†

10.1. Hyrje

Kosova është ndër vendet e fundit që ka filluar procesin e tranzicionit si dhe ringjalljes ekonomike. Mirëpo, duke pasur mungesë të vlerësimit kreditor si dhe mekanizmave të shpërndarjes së informacioneve në qarqe ndërkombëtare mbi ambientin e përgjithshëm ekonomik, limitohet ndërtimi i besueshmërisë së nevojshme për investitorët e huaj që e konsiderojnë Kosovën si vend potencial për investimet e tyre. Investimet në vitet e fundit në të shumtë e rasteve ishin të ndërmarra nga sektori privat vendas si dhe investimet publike, ndërsa në masë më të vogël nga investitorët e huaj. Në anën tjetër, Kosova ka një potencial të pa shfrytëzuar në tërheqjen e investimeve në vend duke marrë parasysh se rreth gjysmë milioni kosovarë jetojnë jashtë vendit. Një pjesë e rëndësishme e IHD-ve në Kosovës janë investimet e diasporës kosovare të cilët kanë marrë pjesë në procesin e privatizimit si dhe në investime tjera direkte në bashkëpunim me partnerë të huaj.

Sa i përket investimeve, edhe emigrantët janë të rezervuar në dëshirën e tyre për të investuar në ekonominë e Kosovës. Ndikim në vendimet e emigrantëve për investime në Kosovë vazhdon të ketë perceptimi i tyre mbi mjedisi e biznesit të Kosovës i cili ende nuk ka siguruar mbrojtje të mjaftueshme për investimet e tyre. Edhe pse mund të argumentohet se dërgesat kryesisht paraqesin formë të rëndësishme të mbështetjes së konsumit dhe rritjes së kërkesës për mallra konsumi dhe shërbime, e rëndësishme për tu analizuar mbetet sjellja e emigrantëve në raport me perceptimin e tyre për mjedisin e biznesit në Kosovë dhe ndërmarrja e investimeve nga ta. Në këtë punim synohet të trajtohet ky problem, ndërsa përgjigjet e gjetura nuk janë befasuese. Faktor i rëndësishëm në vendimin e emigrantëve për të ndërmarrë investime në vend rezulton të jetë mjedisi i biznesit në Kosovë; ky faktorë gjithashtu mund të ndikojë edhe në tërheqjen e IHD-ve në përgjithësi. Edhe pse rritja pozitive ekonomike dhe fleksibiliteti i fuqisë punëtore mund të paraqesë indikatorë të mirë për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës dhe sinjal pozitiv për ambientin e përgjithshëm, përmirësime nevojiten sidomos në mjedisin ligjor, ndërmjetësimin financiar, si dhe perceptimet e përgjithshme për funksionimin e institucioneve të tregut.

Ky punim është i organizuar si në vijim. Kapitulli i dytë ofron disa figura mbi potencialin ekonomik të diasporës kosovare. Të dhënat sugjerojnë se 25 përqindëshi i popullsisë që jeton jashtë vendit realizojnë të ardhura rreth 4 miliardë euro gjatë një viti. Pjesë e rëndësishme e të ardhurave dërgohen në Kosovë si dërgesa të emigrantëve (remitanca). Mirëpo, përkundër identifikimit të disa investimeve të rëndësishme, të dhënat janë ende të një kualiteti jo të mirë për investimet e diasporës. Sidoqoftë, në kapitulli 3 të këtij punimi prezantohet një model i thjeshtë për përcaktuesit e investimeve të emigrantëve. Gjetjet tregojnë se perceptimi mbi ambientin e biznesit në Kosovë është njëra nga përcaktuesit

* Sokol Havolli është Ekonomist i Lartë në Departamentin e Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike në BQK.

† Boštjan Jazbec është Këshilltar i Guvernatorit të BQK-së.

kryesor për investime. Prandaj, pritjet janë se përmirësimet në ambientin e biznesit në Kosovë do të ndikojnë pozitivisht në tërheqjen e investimeve të huaja, jo vetëm për shkak të investimeve të diasporës, por gjithashtu edhe për shkak të sinjaleve të cilat transmetohet për investitorët e huaj potencial. Kapitulli i katërt ofron disa përmbledhje të përgjithshme.

10.2. Potenciali Financiar i Diasporës së Kosovës

Shifrat tregojnë se emigrantët nga Kosova përbëjnë 20-25 për qind të popullsisë së përgjithshme (UNDP, 2010, Riinvest, 2006). Kjo tregon se rreth gjysmë milioni kosovarë jetojnë jashtë vendit. Me një nivel relativisht të madh të emigrimit të përqendruar kryesisht në vendet e zhvilluara (rreth 90 për qind në vendet e Bashkimit Evropian, sipas UNDP 2010), emigrantët kosovarë duket se kanë një nivel të lartë të të ardhurave. Vlerësimet (llogaritje të autorëve bazuar në UNDP, 2010, Nexus, 2009 dhe Riinvest 2006) tregojnë se të ardhurat vjetore të emigrantëve kosovarë janë mbi 4 miliardë Euro. Bazuar në vlerësimet duke përdorur disa sondazhe, mund të thuhet se kursimet dhe dërgesat e emigrantëve përbëjnë rreth 28, përkatësisht 12 për qind të të ardhurave totale të emigrantëve. Si rrjedhojë, potenciali i emigrantëve kosovarë për të investuar në vendlindjen e tyre është i konsiderueshëm. Megjithatë, investimet e emigrantëve në vendlindjen e tyre varen nga marrëdhëniet që emigrantët kanë me vendlindjen, familjet e tyre dhe të afërmit. Faktorë të tjerë social dhe ekonomik poashtu luajnë rolin e tyre, megjithatë, më e rëndësishmja, pritet të jetë perceptimi i emigrantëve mbi mjedisi e përgjithshëm ekonomik në Kosovë. Me kursimet dhe dërgesa (remitanca) prej rreth 2 miliardë euro në vit, emigrantët mund të jenë burimi kryesor për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Për më tepër, me një nivel të IHD prej rreth 7-8 për qind të PBB-së gjatë pesë viteve të fundit, rreth 30 për qind është kapitali i emigrantëve nga Kosova, të cilët së kanë ndërmarrë investime të përbashkëta me kompanitë të huaja (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, 2010). Prandaj, bazuar në atë që u elaborua më lart, dhe duke përdorur të dhënat nga Anketa e Riinvest (2006) me emigrantë, është ndërtuar modeli në vijim:

$$Minv_i = \beta_i + \beta_1 M_i + \beta_2 Y_i + \beta_3 B_i + \beta_4 D_i + \beta_5 R_i + \mu_i \dots\dots\dots 1$$


ku, $Minv$ përfaqëson variablën e varur diskrete që merr vlerën zero nëse emigranti nuk ka investuar dhe një nëse emigrantë ka investuar në një biznes apo pronë në Kosovë. Karakteristikat personale të emigrantit si mosha, gjinia dhe arsimimi si dhe statusi martesor janë marrë parasysh nga vektori $\beta_1 M$. Të ardhurave e emigrantit janë paraqitur me $\beta_2 Y$, ndërsa $\beta_3 B$ përshkruan perceptimet e emigrantëve për mjedisin e biznesit në Kosovë. Largësia ndërmjet Kosovës dhe vendit të destinacionit është e kontrolluar nga $\beta_4 D$ ndërsa shuma e remitancave që emigranti dërgon çdo vit paraqitet me $\beta_5 R$. Termi i gabimit është përcaktuar nga μ_i .

10.3. Modeli Empirik për investimet e emigrantëve

Duke pasur parasysh se emigrantët e Kosovës kanë një fuqi relativisht të madhe të të ardhurave (si dhe kursimet e akumuluar), potenciali i emigrantëve kosovarë për të investuar në vendlindje është i konsiderueshëm. Siç u përmend në kapitullin e mëparshëm, një pjesë e konsiderueshme e IHD-ve aktuale në Kosovë janë investim i përbashkët i emigrantëve dhe investitorëve të huaj. Bazuar në të dhënat individuale, Tabela 1 paraqet gjetjet e faktorëve që ndikojnë në vendimin e emigrantëve për të investuar në Kosovë. Megjithatë, para shqyrtimit të gjetjeve, duhet të kemi parasysh se problemet diagnostike që dalin nga modeli janë konsideruar, dhe testet tregojnë se modeli është i specifikuar mirë dhe statistikisht i rëndësishëm dhe pa probleme serioze. Sipas gjetjeve, mosha e

emigrantëve luan një rol të rëndësishëm në marrjen e vendimit për të investuar në Kosovë. Gjetjet sugjerojnë se një vit shtesë për moshën e emigrantëve do të rezultojë në një probabilitet më të lartë për të investuar në Kosovë. Megjithatë, kjo lidhje nuk është lineare siç tregohet edhe nga vlera në katrorë e variabiles Moshë. Ajo në fakt tregon se probabiliteti për të investuar rritet por me një normë rënëse (funksion invers në formën U). Kjo marrëdhënie është

Figura 1. Raporti ndërmjet Moshës dhe probabilitetit për Investime nga emigrantët



paraqitur në Figurën 1. Kjo sugjeron se në qoftë se emigrantët janë të moshës 20, probabiliteti që ata do të investojnë në vendlindje vazhdimisht do të rritet për 10 vitet e ardhshme (deri sa të arrijnë moshën 30), potencialisht si rezultat i sjelljes ndërmarrëse më të lartë të emigrantëve të rinj dhe gatishmërisë për të ndërmarrë rrezik më të lartë kur janë në moshë më të re. Për më tepër, potenciali më i madh për të rimarrë veten financiarisht në rast se pësojnë humbje nga investimet, kur janë në moshë më të re, mund të shpjegojë marrëdhënien moshë-investime. Ndërsa në një moshë më të vjetër (d.m.th. mbi 30) probabiliteti për të investuar zvogëlohet dhe kjo mund të jetë për shkak të faktorëve si familja/fëmijët dhe aftësia më e vogël për të ndërmarrë vendime të rrezikshme për të ardhurat e tyre. Sa i përket gjinisë dhe statusit martesor të emigrantit, asnjëra prej tyre nuk ka ndonjë ndikim statistikisht e rëndësishme në probabilitetin për të investuar në Kosovë. Të ardhurat e emigrantit, edhe pse statistikisht të rëndësishme, kanë një efekt relativisht të ulët në probabilitetin për të investuar. Kjo mund të jetë si rezultat i strukturës së ekonomisë (që është pothuajse tërësisht e përbërë nga ndërmarrjet mikro dhe të vogla), të cilat nuk kërkojnë shuma të mëdha për investime. Megjithatë, një shpjegim më i arsyeshëm se pse kjo variabël ka një efekt të vogël në probabilitetin për të investuar do të ishte se ka një mungesë të informacioneve në nivel individual në këto të dhëna, mbi shumën që emigrantët kanë investuar dhe si pasojë, të ardhurat mund të kenë humbur efektin e madhësisë.

Një nga konstatimet kryesore në këtë model vjen nga perceptimet e emigrantëve për mjedisin e biznesit në Kosovë, që konsiderohet edhe si përcaktues kryesor i probabilitetit për investimin e të ardhurave dhe kursimeve të tyre. Kjo tregon se probabiliteti për të investuar në Kosovë rritet shumë, nëse emigranti percepton mjedisin e biznesit si të favorshëm. Gjetja e tillë është e rëndësishme sepse politikat mund të orientohen për të reflektuar pozitivisht tek emigrantët, duke e bërë mjedisin e Kosovës të favorshëm dhe më të lehtë, në mënyrë që të tërheqin investimet e emigrantëve. Sidoqoftë, është e rëndësishme të mos nënvlerësohet rëndësia e kornizës ligjore në Kosovë që në shumë raste mund të konsiderohet si një nga pengesat e bërjes biznes duke mos përkrahur në masë të nevojshme investitorët, në këtë rast edhe emigrantët.

Siç edhe është përkrahur në Jazbec dhe Kastrati (2011), është mungesa e zhvillimit në të gjitha vendet e rajonit- jo vetëm në Kosovë- që mund të konsiderohet si shkaktarë i mungesës së rritjes më të shpejtë ekonomike, rrjedhimisht tërheqjes së IHD-ve. Edhe pse mund të argumentohet se vendet e EJJ-së ishin të suksesshme në krijimin e stabilitetit

makroekonomik dhe me liberalizim të tregut dhe privatizim, është me rëndësi të ceket se zhvillimi më i ngadalshëm në një masë mund ti adresohet mungesës së kornizës institucionale të orientuar në ekonomi të tregut.

Tabela 1. Rezultatet e regresionit në modelin empirik për investimet e emigrantëve

Variablat	(1) Investimet	(2) Investimet	(3) Investimet
Mosha	0.137** (0.0656)		0.124** (0.0528)
Mosha^2	-0.00137* (0.000770)		-0.00115* (0.000643)
Gjinia (1=mashkull)	0.0196 (0.238)	0.147 (0.230)	-7.21e-05 (0.203)
Vitet e Edukimit	-0.0658 (0.0538)	-0.0613 (0.0536)	-0.0545 (0.0452)
Statusi Martesor (1=martuar)	-0.00541 (0.326)	0.425 (0.283)	0.122 (0.238)
Përceptimi mbi ambientin e biznesit	0.616*** (0.199)	0.636*** (0.198)	0.652*** (0.169)
Të ardhurat	0.0001*** (2.75e-05)	0.0001*** (2.80e-05)	0.0001*** (2.51e-05)
Dërgesat e mujore (remitancat)	0.000453* (0.000250)	0.000452* (0.000244)	0.000399** (0.000185)
Distanca deri në vendlindje	-0.000122 (8.25e-05)	-0.000107 (8.70e-05)	-9.66e-05 (6.93e-05)
Vitet e Emigracionit	-0.0625 (0.0712)	-0.0325 (0.0690)	
Vitet e Emigracionit^2	0.00373 (0.00327)	0.00328 (0.00324)	
Konstante	-3.533*** (1.311)	-1.256 (0.808)	-3.896*** (1.075)
Numri i observimeve	663	663	974

Gabimi standard i 'White' në kllapa

*** p<0.01, ** p<0.05, * p<0.1

Burimi: Kalkulime të autorit bazuar në databazën Riinvest (2006)

Nëpërmjet përforsimit të implementimit të kontratave, të drejtës së pronës, implementimi i ligjit, përkrahja ndaj aktiviteteve ekonomike do të ishte më e lartë. Kjo është me rëndësi të veçantë, duke pasur parasysh se në mesin e 27 vendeve të Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore, sa i përket lehtësisë për të bërë biznes (World Bank Doing Business Report, 2009), Kosova renditet e fundit (Tabela 2). Prandaj, ekziston një hapësirë e rëndësishme për hartimin e politikave në përmirësimin e procedurave e të bërit biznes.

Table 2. Indikatorët e Bankës Botërore për Bërje të biznesit në rajonin e EJL-së

	Lehtësia e bërjes biznes	Fillimi i Biznesit	Leja ndërtimore	Punësimi i punëtorëve	Regjistrimi i pronës	Qasja në kredi	Mbrojtja e Investitorëve	Pagesa e taksave/tatimeve	Tregtia ndërkombëtare	Implementimi i kontratave	Mbyllja e biznesit
Shqipëria	18	11	22	16	17	4	2	18	11	22	27
Bullgaria	10	12	11	8	12	1	7	12	17	21	11
Kosova	22	27	24	4	16	11	27	6	19	27	2
Maqedonia	5	2	14	9	14	11	3	1	9	19	22
Mali i Zi	15	18	19	6	24	11	6	19	8	26	5
Serbia	19	15	23	14	21	1	15	17	13	23	21

Burimi: Indikatorët e bërjes biznes sipas Bankës Botërore (Marrë nga Jazbec dhe Kastrati, 2011)

Rrjedhimisht, investitorët privat në vendet e rajonit nuk kanë mbrojtje të nevojshme që si rezultat mund të ndikojë në rritjen e ekspozimit në vendet e rajonit. Përkundër këtyre indikatorëve, Kosova paraqet një vend të rëndësishëm për investitorët e huaj kur krahasohen IHD-të në proporcion me madhësinë e ekonomisë. Gjatë vitit 2010, ndër vendet rajonale, Kosova radhitet e katërta sipas indeksit të performancës së IHD-ve (BQK, 2010). Kosova për më tepër, ka përparësi krahasuese në disa sektorë të ekonomisë për IHD, si p.sh. industria e minierave por edhe një fuqi punëtore fleksibile dhe me kosto të ulët, në krahasim me vendet e EJT-së si Maqedonia, Serbia, Bosnja e Hercegovina etj. të cilat do të mund të ndikojnë në rritjen e përgjithshme të IHD-ve si dhe në tërheqjen e kapitalit të diasporës Kosovare.

10.4. Përmbledhje

Duke pasur parasysh se investimet e emigrantëve si në biznese, po ashtu edhe në patundshmëri, vazhdimisht kanë qenë burim i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik në Kosovë, ky artikull ka synuar të gjejë përcaktuesit kryesor të këtyre investimeve. Rezultatet empirike të përfituara në këtë studim sugjerojnë se faktori më me ndikim në përcaktimin e emigrantëve për të investuar në Kosovë përfaqësohet nga perceptimet e emigrantëve rreth ambientit të biznesit në Kosovë, që do të thotë se gjasat që emigrantët të rrisin investimet e tyre në Kosovë rriten me përmirësimin e perceptimeve të tyre rreth ambientit afarist në Kosovë. Prandaj, nëpërmjet ndërmarrjes së politikave adekuate për përmirësimin e mëtutjeshëm të ambientit afarist në vend mund të ndikohet në përmirësimin e perceptimeve të emigrantëve rreth mundësive investive që ofron Kosova dhe rrjedhimisht të arrihet deri të një shkallë më e lartë e shfrytëzimit të potencialit financiar të diasporës Kosovare. Një rrjedhë më e madhe e investimeve të diasporës drejtë Kosovës paraqet një sinjal pozitiv edhe për investitorët e huaj, gjë e cila mund të rezultojë edhe me rritje të investimeve të huaja në Kosovë si dhe ndërmarrje të përbashkëta investive ndërmjet investitorëve të huaj dhe emigrantëve Kosovar. Lidhjet mjaft të forta të diasporës Kosovare me vendlindjen dhe potenciali mjaft i lartë financiar i tyre paraqesin një perspektivë të mirë për rritjen e investimeve në Kosovë.

Shtojca Statistikore

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sistemi bankar	Grupi bazë i indikatorëve	2008	2009	2010	Qer 2011
Mjftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	16.5	18.1	18.8	17.2
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	15.3	15.2	15.8	14.4
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	2.3	2.9	3.7	5.7
Cilësia e asetëve	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	2.8	4.3	5.2	5.9
	Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive				
	<i>Korporatat tjera financiare</i>	0.1	0.2	0.4	0.4
	<i>Korporatat publike jofinanciare</i>	0.01	0.02	0.43	0.02
	<i>Korporatat tjera jofinanciare</i>	76.2	73.1	69.6	69.9
	<i>Ekonomitë familjare</i>	23.7	26.7	29.5	29.7
	<i>Gjithsej</i>	100.0	100.0	100.0	100.0
Profitabiliteti	Kthimi në asetëve (ROA)	3.0	1.5	1.8	1.4 *
	Kthimi në kapital (ROE)	27.3	15.0	18.8	14.2 *
	Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	75.0	74.4	74.5	75.9
	Shpenzimet jo-interes ndaj të hyrave bruto	68.7	80.2	74.3	79.9
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	26.8	34.6	32.3	24.3
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	28.0	37.3	36.8	29.8
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	33.4	43.6	40.6	31.1
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	35.0	47.0	46.2	38.1
Senzitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	13.1	12.4	0.1	1.3
	Grupi i zgjeruar i indikatorëve				
	Kapitali ndaj asetëve	11.2	9.8	10.1	10.2
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	56.5	64.6	72.4	82.7
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointeresi	36.2	39.4	39.4	39.8
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	9.4	10.1	10.9	10.6
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	117.1	129.8	126.2	114.2
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	4.7	5.4	4.9	5.2

* Të dhënat për ROAA dhe ROAE për qershor 2010 janë të përvitësuar.

Tabela 2. Bilancet e gjendjes së bankave komerciale, qershor 2011, në milionë euro

Procredit Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	90.1	Bilanci nga bankat tjera	2.4
Bilanci me bankat komerciale	40.3	Depozitat	623.1
Letrat me vlerë	107.8	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	476.3	Detyrimet tjera	19.6
Asetet fikse	17.2	Borxhi i ndërvarur	24.5
Asetet tjera	12.0	Mjetet vetanake	74.0
GJITHSEJ ASETET	743.7	GJITHSEJ DETYRIMET	743.7

Burimi: BQK (2011)

Raiffeisen Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	71.4	Bilanci nga bankat tjera	17.5
Bilanci me bankat komerciale	111.5	Depozitat	543.9
Letrat me vlerë	66.2	Huamarrjet tjera	...
Kreditë	396.2	Detyrimet tjera	16.6
Asetet fikse	8.0	Borxhi i ndërvarur	...
Asetet tjera	6.7	Mjetet vetanake	82.0
GJITHSEJ ASETET	660.0	GJITHSEJ DETYRIMET	660.0

Burimi: BQK (2011)

Banka për Biznes

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	16.0	Bilanci nga bankat tjera	1.2
Bilanci me bankat komerciale	9.0	Depozitat	85.6
Letrat me vlerë	...	Huamarrjet tjera	...
Kreditë	72.9	Detyrimet tjera	1.4
Asetet fikse	2.2	Borxhi i ndërvarur	2.5
Asetet tjera	1.0	Mjetet vetanake	10.4
GJITHSEJ ASETET	101.1	GJITHSEJ DETYRIMET	101.1

Burimi: BQK (2011)

Banka Ekonomike

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	12.9	Bilanci nga bankat tjera	3.4
Bilanci me bankat komerciale	24.4	Depozitat	119.0
Letrat me vlerë	...	Huamarrjet tjera	...
Kreditë	92.8	Detyrimet tjera	2.9
Asetet fikse	1.7	Borxhi i ndërruarur	...
Asetet tjera	5.7	Mjetet vetanake	12.1
GJITHSEJ ASETET	137.5	GJITHSEJ DETYRIMET	137.5

Burimi: BQK (2011)

Banka Kombëtare Tregtare

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	8.5	Bilanci nga bankat tjera	46.3
Bilanci me bankat komerciale	0.1	Depozitat	60.0
Letrat me vlerë	8.1	Huamarrjet tjera	...
Kreditë	93.3	Detyrimet tjera	1.1
